Ambasciata d'Italia
Tirana

AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

UN WOMEN

Fuqizimi i Grave për Zhvillimin Rural në Shqipërinë Veriore

Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirëve të Vlerës në Bashkinë Bulqizë

UN Women është krijuar për të avancuar të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave. Si enti drejtues i Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe sekretariat i Komisionit për Statusin e Grave, ne punojmë për të ndryshuar ligjet, institucionet, sjelljet shoqërore dhe shërbimet, me qëllim mbylljen e hendekut gjinor dhe ndërtimin e një bote të barabartë për të gjitha gratë dhe vajzat.Partneritetet tona me qeveritë, lëvizjet e grave dhe sektorin privat, së bashku me rolin tonë koordinues në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara, i kthejnë përparimet në ndryshime të qëndrueshme. Puna jonë për avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave përqendrohet në katër fusha kyçe: lidershipi, fuqizimi ekonomik, mbrojtja nga dhuna, roli i grave në paqe dhe siguri, si dhe veprimi humanitar.

UN Women i vendos të drejtat e grave dhe vajzave në qendër të përparimit global—gjithmonë dhe kudo. Sepse barazia gjinore nuk është vetëm ajo që bëjmë. Barazia gjinore është ajo që jemi.

UN Women Zyra e Shqipërisë,
Rr. "Skenderbej", Ndërtesa 8, Ap. 29-31, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 450 2555/7575
E-mail: unwomen.albania@unwomen.org
Website: https://albania.unwomen.org

Kjo analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirëve të vlerës u realizua në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut", i zbatuar nga UN Women dhe i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar e Italisë. Ky projekt zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara ose cilësdo prej organizatave të lidhura me to.

Për të shkarkuar këtë botim, ju lutemi shkoni në faqen: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications

Autorë: Erald Lamja, Diamanta Vito, ekspertë të UN Women

Me kontribut teknik të: Rachele Megna, Besmira Kukaj, nga UN Women

Bashkia Bulqizë

Përpunimi grafik: HL Branding

Ky botim është i disponueshëm me akses të lirë në përputhje me licencën Creative Commons të krijuar për organizatat ndërqeveritare, e disponueshme në: https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/igo/.

Botuesit duhet të heqin logot e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, UN Women nga botimi i tyre dhe të krijojnë një kopertinë të re. Botuesit duhet të dërgojnë versionin e tyre në format elektronik në adresën: permissions@unwomen.org. Fotokopjimi dhe riprodhimi i pjesëve të veçanta lejohet, për sa kohë që jepet njohja e duhur.

Fuqizimi i Grave për Zhvillimin Rural në Shqipërinë Veriore

Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirëve të Vlerës në Bashkinë Bulqizë

Qershor 2025

Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtesave 9

Përligjja e studimit 11

Përmbledhje e konstatimeve kryesore kontekstuale 12

PJESA 1: METODOLOGJIA 16

PJESA 2: ANALIZË E ZINXHIRIT TË VLERËS SË BMA-VE 24

1. Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirit të vlerës së BMA-ve 25

1.1 Situata e zinxhirit të vlerës të BMA-ve në qarkun e Dibrës 26

2. Diagram i Zinxhirit të Vlerës të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike 30

2.1 Aktorët në zinxhirin e vlerës 31

2.2 Shërbimet e mbështetjes dhe kontrollit 32

2.3 Konstatimet e studimit 37

2.4 Ndërhyrje të rekomanduara për zinxhirin e vlerës të BMA-ve në Bulqizë 39

PJESA 3: ANALIZË E ZINXHIRIT TË VLERËS TË PUNIMEVE ARTIZANALE 42

1. Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirit të vlerës të punimeve artizanale 43

2. Diagram i zinxhirit të vlerës të punimeve artizanale në Ostren 46

2.1 Konstatimet e studimit 50

2.2 Ndërhyrje të rekomanduara për zinxhirin e vlerës të punimeve artizanale në Bulqizë 52

PJESA 4: SHTOJCAT 56

Shtojca 1. Bashkia Bulqizë: Informacion i përgjithshëm 57

Vështrim i përgjithshëm mbi bashkinë Bulqizë 58

Histori 59

Popullsia 59

Infrastruktura: toka, ujërat, energjia elektrike dhe jeta sociale 60

Shërbimet sociale dhe ndihma ekonomike 60

Edukimi 62

Shëdetsia 63

Situata e biznesit lokal dhe aktiviteti ekonomik 63

Bujqësia 64

Turizmi 68

Shtojca 2: Konteksti kombëtar i barazisë gjinore 71

Shtojca 3. Bujqësia dhe zhvillimi rural: çështje gjinore kyçe në Shqipëri 75

Lista e Tabelave

Tabela 1. Klasifikimi dhe përzgjedhja e zinxhirëve të vlerës me përdorim të kritereve me ndjeshmëri gjinore 20

Tabela 2. Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e BMA-ve 21

Tabela 3. Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e punimeve artizanale në NJA Ostren 22

Tabela 4. Listë e bimëve të egra që mblidhen në zonën e Dibrës 26

Tabela 5. Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të BMA-ve 29

Tabela 6. Rekomandime për zinxhirin e vlerës të BMA-ve 40

Tabela 7. Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të punimeve artizanale 45

Tabela 8. Rekomandime për zinxhirin e vlerës të punimeve artizanale 54

Tabela 9. Popullsia e Bulqizës (2023) 60

Tabela 10. Arsimi parashkollor 62

Tabela 11. Arsimi i detyruar dhe i mesëm (2018) 62

Tabela 12. Shkolla profesionale gjeologji miniera dhe e shërbimeve sociale 63

Tabela 13. Ndërmarrjet aktive 64

Tabela 14. Të dhëna për prodhimin bujqësor (2023) 64

Tabela 15. Prodhimi i vreshtarisë 65

Tabela 16. Prodhimi i frutave 65

Tabela 17. Fermerët në Bulqizë sipas njësisë administrative dhe gjinisë 66

Tabela 18. Prodhimi i mishit, peshë e gjallë, në vitin 2023 (ton) 67

Tabela 19. Prodhimi i qumështit në vitin 2023 (ton) 67

Tabela 20. Bagëtitë për qumësht në vitin 2023 68

Tabela 21. Prodhime të tjera nga bagëtitë në vitin 2023 (ton) 68

Tabela 22. Blegtoria në Bulqizë 2024 68

Tabela 23. Monumentet në bashkinë Bulqizë 69

Lista e Figurave

Figura 1. Qasja metodologjike 19

Figura 2. Diagram i zinxhirit të vlerës të BMA-ve 30

Figura 3. Diagram i zinxhirit të vlerës të punimeve artizanale 46

Figura 4. Bashkia Bulqizë 57

Figura 5. Gratë, burrat dhe bujqësia në Shqipëri 79

Lista e Shkurtesave

AICS	Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
AREB	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor
NJA	Njësi Administrative
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e OKB-së
PMB	Praktikat e Mira Bujqësore
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
OMGJ	Organizma të Modifikuar Gjenetikisht
ANGJZV	Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës
HACCP	Analiza të Rrezikut dhe Pikave Kritike të Kontrollit
UNKN	Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
BMA	Bimë Mjekësore dhe Aromatike
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
DHKZ	Dhoma Kombëtare e Zejtarisë
QTTB	Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
ZV	Zinxhir i Vlerës
FEG	Fuqizimi Ekonomik i Grave

Përligjja e Studimit

Dhuna me bazë gjinore mund të krijojë barriera që pengojnë mundësitë ekonomike dhe zhvillimin. Nga ana tjetër, fuqizimi ekonomik i grave (FEG) mund të shtojë besimin dhe pavarësinë dhe të zvogëlojë gjasat që ato të jetojnë në situata të dhunshme; po kështu, rritja e fuqizimit ekonomik të grave u kundërvihet edhe stereotipeve gjinore dhe normave shoqërore të rrënjosura thellë, të cilat mund të manifestohen me rritje të dhunës me bazë gjinore. **Ky dualitet nxjerr në pah ndërveprimin kompleks midis fuqizimit dhe rezistencës ndaj ndryshimit, që thekson nevojën e një qasjeje ndaj barazisë gjinore që është tërësore dhe e përshtatur me kontekstin.** Rrjedhimisht, fuqizimi ekonomik i grave shihet edhe si mjet për t'i dhënë fund dhunës në rastin e grave të mbijetuara të dhunës, edhe si një mënyrë për forcimin e pavarësisë ekonomike të grave dhe pjesëmarrjen e tyre në forcat e punës. Këto dinamika janë veçanërisht të dukshme në bashkitë e Bulqizës, Malësisë së Madhe, Shkodrës, dhe Dibrës, të cilat janë bashkitë në qendër të projektit "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut,"[1] i zbatuar nga UN Women Shqipëri, me mbështetjen e Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, përmes Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS Tiranë). Në këto zona mbizotërojnë stereotipet gjinore dhe ato karakterizohen nga mungesa sistematike të shërbimeve sociale, si transporti publik dhe kopshtet e fëmijëve; aksesi i kufizuar ose i paqartë në të drejta pronësore të grave; si dhe shkallë e lartë e punës së papaguar dhe informale që kryejnë gratë, që mund të kufizojë shkallën në të cilën ato mund të marrin pjesë në veprimtari ekonomike.[2] Për t'i trajtuar këto probleme, UN Women promovon qeverisjen e përgjigjshme gjinore, ku përfshihen elementë të forcimit të reagueshmërisë gjinore të kornizës së politikave bujqësore dhe të zhvillimit vendor në nivel kombëtar dhe lokal, përmes rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat e grave dhe adresimit të stereotipeve gjinore, përfshirë në lidhje me të drejtat pronësore dhe për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave. Kjo qasje me ndjeshmëri gjinore ndaj zinxhirit të vlerave është një strategji proaktive që jo vetëm promovon barazinë gjinore, por edhe forcon efikasitetin, qëndrueshmërinë, dhe karakterin përfshirës të ekonomive rurale. Kjo qasje e bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, parimet e drejtësisë sociale dhe avantazhet ekonomike të përfshirjes gjinore për bizneset – si ato që janë shtjelluar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP)[3] – i njeh gratë si kontribuese aktive në produktivitetin ekonomik dhe forcimin e aftësisë së komunitetit për të përballuar situata të vështira. Kjo nismë synon të transformojë dinamikën ekzistuese të pushtetit dhe të zgjerojë rolet e grave si veprimtare ekonomike. **Garantimi i reagueshmërisë gjinore të ligjeve, politikave dhe shërbimeve do të krijojë një mjedis mundësues që mbështet jo vetëm të drejtat e grave, por edhe aftësinë konkurruese dhe qëndrueshmërinë ekonomike.** Nga ana e tij, promovimi i fuqizimit ekonomik të grave forcon autonominë e grave dhe bën të mundur që ato të dalin nga cikli i dhunës, të kërkojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kontribuojnë në mënyrë më të plotë në familje dhe komunitet. Përmes njohjes së rolit kyç të barazisë gjinore në arritjen e një zhvillimi rural përfshirës dhe të qëndrueshëm, ky projekt ndërmerr të kryejë **analiza me ndjeshmëri gjinore të zinxhir**ëve të **vler**ës**, të përshtatura me veçoritë e zonave** në secilën bashki partnere. Këto analiza synojnë të evidentojnë sektorët kyç të ekonomisë dhe zinxhirët e vlerës me potencial zhvillimor, të hartëzojnë rolet e diferencuara të grave dhe burrave në këta zinxhirë vlere, dhe të identifikojnë pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen dhe rolin drejtues të grave. Mbi bazën e këtyre të dhënave po përgatiten ndërhyrje të posaçme për rritjen e aksesit të grave në mundësi ekonomike dhe për të promovuar një zhvillim të drejtë gjinor të zinxhirit të vlerave. Studimi bën një analizë të Bashkisë së Dibrës nga këndvështrimi gjinor dhe sugjeron qasje me ndjeshmëri gjinore për forcimin e barazisë gjinore në zinxhirët e vlerës ekonomike dhe përmes tyre, bazuar në ekspertizën e UN Women në këtë fushë.[4] Ai synon të identifikojë strategji konkrete dhe të realizueshme për forcimin e barazisë gjinore **në zinxhirët e vlerës dhe përmes tyre,** duke u mbështetur në ekspertizën globale të UN Women dhe partneritetet vendore. **Përmes promovimit të zinxhirëve të vlerës me përfshirje të gjerë, projekti synon të çlirojë potencialin e plotë ekonomik të grave dhe të forcojë rolet e tyre si faktorë të ndryshimit në zhvillim të qëndrueshëm rural.**

1. Projekt i financuar nga AICS – Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor dhe i zbatuar nga UN Women Shqipëri (2024-2027).
2. *Empowering Women in the Rural Economy* (Fuqizimi i grave në ekonominë rurale). Shih https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/%40ed_dialogue/%40sector/documents/publication/wcms_601071.pdf
3. *Guide to Gender-Sensitive Approaches to Value Chain Development* (Udhëzues për qasje me ndjeshmëri gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerave). Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP). (2022). Shih: https://www.ilo.org/publications/guide-gender-sensitive-approaches-value-chain-development
4. https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2022/12/gender-sensitive-value-chain-analysis

Përmbledhje e Konstatimeve Kryesore Kontekstuale

Bashkia Bulqizë, që gjendet në zonën e Dibrës të Shqipërisë, karakterizohet nga një terren malor, burime të pasura natyrore dhe një popullsi kryesisht rurale. Bashkia ka një sipërfaqe prej 694 km^2, me 73,1% të banorëve që jetojnë në zona rurale, ku përballen me vështirësi në infrastrukturë, zhvillim ekonomik, dhe në aksesimin e shërbimeve thelbësore.

Historikisht, Bulqiza është njohur për industrinë e minierave, sidomos nxjerrjen e kromit, që vazhdon të jetë sektor ekonomik mbizotërues edhe sot. Megjithatë, zona ka mjaft potencial edhe në bujqësi, blegtori, kultivimin e bimëve mjekësore, punime artizanale, dhe turizëm, që janë ende të pashfrytëzuara. Me gjithë potencialin e saj ekonomik, Bulqiza përballet me nivel të lartë papunësie, dallime gjinore dhe akses të kufizuar – sidomos të grave – në burime. Trajtimi i këtyre sfidave kërkon ndërhyrje të fokusuara që promovojnë rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm me përfshirje gjinore.[5]

Ekonomia e Bulqizës përbëhet kryesisht nga industria minerare, bujqësia dhe tregtia e vogël, ndër të cilët sektori i minierave punëson një numër të konsiderueshëm të forcave të punës. Pjesëmarrja e grave në ekonominë formale mbetet e ulët: 38% e grave janë të papuna dhe me akses të kufizuar në mundësi ekonomike jashtë roleve tradicionale.[6] Bizneset e vogla, sidomos ato të drejtuara nga gratë, në sektorë si artizanati dhe agrobiznesi, përballen me barriera si aksesi i kufizuar në kredi, mungesë e trajnimit për biznes, dhe përjashtimi nga rrjetet formale. Bujqësia luan rol vital në ekonominë e zonës, por vetëm 14,9% e fermerëve të regjistruar janë gra, që dëshmon për pabarazitë gjinore në pronësinë mbi tokën dhe pjesëmarrje në bujqësi.

Gratë merren kryesisht me bujqësi për nevojat e familjes, kujdesen për bagëtitë dhe mbledhin bimë mjekësore, por kontributi i tyre shpesh mbetet informal.

Vetëm 14.9% e fermerëve të regjistruar janë gra, çka thekson hendekun gjinor në pronësinë e tokës dhe në bujqësi.

38% e grave janë të papuna dhe kanë akses të kufizuar përtej roleve tradicionale.

5. Dosja e Barazisë Gjinore Shqipëri. UN Women Shqipëri. 2020. https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020-0

6. Gratë dhe burrat në Shqipëri 2023. INSTAT. Shih: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/men-and-women-2023/

Gratë merren kryesisht me bujqësi për nevojat e familjes, kujdesen për bagëtitë dhe mbledhin bimë mjekësore, por kontributi i tyre shpesh mbetet informal. Pavarësisht nga potenciali që ekziston në bashki për bletarinë, prodhimin e bulmetit dhe kultivimin e BMA-ve, gratë kanë akses të kufizuar në trajnime, teknologji dhe tregje.

Gratë në Bulqizë përballen me barriera sociale dhe ekonomike që kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes dhe aktivitet ekonomik. Familjet ku kryefamiljare janë nëna të vetme përbëjnë 10% të familjeve, që thekson nevojën për politika sociale reaguese gjinore. Shqetësim është edhe pjesëmarrja e vajzave në arsim, për të cilën janë pengesë rrugët e gjata që u duhet të bëjnë për të shkuar në shkollë dhe mungesa e mundësive për përgatitje profesionale.[7] Trajtimi i këtyre sfidave kërkon investime në infrastrukturë sociale, programe për fuqizimin e grave, dhe shërbime mbështetëse në komunitet.[8]

Bulqiza ofron mundësi të shumta për turizëm, veçanërisht në ekoturizëm dhe turizmin e aventurës, por ky sektor ende nuk është i zhvilluar sa duhet. Vende turistike si Liqeni i Zi, Malësia e Martaneshit dhe vende historike në zonë ofrojnë mundësi unike për turizëm të qëndrueshëm. Gratë mund të luajnë rol të rëndësishëm në sipërmarrjet që lidhen me turizmin, si bujtinat, punimet artizanale, dhe gatimet e zonës, por përballen me vështirësi për formalizimin dhe marketimin e bizneseve të tyre. Përmirësimi i infrastrukturës, promovimi i atraksioneve të zonës dhe investimi në nisma turistike të drejtuara nga gratë mund të ndihmojë për çlirimin e potencialit turistik të zonës dhe të mbështesë njëkohësisht rritje ekonomike me përfshirje gjinore.[9]

Bashkia Bulqizë është e pasur në burime natyrore, ka një trashëgimi të pasur kulturore dhe potencial ekonomik, por përballet me sfida strukturore të konsiderueshme që pengojnë zhvillimin përfshirës dhe të qëndrueshëm të saj.

Mbizotërimi i industrisë minerare ka kufizuar diversifikimin ekonomik dhe bujqësia, turizmi dhe artizanati mbeten të pazhvilluara sa duhet, me gjithë potencialin e tyre për të krijuar vende pune dhe për t'i dhënë hov zhvillimit ekonomik.

Gratë, në veçanti, përballen me barriera sistemike për të pasur akses në mundësi ekonomike, arsim, shërbim shëndetësor dhe burime financiare, çka kufizon pjesëmarrjen e tyre të plotë në zhvillimin e zonës.

Bashkia Bulqizë

Sipërfaqe
694 km²
(8 njësi administrative)

Popullsia
26,826
(13,218 gra and 13,608 burra)



7. Bashkia Bulqizë.
8. Bashkia Bulqizë.
9. Strategjia Kombëtare e Turizmit e Shqipërisë 2024-2030. Shih: https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/785

Konstatimet Kryesore

Konstatimi I Rreth 300 familje nga zonat rurale merren me mbledhjen spontane të BMA-ve.[10] Ka përvojë të kufizuar në kultivim (me përjashtim të rreth 30 familjeve në NJA Shupenzë, të cilat ishin pjesë e një ndërhyrjeje të financuar nga USAID në vitin 2019).[11] Konsoliduesi i zonës është shumë i interesuar të ndërmarrë rol aktiv për të promovuar kultivimin. Gjendja e infrastrukturës përbën një sfidë shtesë, sidomos për përpunimin e bimëve mjekësore dhe aromatike, ku mungojnë ambientet e përshtatshme dhe teknologjia moderne për kryerjen e proceseve pas vjeljes.

Konstatimi II Punimet artizanale, sidomos punimet e thurura prej leshi, përbëjnë potencial për vetëpunësimin e grave në Ostren. Aftësitë e grave kufizohen vetëm në disa produkte tradicionale lokale dhe ato nuk kanë njohuri për kërkesat e tregut.

Konstatimi III Bletaria është e kufizuar dhe ende perceptohet si punë 'burrash'. Shoqata e bletërritësve vendorë nuk është shumë aktive dhe nuk ka bashkëpunim. Nga 36 bletërritës anëtarë të shoqatës lokale, vetëm pesë janë gra.

Konstatimi IV Në bazë të dokumenteve të shqyrtuara, blegtoria dhe prodhimi i bulmetit janë sektorë mjaft premtues; megjithatë, vizitat në terren dhe intervistat me aktorët dhe palët e interesit treguan që bashkëpunimi dhe besimi i ndërsjellë mes fermerëve është pothuaj inekzistent.

Konstatimi V Një barrierë tjetër e konsiderueshme janë njohuritë e kufizuara për tregun – gratë pak i kuptojnë dinamikat e zinxhirit të vlerës, mekanizmat e çmimit, dhe kërkesat e konsumatorëve. Këtyre u shtohen edhe aksesi i kufizuar në burime, përfshirë në ndihmë financiare, asistencë teknike dhe lidhje në treg. Po kështu, gratë janë të nënpërfaqësuara në organe vendimmarrëse, që kufizon ndikimin e tyre në politika dhe strategji ekonomike, si në nivel vendor ashtu edhe në nivel rajonal.

Puna në terren zbuloi vështirësi kritike që pengojnë pjesëmarrjen dhe rritjen ekonomike të grave, por tregoi edhe mundësitë ku ndërhyrje të fokusuara mund të sjellin zhvillim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Një nga vështirësitë kryesore që u identifikua ishte roli i padukshëm i grave në zinxhirët e vlerës, sidomos në sektorë si bletaria dhe blegtoria, ku kontributet e tyre përgjithësisht nuk njihen. Krahas kësaj, ka mungesë bashkëpunimi mes aktorëve të zinxhirit të vlerës, sidomos në sektorët e bletarisë dhe të blegtorisë/bulmetit, që pengon rritjen kolektive dhe efikasitetin e zinxhirit të vlerës. Përveç këtyre, emigrimi i lartë sezonal, me pothuaj 80% të burrave që largohen për të punuar diku gjetkë, pengon stabilitetin familjar dhe të biznesit, duke ua bërë grave të vështirë që të mbajnë aktivitetin ekonomik.Me gjithë këto vështirësi, ka një numër mundësish për ndërhyrje. Zinxhirët e vlerës të punimeve artizanale dhe të BMA-ve ofrojnë skenarë potencialë me përfitim të dyfishtë, si për zhvillimin e zinxhirit të vlerës, ashtu edhe për fuqizimin e grave.

10. Informacion i dhënë nga Lo-Am Medicine.

11. Projekti i USAID për planifikimin dhe qeverisjen vendore në Shqipëri kreu një ndërhyrje për fuqizimin e grave në zinxhirin e vlerës të BMA-ve në njësinë administrative të Shupenzës.

Pjesa 1
Metodologjia

Kjo analizë u krye nga UN Women Shqipëri, në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut", i financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS Tirana), me mbështetjen e personelit të Bashkisë Bulqizë dhe në bashkëpunim me grupe të ndryshme të interesit në zinxhirët e vlerave. Qëllimi i kësaj analize ishte që të vlerësonte mundësitë për rritje ekonomike në Bashkinë Bulqizë, me fokus të veçantë mbi identifikimin e sektorëve ku gratë mund të përfshihen më shumë. Duke kuptuar sfidat dhe potencialin e zinxhirëve të ndryshëm të vlerës, ky studim synon të propozojë ndërhyrje të fokusuara që kontribuojnë si në zhvillimin ekonomik, ashtu edhe në fuqizimin e grave të zonës.

Objektivi i parë i këtij studimi ishte që të identifikonte sektorët ekonomikë kyç ku ka mundësi për rritje dhe zhvillim ekonomik në Bashkinë Bulqizë. Kjo përfshiu vlerësimin e nivelit të pjesëmarrjes së grave në këta sektorë, si dhe potencialin e këtyre të fundit për fuqizimin e grave. Duke kuptuar dinamikat ekzistuese, studimi synoi të vinte në pah mundësitë ku gratë mund të luajnë një rol më aktiv dhe të përfitojnë nga nismat ekonomike. Objektivi i dytë ishte që të përcaktohej një numër i vogël zinxhirësh vlere që janë më premtues për zhvillim të mëtejshëm. Këtu u përfshi edhe dhënia e rekomandimeve të fokusuara për forcimin e rolit të grave, adresimi i barrierave të shkaktuara nga paragjykimet gjinore, si dhe identifikimi i masave specifike që do të shtonin pjesëmarrjen e grave në aktivitete ekonomike dhe do të eliminonin pengesat strukturore që pengojnë fuqizimin e tyre. Qasja me ndjeshmëri gjinore në zinxhirët e vlerës kryesisht në metodologjinë e shtjelluar në *Making the Strongest Links: A Practical Guide to Mainstreaming Gender analysis in Value Chain Development* (Krijimi i hallkave më të forta – udhëzues praktik për përfshirjen e analizës gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerës) nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) botuar në vitin 2007; udhëzuesi plotësues *Gender-Sensitive Approaches to Value Chain Development: A Complementary Guide* (Qasje me ndjeshmëri gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerës: Udhëzues plotësues), po ashtu botim i ONP-së në vitin 2022; dhe *Guide for Practitioners dhe Interested Stakeholders* (Udhëzues për profesionistët dhe grupet e interesit) përgatitur nga USAID në vitin 2019 dhe ribotuar nga UN Women Shqipëri në vitin 2021.

Metodologjia e përdorur është ajo sasiore, me kombinim të burimeve dytësore dhe parësore. Burimet dytësore përbëheshin nga raporte dhe të dhëna të ndryshme të mbledhura kryesisht nga botime dhe statistika zyrtare të Institutit të Statistikave të Shqipërisë, raporte të bashkisë, raporte të këshillit të qarkut, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe të dhëna dhe informacione të marra nga studime dhe projekte të mëparshme të zhvilluara në fushën përkatëse. Raportet e bashkisë (që konsistonin kryesisht në planet strategjike dhe operacionale), ishin veçanërisht me vlerë për të kuptuar strukturën ekonomike të zonës dhe vizionin e bashkisë për sigurimin e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm. Qëllimi i burimeve parësore të mbledhura përmes punës kërkimore në terren, ishte që të mbështeste procesin e përzgjedhjes së zinxhirëve të vlerës. Ndër to ishin konsultime, intervista, dhe angazhime të drejtpërdrejta me përfaqësues të bashkisë, aktorë të zinxhirit të vlerës (gra dhe burra), prodhues dhe specialistë. Ky hap u nda në dy faza:

Vlerësimi paraprak: U mbajtën diskutime dhe takime me përfaqësues të bashkisë, prodhues, anëtarë të ekipit të projektit dhe organizata mbështetëse për të parë mundësitë e zinxhirëve të vlerës. Seancat në grupe fokusi me përfaqësues të bashkisë ndihmuan në identifikimin e kufizimeve, pengesave specifike gjinore, dhe mundësive që lidhen me zinxhirët ekzistues apo të krijuar rishtas të vlerës. Bazuar në këtë punë paraprake në terren, u identifikuan disa sektorë kyç për analizë të mëtejshme, në sajë të potencialit të tyre për zhvillim ekonomik dhe pjesëmarrjen e grave në fushat e synuara.

Këtu u përfshinë **prodhimi i bulmetit, bimët mjekësore dhe aromatike (BMA-të), bletaria, shërbimet e lidhura me turizmin dhe punimet artizanale**. Këtyre sektorëve iu dha përparësi për shkak të aksesit të grave në to, potencialit për krijimin e vendeve të punës, njohurive ekzistuese në zonë dhe relevancës kulturore.Në përputhje me Agjendën e ONP-së për Punë të Denjë, përzgjedhja e këtyre sektorëve thekson objektiva si:

- **Promovimi i punësimit produktiv** përmes sektorëve me mundësi zhvillimi dhe me intensitet të lartë pune në nivel vendor;
- **Zgjerimi i aksesit në mundësi të drejta** për fitim të ardhurash nga gratë dhe grupet e margjinalizuara;
- **Përmirësimi i kushteve të punës dhe mbrojtjes sociale**, sidomos në bujqësi dhe aktivitetet informale;
- **Forcimi i zërit dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje** në të gjithë zinxhirët e vlerës.

Puna në terren: Vizita, takime dhe intervista në terren me aktorët e ZV-së për të marrë informacion të thelluar për sektorët ekonomikë përkatës. Konstatimet nga studimi i dokumentacionit u diskutuan me përfaqësues të bashkisë si Haxhi Pulja, zëvendëskryetar i bashkisë, Shahin Alliu, drejtor i seksionit të bujqësisë në bashki, në një takim të mbajtur më 21 janar 2025.
Zinxhirët kryesorë të vlerës që u përzgjodhën për vlerësim më të thelluar ishin: bimët mjekësore dhe aromatike, produktet artizanale (zona e Gollobordës); bletaria dhe blegtoria. Këta zinxhirë të vlerës ishin fokusi kryesor gjatë misioneve në terren. Në punën në terren u përfshinë:

- Vizitë tek konsoliduesi/kompania e BMA-ve në Bulqizë: takim dhe intervistë me Drilon Vocin, pronar i Lo-Am Medicine, një punëtore, dy fermerë që furnizojnë qendrën me produkte (një grua dhe një burrë) dhe përfaqësues nga sektori i bujqësisë në bashki, më 21 janar 2025.

- Vizitë në njësinë administrative të Ostrenit (në Gollobordë): takim me përfaqësues të zonës dhe personelin e njësisë administrative të Ostrenit: Bajram Mata (administrator), Fatos Tola (gjendja civile), dhe Mehmet Gjoka (agronom), dhe Llambi Kurti, (veteriner në zonën Trebisht-Ostren) si edhe (tetë) gra të zonës që merren me prodhimin e punimeve artizanale/kostume tradicionale, më 21 janar 2025.

- Vizitë në terren dhe takim me kryetarin e shoqatës së bletërritësve dhe me bletërritësin, Arjan Zogu, më 21 janar 2025.

- Vizitë në terren dhe takim me pronarët e një ferme blegtorale dhe të përpunimit të bulmetit, Mona dhe Naim Xheli, dhe me administratorin e NJA të Shupenzës, Ylli Jani, më 22 janar 2025.

Puna studimore në terren ofroi informacione të rëndësishme për strukturën dhe dinamikën e zinxhirëve të vlerës në Bulqizë, dhe theksoi barrierat potenciale ekonomike ndaj pjesëmarrjes së grave dhe fushat ku mund të kryhen ndërhyrje të fokusuara për të forcuar si zhvillimin ekonomik, ashtu edhe barazinë gjinore.

Për vlerësimin e zinxhirëve potencialë të vlerës u përdorën këto kritere:

- A ka kërkesa në rritje për produktin?

- A janë të përfshira gratë në hallkat e zinxhirit të vlerës?

- A janë shumica e hallkave në zinxhirin e vlerës me bazë në bashki?

- A ka nisma të tanishme apo të kohëve të fundit që mund të shërbejnë si bazë për zinxhirin e vlerës?

- A krijohen mundësi nga zhvillimi i zinxhirit të vlerës?

- A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për zhvillim/diversifikim në zinxhirin e vlerës?

Në përfundim të takimeve me aktorë të ZV-së dhe grupet e interesit, të konsultimeve,[12] intervistave dhe vëzhgimeve të mjedisit të punës, u përcaktuan zinxhirët e vlerës për t'u vlerësuar më tej në bazë të tabelës së kritereve për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore në zinxhirët përkatës, të cilët janë: punimet artizanale (në Ostren), dhe BMA-të.

1. **Përcaktimi i objektivave dhe i grupit të synuar:** Caktimi i objektivave bazuar në synimet kombëtare dhe bashkiake (konkretisht, përmirësimi i jetesës dhe promovimi i barazisë gjinore) dhe përcaktimi i grupit të synuar dhe i kritereve të përzgjedhjes:

2. **Grupi i synuar:** gratë dhe burrat në zonat rurale veriore;

3. **Kriteret:** rëndësia e zinxhirit të vlerës në krijimin e mundësive për fuqizimin ekonomik ët grave.

4. **Vlerësimi i situatës në bashki:** Studimi fillestar i situatës në bashki dhe studim i dokumentacionit të planeve, strategjive, studimeve të mëparshme, etj.;

5. **Sektorët kryesorë:** Identifikimi i sektorëve kryesorë përmes vlerësimit të raporteve, të dhënave dhe botimeve të ndryshme;

12. Konsultim me sekretarin e përgjithshëm të Shoqatës Kombëtare të Bletërritësve të Shqipërisë, veterinerin e Shupenzës, Trebishtit dhe Ostrenit, të zyrës së AKVMB në Dibër, specialistin e bletarisë Dr. Pëllumb Aleksi, specialistët e BMA-ve, Prof. Dr. Gjon Gaspri dhe Prof. Dr. Alban Ibraliu, Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, Social Development Investment – një OSHC aktive në fushat e artizanatit dhe zejtarisë.

6. **Vlerësimi i ZV-ve:** Vlerësimi i zinxhirëve kryesorë të vlerës në sektorët e përzgjedhur përmes marrjes së mendimeve, diskutimeve, dhe grupeve të fokusit;

7. **Përzgjedhja e ZV-ve:** Përzgjedhja e një deri në dy zinxhirëve të vlerës dhe vlerësimi i mundësive, kufizimeve dhe fushave të ndërhyrjes përmes punës kërkimore në terren;

8. **Rekomandime:** Rekomandime për bashkinë lidhur me përmirësimin e zinxhirit të vlerës dhe rekomandime për projektin në lidhje me mundësitë e ndërhyrjes.

Figura 1. Qasja metodologjike



Tabela 1. Klasifikimi dhe përzgjedhja e zinxhirëve të vlerës me përdorim të kritereve me ndjeshmëri gjinore

Kriteret	BMA-të	Punimet artizanale (Ostren)
A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/ diversifikim në zinxhirin e vlerës?	Aktualisht, gratë bëjnë vetëm mbledhjen e bimëve dhe ndonjëherë marrin pjesë edhe në dorëzimin e produktit tek grumbulluesi i zonës. Konsoliduesi pranon vetëm produkt të freskët dhe i than ato në hapësirat brenda qendrës së grumbullimit. Konsoliduesi ka nisur një parcelë të vogël eksperimentale, ku teston bimë për kultivim. Tranzicioni drejt kultivimit mund të jetë një mundësi e mirë rritjeje për gratë.	Gratë në Ostren kanë traditë të gjatë në punimet artizanale. Gama e produkteve të tyre është e kufizuar në punime tradicionale të zonës, por, me mbështetje, ato i kanë aftësitë për ta zgjeruar gamën e punimeve me produkte të tjera, duke iu përgjigjur kërkesave të tregut.
A kanë (ose a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për shtimin e vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit?	Gratë janë të përfshira vetëm në mbledhjen e bimëve të egra. Nevojitet më shumë njohuri, sidomos për sa i përket zbatimit të standardeve, certifikimit dhe zbatimit të praktikave më të mira në të gjitha fazat, përfshirë tharjen dhe përpunimin fillestar.	Gratë kanë aftësitë bazë dhe mund të fitojnë aftësi të tjera në qoftë se mbështeten me trajnime. Duhet bërë më shumë për sa i përket diversifikimit, si për shembull, modele dhe produkte të reja për tregun, krijimin e lidhjeve në treg dhe trajnimin për modele të reja.
A ofron ky zinxhir i vlerës mundësi të reja për gratë?	Po. Në qoftë se ka bashkëpunim mes aktorëve dhe përfshirje në kultivim dhe tharje të bimëve.	Po. Sidomos nëse gratë orientohen drejt tregut dhe bashkëpunojnë me njëra-tjetrën.
A mund t'i përmirësojë zinxhiri i vlerës kushtet e jetesës për gratë/familjet e tyre?	Duke kaluar nga mbledhja e bimëve të egra në kultivim, gratë do të shtojnë të ardhurat dhe do të përmirësojnë kushtet e tyre të punës.	Po. Ky aktivitet mund të bëhet nga shtëpia dhe gratë mund të shtojnë të ardhurat e familjeve të tyre. Megjithatë, do të nevojiten investime të vogla, si për mjedis pune dhe për mjete pune të reja.
A ka një organizatë të motivuar në zinxhirin e vlerës që mund të mbështesë/përfaqësojë pjesëmarrësit në zinxhirin e vlerës, e cila mund të çojë përpara zhvillimin?	Konsoliduesi vendor është i interesuar të mbështesë ZV-në. Krahas kësaj, do të duhet edhe që gratë dhe fermerët të grupohen.	Bashkia dhe njësia administrative i kanë vënë artizanet e Ostrenit në listën e prioriteteve të tyre. Gjatë vizitës në terren, ato shprehën interes për t'u dhënë grave një hapësirë në ndërtesën e njësisë administrative. Megjithatë, do të jetë e nevojshme që edhe gratë të grupohen për të pasur përfaqësim më të mirë.
A ka mundësi të bëhen ndryshime me investime të vogla?	Po, në qoftë se kalimi nga mbledhja e bimëve të egra në kultivim bëhet mbi bazën e kërkesave të tregut dhe me zbatimin e praktikave dhe standardeve të kërkuara. Për këtë do të nevojiteshin investime, si për sigurimin e farave/fidanëve, për trajnime për praktikat e mira bujqësore, dhe për pajisje tharëse.	Po, përmes mbështetjes me pajisje bazë, trajnime për aftësi biznesi dhe teknologjike, dhe për lidhjet në treg.

Tabela 2. Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e BMA-ve

Pyetjet	Pikët*	Pesha**	Gjithsej	Përshkrimi
A është numri i grave të punësuara në zinxhirin e vlerës relativisht i lartë?	3	2	6	Po, bazuar në informacionin e dhënë nga konsoliduesi vendor, përqindja e grave që janë të përfshira në mbledhjen e bimëve të egra është 50%.
A ka shumë gra sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës?	2	2	4	Gratë marrin pjesë kryesisht në mbledhjen e bimëve të egra dhe shpesh shoqërojnë meshkujt e familjes në dorëzimin e bimëve. Disa gra bashkëpunojnë për transportim dhe mbledhjen e bimëve, por ka shumë pak gra sipërmarrëse të pavarura.
A kanë gratë kontroll mbi pajisjet dhe asetet?	2	2	4	Puna kryhet në pyll dhe në malet përreth. Pronësia mbi tokën ende është problem, për sa i përket kontrollit të aseteve.
A kanë (apo a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për ndonjë shtim interesant të vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit?	4	1	4	Po. Gratë kanë aftësitë bazë në bujqësi dhe në kultivimin e bimëve. Për të bërë kalimin në kultivim me fokus BMA-të, atyre do t'u nevojitet trajnim specifik bazuar në bimët përkatëse.
A kanë kontroll gratë mbi të ardhurat nga shitjet dhe mbi sipërmarrjen?	1	2	2	Transaksionet e biznesit bëhen kryesisht nga burrat. Konsoliduesi i zonës vë në dukje se janë shumë të pakta gratë që sjellin produkt në qendrën e tij të grumbullimit.
A mund të kryhet puna afër shtëpisë?	3	1	3	Po, duke kaluar nga mbledhja e bimëve të egra në kultivim.
A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për hyrjen e sipërmarrëseve të varfra (prodhim i vogël, kosto e ulët për fillim biznesi, nuk kërkon investime kapitale madhore, me përdorim aftësish teknologjike të ulëta)?	4	1	4	Po, fidanë të bimëve të përhershme për kultivim në shkallë të vogël (parcela të vogla), pajisje dhe mjete pune me teknologji të thjeshtë për kultivim.
A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për përfshirjen e grave në të (koha dhe aftësia për të lëvizur, aksesi në teknologji dhe asete, kufizimet kulturore)?	3	2	6	Po. Gratë edhe tani janë të përfshira në mbledhjen e bimëve të egra; ky është aktivitet i njohur për to.
A ofron ky ZV mundësi të reja për gratë?	2	4	8	Mesatar. Edhe po të kalojnë vetëm në kultivim, gratë përsëri do të mbeten hallka e fundit në zinxhir, në qoftë se nuk synojnë tregun përfundimtar (konsumatorët) dhe në qoftë se nuk angazhohen në proceset pas vjeljes (tharja, prerja, paketimi, etj.) për tregun lokal.
A është aktiviteti në ZV në përputhje me kushtet e jetesës (të ardhurat gjatë vitit, përdorimi i punës së familjarëve, kthim i shpejtë i investimit, ruajtja e paprekur e mjedisit)?	4	2	8	Po. Përmes kalimit në kultivim, futjes së bimëve të përhershme me një vjelje në vit për uljen e kostove të mbjelljes dhe të krahut të punës, dhe zbatimit të praktikave të mira bujqësore.
A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/ diversifikim në zinxhirin e vlerës?	4	1	4	I lartë. Njësoj si më sipër.
A ka norma gjinore (për shembull, ngecje në 'punët e grave') që i pengojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e zinxhirit të vlerës?	2	2	4	E vetmja pengesë, që është e zakonshme sidomos në zonat veriore të Shqipërisë, janë të drejtat pronësore të grave mbi tokën/ fermën. Shumë gra ende nuk janë të regjistruara si (bashkë-)pronare të shtëpive, tokës, apo pronave të tjera, të cilat më së shumti janë të regjistruara në emrin e burrave. Kjo i ka penguar gratë fermere që të përfitojnë nga shërbimet e ekstensionit bujqësor, mbështetja financiare, dhe kontratat formale me tregtarët, që ndikon negativisht në produktivitetin e tyre.
Totali i përgjithshëm i potencialit gjinor			57/102	

** Pikëzimi: 0 (shumë i ulët, jo, aspak) deri në 5 (shumë i lartë, po, shumë i rëndësishëm).*

*** Pesha nga 1 në 4, sipas rëndësisë dhe impaktit që ka secila prej pikave të mësipërme në arritjen e objektivave të përcaktuara.*[13]

Tabela 3. Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e punimeve artizanale në NJA Ostren

Pyetjet	Pikët*	Pesha**	Gjithsej	Përshkrimi
A është numri i grave të punësuara në zinxhirin e vlerës relativisht i lartë?	4	2	8	Gratë janë ato që merren me artizanat në zonën e Ostrenit.
A ka shumë gra sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës?	3	2	6	Pothuaj të gjitha gratë e Ostrenit kanë aftësi artizanale dhe merren me punime artizanale, kryesisht qëndisje, thurje të rrobave të leshta dhe jelekëve. Gjatë vizitës në terren, në takim morën pjesë tetë gra.
A kanë gratë kontroll mbi pajisjet dhe asetet?	4	2	8	Gratë kanë kontroll mbi pajisjet, të cilat janë shumë bazike.
A kanë (apo a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për ndonjë shtim interesant të vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit?	4	1	4	Gratë kanë aftësitë bazë dhe mund të fitojnë njohuri të tjera në qoftë se mbështeten me trajnime. Kërkohet më shumë diversifikim, si për shembull, për modele dhe produkte të reja për tregun, krijimin e lidhjeve në treg dhe trajnimin për modele të reja
A kanë kontroll gratë mbi të ardhurat nga shitjet dhe mbi sipërmarrjen?	4	2	8	Po. Gratë vendosin për çmimin e shitjes së produktit, bazuar kryesisht në koston e prodhimit.
A mund të kryhet puna afër shtëpisë?	5	1	5	Po. Aktiviteti kryhet në shtëpi. Krahas kësaj, zëvendëskryetari i bashkisë dhe administratori i NJA të Ostrenit ishin shumë të interesuar t'u ofronin grave një hapësirë pune në ndërtesën e njësisë administrative në qendër të fshatit.
A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për hyrjen e sipërmarrëseve të varfra (prodhim i vogël, kosto e ulët për fillim biznesi, nuk kërkon investime kapitale madhore, me përdorim aftësish teknologjike të ulëta)?	4	1	4	Po. Procesi i prodhimit është kryesisht manual, me vegla pune tradicionale bazike, si tezgjahu.
A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për përfshirjen e grave në të (koha dhe aftësia për të lëvizur, aksesi në teknologji dhe asete, kufizimet kulturore)?	4	2	8	Po. Po kështu, nuk ka pengesa për sa i përket dallimeve gjinore, sepse gratë janë të përfshira në pothuaj të gjitha proceset e prodhimit, në shtëpi ose afër shtëpisë, dhe artizanati është tashmë një ZV nën kontrollin e grave.
A ofron ky ZV mundësi të reja për gratë?	3	4	12	Po, duke marrë parasysh se ky aktivitet drejtohet nga gratë; gratë janë të përfshira në të gjitha fazat, dhe duke marrë parasysh se zona e thellë e Ostrenit nuk ofron shumë mundësi të tjera për gratë.
A është aktiviteti në ZV në përputhje me kushtet e jetesës (të ardhurat gjatë vitit, përdorimi i punës së familjarëve, kthim i shpejtë i investimit, ruajtja e paprekur e mjedisit)?	4	2	8	Po. Pika hyrjeje me kosto të ulët dhe kthim i shpejtë i investimit nëse gratë prodhojnë produkte të orientuara nga tregu, që kërkohen në treg.
A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/diversifikim në zinxhirin e vlerës?	4	1	4	Njësoj si më lart. Artizanati është traditë e zonës. Orientimi dhe mbështetja e grave drejt kërkesave të tregut do të përmirësojë efikasitetin e përgjithshëm në zinxhirin e vlerës.
A ka norma gjinore (për shembull, ngecje në 'punët e grave') që i pengojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e zinxhirit të vlerës?	4	2	8	Jo. Njësoj si më lart. Artizanati konsiderohet si aktivitet i grave. Zakonisht ai përcillet nga një brez në tjetrin, Ka ende pengesa, si vendimmarrja për fillimin e një biznesi, aksesi në financim, aksesi në burime, etj.
Totali i përgjithshëm i potencialit gjinor			84/102	

13. Trajtimi me përparësi i zinxhirëve të vlerës mbi bazën e mundësive që ofrojnë për promovimin e barazisë gjinore si një mënyrë efektive për të vënë në pah faktorët që kanë ndikim pozitiv në punësimin dhe të ardhurat e grave dhe të vajzave. Për këtë qëllim është përdorur një sistem klasifikimi nga 1 në 4 (ku 1 është 'i ulët', 2 'mesatar', 3 'mirë', dhe 4 'shumë mirë'). Bazuar në: Women's Inclusion and Value Chain Improvement in Albania – A Guide for Practitioners and Stakeholders (Përfshirja e grave dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerës në Shqipëri – Udhëzues për punonjësit dhe palët e interesit). USAID 2019 dhe UN Women 2021.

Pjesa 2

Analiza e Zinxhirit të Vlerës së Bimëve Mjekësore dhe Aromatike

1. Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës së BMA-ve

Shqipëria ka një traditë të gjatë në prodhimin dhe eksportin e BMA-ve. Shtytësi kryesor i zhvillimit të sektorit të furnizimit është bollëku i BMA-ve të egra. Rreth 15% e 3.250 llojeve të bimëve shqiptare kanë vlera si bimë mjekësore, aromatike, si erëza dhe tanina. Ky sektor ka një traditë të gjatë, më se 60 vjeçare. Aktualisht, mbledhja, kultivimi, përpunimi dhe tregtimi i BMA-ve është një biznes i rëndësishëm agropyjor në Shqipëri.[15]

Sipas Agjencisë Shqiptare të zhvillimit të Investimeve (AIDA), mbi 85.000 persona (kryesisht nga zonat rurale) janë të përfshirë në të gjithë zinxhirin e vlerës, që nga mbledhja e bimëve të egra, kultivimi, deri tek eksporti. Rreth 1/5 e familjeve në zonat rurale në rajonet malore janë përfshirë në aktivitete që sjellin të ardhura nga bimët mjekësore dhe aromatike: në mbledhje e kultivim, apo në punë të tjera në zinxhirin e vlerës të BMA-ve.

Afërsisht 400 lloje të BMA-ve janë identifikuar si bimë mjekësore dhe aromatike të florës shqiptare dhe mbi 200 lloje mblidhen dhe eksportohen.

Rreth 90% e prodhimit të bimëve mjekësore dhe aromatike eksportohet, që përfaqëson gati 20% të Totalit të eksporteve bujqësore të Shqipërisë. Në vitin 2022, prodhimi vendor i BMA-ve ishte 16.430 ton. Gjithashtu, në vitin 2022, eksportet totale të bimëve mjekësore dhe aromatike arritën vlerën 63 milion euro, me një rritje prej 6,7% nga viti i mëparshëm (59 milion euro).[16]

Sipërfaqja e kultivuar me BMA arriti në 7.200 hektarë në vitin 2023,me një prodhim prej 17.800 ton. Kultivimi i BMA-ve është përqendruar në Malësinë e Madhe (5.200 ha), por po përhapet me ritme të

Në Bulqizë, mbi 300 familje (50% gra) merren me mbledhjen e bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA).

shpejta në rajone të tjera të vendit (në Belsh 478 ha, Cërrik 188 ha, Gramsh 135 ha, etj.).[17]

Edhe pse kërkesa për BMA në tregun e brendshëm është e kufizuar, ka një gamë të gjerë BMA-sh me nivel më të ulët përpunimi të cilat shiten në tregjet e frutave dhe perimeve të freskëta dhe në dyqane. Ndër produktet kryesore që shiten në tregjet e brendshme janë çajet bimore dhe erëzat që përdoren për gatim.

Aktualisht, çaji dhe salepi paketohen nga kompani shqiptare dhe shiten në dyqane, përfshirë në supermarkete dhe restorante. Po kështu në tregjet e frutave dhe perimeve të freskëta shiten edhe barishte dhe erëza të tjera, të paketuara në qese të thjeshta - zakonisht 20-100 gram.[18]

15. *Medicinal and Aromatic Plants Sector Study* (Studimi i sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike). MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf
16. Biofach 2024. AIDA. Shih: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BIOFACH-24-broshure-1.pdf
17. INSTAT – Vjetari statistikor i bujqësisë, 2023.
18. Medicinal and Aromatic Plants Sector Study. AASF, 2023. Shih: https://aatsf.com.al/wp-content/uploads/2020/04/4Mapcover-EN.pdf

1.1 SITUATA E ZINXHIRIT TË VLERËS TË BMA-VE NË ZONËN E DIBRËS

Kushtet e veçanta klimatike dhe tokësore të zonës së Dibrës kanë ndikuar në krijimin e një shkalle të lartë biodiversiteti, ku BMA-të zënë vend të rëndësishëm në florën spontane të zonës. Në zonën e Dibrës ka më se 100 lloje BMA-sh, që u përkasin 30 familjeve bimore. Pothuaj 98% rriten në gjendje të egër dhe kohët e fundit rreth 2% kultivohen. Pjesa më e madhe rritet në lartësi 1.000-1.700 metra, ose edhe 2.000 metra mbi nivelin e detit, që i bën ato mjaft të vlerësuara. Rreth 500 familje në Dibër merren me BMA-të (kryesisht me mbledhjen e bimëve të egra).

Në vitin 1988, në zonën e Dibrës mblidheshin rreth 91 bimë mjekësore dhe aromatike (BMA) të cilat eksportoheshin. Sasia totale e BMA-ve të eksportuara atë vit ishte 5.374 ton, që gjeneroi një vlerë prej 1,124 milion USD.Sot në këtë zonë mblidhen 63 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike. Nga bimët që mblidhen sot, 16 janë të klasifikuara në një prej kategorive të gjendjes së rrezikuar nga Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (UNKN).[19]

Konkretisht:

- **Në rrezik kritik (CR):** me status të rrezikut të zhdukjes janë tri bimë: vërri i zi, mështekna dhe bliri.
- **Të rrezikuara (EN):** me status të rrezikuar janë pesë bimë: alkemila molis (alchemilla mollis), sanzi (gentiana lutea), lule borziloku, arra dhe rigoni (çaji i malit).
- **Të cenueshme (VU):** me status të cenueshëm janë shtatë bimë: dëllinja e zezë, dëllinja e kuqe, tisi, sherbela, shtogu, trumza, boronica (aronia).
- **Pothuaj të rrezikuar (NT):** Nuk ka BMA që mblidhen sot në zonë me këtë status.
- **Më pak shqetësuese (LC) ose me rrezik më të vogël (LR):** këtu përfshihet një specie: rrushi i arushës.

Tabela 4. Listë e bimëve të egra që mblidhen në zonën e Dibrës

Nr.	Emri latin	Emri në gjuhën shqipe	Statusi i kërcënimit
1	Juniperus communis	Dëllinjë e zezë	VU Alb
2	Juniperus oxycedrus	Dëllinjë e kuqe	VU A1b
3	Achillea millefolium	Njëmijëfletësh	
4	Althaea officinalis	Mëllaga e bardhë	
5	Alchemilla catachnoa	Alkemilë kataknoe	EN A1b
6	Arctium lappa	Rrodhja	
7	Anthyllis montana	Antilidë e malit	

19. Informacion nga intervista me Prof. Dr. Alban Ibraliu, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

No	Latin name	Albanian name	Threat status
8	Arctostaphylos uva-ursi	Rrushi i arushës	LR cd
9	Artemisia absinthium -	Bar pelini	
10	Bellis perennis	Luleshqerra	
11	Betula pendula	Mështekna	CR B2e
12	Castanea sativa	Gështenja	
13	Carlina vulgaris	Ushunjëz e rëndomtë	
14	Centaurea cyanus	Kokoçeli	
15	Corylus avellana	Lajthia	
16	Crataegus monogyna	Murrizi njëbërthamëz	
17	Crataegus oxyacantha	Murrizi dybërthamëz	
18	Colchicum autumnale	Xhërokulli vjeshtor	
19	Cynodon dactylon	Grami	
20	Fragaria vesca	Luleshtrydhja	
21	Fraxinus excelsior	Frashër i zi	CR A1b
22	Fraxinus ornus	Frashër i bardhë	
23	Galium verum	Ngjitëse e vërtetë	
24	Gentiana lutea	Sanzi	EN A1b
25	Iris sp	Shpatore	VU A2b
26	Helichrysum arenarium	Lule aku	
27	Hypericum perforatum	Lule basani	EN A1b
28	Juglans regia	Arra	EN A1b
29	Malus sylvestris	Molla e egër	
30	Melilotus officinalis	Jonxha e egër	
31	Melissa officinalis	Melisa	
32	Ononis spinosa	Gjuhë nuse	
33	Origanum vulgare	Çaji i malit	EN A1b
34	Papaver rhoeas	Lulëkuqja	
35	Parietaria officinalis	Parietaria	

(Vazhdon në faqen tjetër)

No	Latin name	Albanian name	Threat status
36	Phaseolus vulgaris	Fasulja	
37	Plantago lanceolata	Gjethe delli	
38	Polygonum aviculare	Bar pate	
39	Primula veris (=P. Officinalis)	Agulicja	
40	Prunus cerasus (=Cerasus vulgaris)	Qershia	
41	Prunus spinosa	Kulumbria	
42	Robinia pseudoacacia	Akacia	
43	Rosa canina	Trëndafili i egër	
44	Rubus fruticosus	Ferrëmanëza	
45	Rubus idaeus	Mjedra	
46	Salix alba	Shelgu i bardhë	
47	Salvia officinalis	Sherbela	VU Alb
48	Salvia sclarea	Shëngjini	
49	Sambucus ebulus	Qingla	
50	Sambucus nigra	Shtogu	VU Alb
51	Saponaria officinalis	Lule sapuni	
52	Satureja montana	Trumza	VU A1c
53	Taraxacum officinale	Lule shurdha	
54	Teucrium chamaedrys	Arrsi dushk	
55	Thymus serpyllum	Zhumbrica	
56	Tilia platyphyllos (=T. officinarum)	Bliri	CR Alc
57	Tilia tomentosa (=T. argentea)	Bliri i argjendtë	
58	Trifolium pretense	Tërfili i kuq	
59	Tussilago farfara	Thundërmushka	
60	Tussilago hybrida (=Syn. P. officinalis)	Llapoi	
61	Urtica dioca	Hithra	
62	Vaccinium myrtillus	Qershigla, boronica	VU A2b
63	Viola odorata	Manushaqja	

Në Bulqizë, mbi 300 familje merren me mbledhjen e bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA), dhe i çojnë produktet e tyre në qendrën lokale të grumbullimit të kompanisë Lo-Am Medicine, e cila krijua në vitin 2021 dhe është afër qytetit. Bimët vilen nga zona të largëta dhe dorëzohen të freskëta kundrejt një çmimi minimal, që kryesisht pasqyron kohën e shpenzuar për vjelje. Fshatarët nuk marrin pjesë në proceset pas vjeljes dhe kompania bën vetëm një proces tharjeje të thjeshtë (mbi dysheme), në objektin e vet. Në vitin 2019, rreth 30 familje në njësinë administrative të Shupenzës u mbështetën për kultivimin e mëllagës dhe të kokoçelit në një sipërfaqe 2 hektarë, përmes një projekti të financuar nga USAID. Aktualisht, sipas të dhënave të raportuara nga INSTAT-i, sipërfaqja e kultivuar me BMA në Bulqizë është vetëm 1 hektar. Lo-Am Medicine ka nisur parcelë eksperimentale afër qendrës së grumbullimit për kultivimin e sherbelës dhe rigonit, në bashkëpunim me QTTB-në Shkodër. Kjo nismë synon të vlerësojë performancën e rritjes, përshtatshmërinë dhe prodhimin potencial të këtyre bimëve mjekësore dhe aromatike në kushtet lokale. Deri tani, rezultatet nga parcela eksperimentale kanë qenë premtuese, me rritje të mirë të bimëve dhe kushte kultivimi të favorshme. Këto rezultate tregojnë potencial, ose për prodhim komercial, ose për studime të mëtejshme për optimizimin e teknikave të kultivimit dhe të mundësive në zinxhirin e vlerës.

Tabela 5. Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të bma-ve

Anët e Forta	Dobësitë
Biodiversitet i pasur dhe klimë e favorshme. Në vend rriten rreth 400 lloje bimësh mjekësore, që përfaqësojnë afërsisht 15% të florës totale, dhe mbi 200 prej tyre mblidhen dhe tregtohen. **Afërsia me tregjet evropiane.** **Kohët e fundit është ngritur në Bulqizë një qendër e re grumbullimi.** **Shembuj të mirë** dhe zgjerim i shpejtë i sipërfaqeve të kultivuara në vend. **BMA-të konsiderohen si një prej potencialeve kryesore** të rinovueshme për zhvillimin social-ekonomik të zonave rurale. **Gatishmëria e grumbulluesve** për të bashkëpunuar me fermerët e zonës. **Gatishmëria për të kultivuar** bimë të përhershme. **Angazhimi i aktorëve kryesorë** të zinxhirit të vlerës për përmirësimin e cilësisë së produktit. **Përfshirja e grave në mbledhjen spontane** dhe kultivimin e bimëve dhe ndërgjegjësimi në rritje i tyre për kontributin që japin. **Një numër gjithnjë e më i madh personash** (si gra, ashtu edhe burra) po merren mbledhjen spontane të bimëve vitet e fundit.	**Fermerët kanë njohuri të kufizuara** për kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA). **Mungesa e burimeve financiare** dhe, rrjedhimisht investime të pamjaftueshme në teknologji dhe përpunim. **Mungesa e certifikimit** për standardet e sigurisë dhe cilësisë. **Mangësi në aftësitë teknike** për kryerjen e të gjitha proceseve (pas vjeljes, tharje, përpunim). **Prani informale** e mbledhësve në treg. **Asimetri në informacionin** për zhvillimet e tregut. **Vendi ku bëhet vjelja e BMA-ve** - ndonjëherë punëtorëve u duhet të shkojnë deri tri orë larg shtëpisë. **Cenueshmëria klimatike** mund të ndikojë në prodhimin e BMA-ve (sidomos të bimëve të egra). **Largësia e vendeve** ku bëhet vjelja e bimëve (mal) nga qendra e grumbullimit. **Puna e rëndë dhe kushte pune të vështira,** sidomos për gratë.
Mundësitë	**Kërcënimet**
Shumëllojshmëria e madhe e specieve të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) në zonë tregon potencial për kultivim. **Mundësi e mirë për të sjellë ndryshim** me investime të vogla, përfshirë trajnimet në zbatimin e praktikave të mira bujqësore. **Zhvillime inovative** dhe përparimi në proceset e tharjes dhe të trajtimit të BMA-ve. **Kërkesë e lartë për BMA** (në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar).	**Speciet bimore të rrezikuara** (mbledhja e bimëve të egra); **Ndikim negativ në biodiversitet** dhe habitatin natyror – vjelja e tepruar e BMA-ve dhe degradimi i mjedisit mund të rrezikojnë jetëgjatësinë e prodhimit të BMA-ve të egra. **Niveli i lartë i emigracionit** që ndikon në numrin e forcave të punës. **Varësia nga kushtet klimatike:** ndryshimet klimatike përbëjnë kërcënim të konsiderueshëm sidomos sepse ndryshimet e motit mund të ndikojnë në rritjen dhe prodhimin e bimëve. **Luhatjet në tendencat e tregut** (ndërkombëtar).

2. Diagram i Zinxhirit të Vlerës të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike

Në vijim paraqitet një diagram gjithëpërfshirës i hallkave të zinxhirit të vlerës, aktorëve, faktorëve mbështetës dhe çështjeve kryesore të identifikuara, bazuar në konstatimet nga intervistat me grupet e interesit dhe agjencitë mbështetëse vendore, puna kërkimore në terren, dhe konsultimet me specialistë.

Diagrami paraqet grupet kryesore të interesit, fazat që nga inputet deri në tregun përfundimtar dhe ndihmon në identifikimin e vështirësive që dalin gjatë hallkave të prodhimit. Vlerat numerike sipër kutive përfaqësojnë kostot dhe vlerën e shtuar për çdo fazë.

Figura 2. Diagram i zinxhirit të vlerës të BMA-ve



2.1 AKTORËT NË ZINXHIRIN E VLERËS

Sikurse shihet në diagramin më sipër, zinxhiri i vlerës i BMA-ve në Bulqizë është i organizuar në një numër të vogël nivelesh kyçe, që janë:

- Mbledhja e bimëve të egra
- Shitjet direkte, dorëzimi/transportimi në qendrën e grumbullimit
- Proceset e pasvjeljes (tharja) dhe tregu me shumicë (që kryhen nga konsoliduesi)

Më poshtë vijon një përshkrim i shkurtër i secilit aktor në zinxhirin e vlerës dhe i agjencive mbështetëse në sistemin e tregut, që nga vjelja/ kultivimi, deri tek grumbullimi, përpunimi dhe shpërndarja përfundimtare në treg.

Furnizuesit e inputeve luajnë rol të rëndësishëm në zinxhirin e vlerës të BMA-ve. Përmes tyre, fermerët sigurojnë farat, fidanët dhe plehrat dhe ata shpesh shërbejnë si burime të rëndësishme informacioni dhe udhëzimesh teknike.

Ofruesit e teknologjisë furnizojnë me veglat dhe pajisjet e domosdoshme për faza të ndryshme të zinxhirit të vlerës të BMA-ve, përfshirë vjeljen, trajtimin pas vjeljes, ruajtjen/magazinimin, tharjen, përpunimin dhe paketimin. Roli i tyre është kritik për përmirësimin e efikasitetit, ruajtjen e cilësisë së produktit, dhe sigurimin e përputhshmërisë me standardet e tregut.

Në Bulqizë nuk ka ofrues të inputeve dhe teknologjisë. Këta individë/kompani kryesisht gjenden në zona me intensitet prodhimi më të madh ose afër sektorëve bujqësore.

Mbledhësit e bimëve të egra (vjelësit) janë individë që jetojnë në zona rurale dhe malore që mbledhin bimë të egra mjekësore dhe aromatike nga mjedisi i zonës ku jetojnë. Ata i thajnë dhe ruajnë bimët në shtëpitë e tyre deri në momentin që ua shesin ato grumbulluesve ose përpunuesve në zonën e tyre.

Në Bulqizë, me këtë aktivitet merren rreth 300 familje (50% gra). Bimët e mbledhura çohen të freskëta në pikën e grumbullimit, ku thahen ose u bëhet përpunimi fillestar, përpara se të shpërndahen më tej. Pjesa më e madhe e personave që punojnë në pikën e grumbullimit janë gra (80%).20

Konsoliduesit vendorë (150)[21] janë magazina ose kompani që veprojnë në zonë dhe që shërbejnë si ndërmjetës midis vjelësve dhe kultivuesve të bimëve të egra dhe përpunuesve në nivel rajoni. Ata luajnë rol thelbësor në zinxhirin e vlerës duke u dhënë vjelësve informacion për çmimet dhe shërbejnë si elementë rregullues kyç të marrëdhënies midis kultivuesve dhe përpunuesve të mëdhenj.

Në Bulqizë ka vetëm një grumbullues kryesor vendor, Lo-Am Medicine, por në zonë veprojnë edhe grumbullues ambulantë, si dhe grumbullues të tjerë në Bashkinë fqinjë të Dibrës.

Konsoliduesit rajonalë (10)[22] janë të vendosur në rrethe të ndryshme të vendit dhe blejnë BMA-të nga konsoliduesit lokalë dhe/ose ambulantë. Këta grumbullues kanë rol kyç në zinxhirin furnizues, duke shërbyer si urë lidhëse midis grumbulluesve vendorë dhe përpunuesve ose eksportuesve të mëdhenj.

Edhe Lo-am Medicine e kryen këtë rol, duke ua çuar produktet e BMA-ve konsoliduesve të mëdhenj. Gjatë vizitës në terren dhe intervistës me pronarin Drilon Voci, u përmend që kompania bashkëpunon me një numër konsoliduesish dhe eksportuesish të mëdhenj që fokusohen në tregtimin e bimëve dhe barishteve të egra.

Përpunuesit e vegjël tregtojnë mesatarisht 150 deri 500 ton BMA në vit. Ata zakonisht kryejnë aktivitete përpunimi dhe paketimi të thjeshtë, me fokus furnizimin e

20. Informacion i dhënë gjatë vizitës në qendrën e grumbullimit Lo-Am, dhe intervistës me pronarin dhe me një punëtore.
21. Biofach 2024. AIDA. Shih: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BIOFACH-24-broshure-1.pdf
22. Po aty.

tregut të brendshëm me produkte si çaji i malit dhe erëza të tjera për gatim. Në ndonjë rast, këto kompani arrijnë t'ua shesin produktet e tyre blerësve ndërkombëtarë.

Përpunuesit e mesëm kanë kapacitet midis 500 dhe 1.000 ton BMA në vit. Në këto kategori bëjnë pjesë rreth 31 kompani, që kanë krijuar lidhje të rregullta eksporti me blerësi ndërkombëtarë. Këto kompani konkurrojnë me njëra tjetrën për mbledhjen dhe marrjen e BMA-ve nga kultivuesit vendorë. [23]

Përpunuesit/eksportuesit e mëdhenj (15) përpunojnë mesatarisht 1.000 deri 1.800 ton bimë mjekësore dhe aromatike në vit. Kjo përbën një pjesë të konsiderueshme të eksporteve të BMA-ve nga Shqipëria. Ata i marrin produktet nga të gjitha nivelet e zinxhirit furnizues, përfshirë nga kultivues të mëdhenj, grumbullues, dhe nga përpunues të vegjël e të mesëm. Këta përpunues/eksportues janë të pajisur me linjat më të avancuara të përpunimit, që u bën të mundur të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe t'u shërbejnë me efektivitet tregjeve botërore.[24]

2.2 SHËRBIMET E MBËSHTETJES DHE KONTROLLIT

Janë katër Agjenci Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB),[25] me qendër në Shkodër, Lushnjë, Korçë, dhe Tiranë, të cilat operojnë nën Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 13.03.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor." Këto agjenci rajonale synojnë të bëhen aktore kyçe në zhvillimin e një sektori konkurrues dhe të qëndrueshëm bujqësor në vend, duke punuar në partneritete afatgjata me përfituesit. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tyre përfshijnë:

- të ofrojnë informacion dhe këshillim për zhvillimin teknik e teknologjik të fermave bujqësore, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi;
- të ofrojnë informacion dhe të asistojnë fermerët për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, IPARD-i dhe projekte të tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të nxisin dhe të ndihmojnë krijimin e funksionimin e formave të ndryshme të kooperimit të fermerëve;
- të organizojnë dhe të kryejnë trajnimin profesional të fermerëve në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të sigurojnë informacion për standardet lidhur me mjedisin, cilësinë, marketingun, bujqësinë organike, produktet me tregues gjeografikë;
- të informojnë dhe të këshillojnë fermerët për përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive e të pajisjeve bujqësore, duke ofruar asistencë teknike pa pagesë.

Pesë Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB)[26] të vendosura në Fushë-Krujë, Shkodër, Vlorë, Lushnjë, dhe Korçë, u krijuan me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 515, datë 19.07.2006, «Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të ministrisë së bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit." Ndër to, QTTB Lushnjë është posaçërisht e fokusuar në perimet. Përgjegjësitë kryesore të QTTB-ve përfshijnë:

- identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen, në praktikat bujqësore, të metodave dhe materialeve (inputeve) të reja;
- përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e bagëtive;
- kërkime dhe testime në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatëse;

23. Të dhëna të konsoliduara nga Biofach 2024. AIDA. Shih: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BIOFACH-24-brochure-1.pdf, Studim i sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike. MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf, dhe Studim për sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike. AASF, 2023. Shih: https://aatsf.com.al/wp-content/uploads/2020/04/4Mapcover-EN.pdf

24. Po aty.

25. Shih: https://bujqesia.gov.al/drejtorite-e-bujqesise/, dhe https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/2.1-struktura-AREB-TIRANE.doc

26. Shih: https://bujqesia.gov.al/qendrat-e-transferimit-te-teknologjive-bujqesore-qttb/

- trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjera të interesuara;
- sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët;
- demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë;
- përgatitjen dhe publikimin e materialeve informuese për specialistët e bujqësisë dhe fermerët;
- mbështetjen e hartimit të politikave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural.

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)[27] është përgjegjës për garantimin e shëndetit dhe sigurisë së kafshëve, bimëve dhe prodhimeve bujqësore në Shqipëri. Ai operon në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe luan rol kyç në mbrojtjen e shëndetit të publikut, promovimin e qëndrueshmërisë bujqësore dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore. Ndër përgjegjësitë kryesore të AKVMB-së përfshihen:

- **Shërbimet veterinare:** Monitorimi dhe kontrollimi i shëndetit të kafshëve, parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, dhe garantimi i sigurisë ushqimore në produktet me prejardhje shtazore.
- **Mbrojtja e bimëve:** Zbatimi i masave fitosanitare për parandalimin dhe kontrollimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve që mund të dëmtojnë prodhimin bujqësor.
- **Roli rregullator për pesticidet dhe plehrat:** Mbikëqyrja e importit, shpërndarjes, dhe përdorimit të pesticideve dhe plehrave, duke siguruar përmbushjen e standardeve të sigurisë.
- **Siguria ushqimore dhe inspektimi:** Kryerja e inspektimeve të fermave, mjediseve të përpunimit ushqimor, dhe tregjeve, për të siguruar që produktet përmbushin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.
- **Kontrolli kufitar dhe biosiguria:** Menaxhimi i inspektimeve kufitare veterinare dhe fitosanitare për parandalimin e hyrjes së dëmtuesve, sëmundjeve dhe produkteve të pasigurta ushqimore në vend.
- **Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit:** Hartimi dhe zbatimi i ligjeve, politikave dhe rregulloreve që lidhen me shërbimet veterinare dhe mbrojtjen e bimëve.
- **Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimet:** Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes për fermerët, veterinerët dhe specialistët bujqësorë për përmirësimin e praktikave më të mira në menaxhimin e shëndetit të bimëve dhe të kafshëve.

AKVMB e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është organizuar në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel rajonal, nëpërmjet katër drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve në Elbasan, Vlorë, Shkodër, dhe Tiranë. Drejtoritë rajonale veprojnë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë dhe kryejnë këto detyra:

- vlerësojnë nevojat dhe problematikat që lidhen me shërbimet veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve, dhe i propozojnë zgjidhje Drejtorisë së Përgjithshme;
- planifikojnë nevojat për shërbime veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve dhe ia paraqesin ato Drejtorisë së Përgjithshme;
- koordinojnë dhe monitorojnë ofrimin e shërbimeve veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve në territorin e tyre;
- përgatisin raporte për marrjen e kampioneve, materialeve patologjike dhe rezultateve të analizave për sëmundje të dyshuara dhe konfirmuara;
- hartojnë raporte periodike për shkallën e infeksionit të bimëve dhe statusin e produkteve bimore;
- detajojnë dhe zbatojnë planet e punës të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

27. Shih: https://akvmb.gov.al/

- lëshojnë dokumente dhe certifikata sipas dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe autorizimeve të Drejtorisë së Përgjithshme;

- kryejnë detyra të tjera të ngarkuara sipas ligjit ose sipas urdhrave të Drejtorisë së Përgjithshme.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)[28] është një institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjës për inspektime dhe menaxhim në fushat e mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe mbarështimit të kafshëve. AKU funksionon sipas Ligjit nr. 10433, datë 16.06 2011, «Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë», konkretisht neni 7, «Parimi i programit të inspektimeve». Koha e kryerjes së inspektimeve përcaktohet në programin vjetor të inspektimeve, por kryhen edhe inspektime rastësore kur kërkohet nga ligji. Neni 4 i të njëjtit ligj përcakton qëllimet e inspektimeve, ku përfshihen: i) vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore; ii) dokumentimi i praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore; iii) këshillimi i subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore; iv) urdhërimi i korrigjimit të shkeljeve ligjore dhe eliminimit të pasojave të tyre; dhe, v) dhënia e dënimeve dhe marrja me masave administrative për shmangien e rreziqeve ndaj interesit publik.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në Shqipëri është organi rregullator përgjegjës për garantimin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore dhe respektimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. AKU mbikëqyr të gjithë hallkat e furnizimit ushqimor, që nga prodhimi dhe përpunimi, deri tek shpërndarja dhe konsumi, dhe synon mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurisë së ushqimeve. Detyrat kryesore të tij përfshijnë:

- mbikëqyrjen dhe inspektimin e prodhimit, përpunimit të ushqimit dhe të mjediseve të shpërndarjes;

- garantimin e respektimit të rregulloreve dhe standardeve të sigurisë ushqimore;

- kryerjen e kontrolleve të cilësisë së ushqimeve dhe testimeve për të parandaluar kontaminimin dhe garantuar sigurinë e ushqimeve;

- zbatimin e ligjeve për sigurinë ushqimore dhe të rregulloreve të vendosura nga qeveria;

- koordinimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për harmonizimin e praktikave të sigurisë ushqimore;

- udhëzimin dhe trajnimin e bizneseve dhe palëve të interesit në industrinë ushqimore në lidhje me praktikat më të mira;

- lëshimin e certifikatave dhe miratimeve për prodhime ushqimore, sipas ligjit.

Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF),[29] me seli në Tiranë, është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ai financohet nga buxheti i shtetit dhe ka si objekt të punës së tij zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Misioni i ESHFF-së përfshin:

- mbrojtjen e interesave të fermerëve;

- shtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

- prezantimin e varieteteve të reja në treg;

- përmirësimin e treguesve të cilësisë të materialit mbjellës që tregtohet;

- sigurimi i një konkurrence të ndershme në treg.

- Institucioni monitoron rrjetin zonal për prova krahasuese për testimin e varieteteve të reja të prodhuara në vend ose të importuara, për riprodhim, shumëzim e tregtim. Mbi bazën e rezultateve të këtyre provave krahasuese dhe metodave laboratorike, ESHFF-ja bën vlerësimin dhe regjistrimin e varieteteve në Katalogun Kombëtar.

Sektori i bujqësisë në Bashkinë Bulqizë (i përbërë nga shtatë burra dhe një grua) aktualisht fokusohet vetëm në mbledhjen e të dhënave të cilat ia raporton INSTAT-it, por nuk u ofron shumë mbështetje fermerëve përmes shërbimeve të ekstensionit, të cilat janë shumë

28. Shih: https://aku.gov.al/
29. Shih: http://www.eshff.gov.al/

të rëndësishme për të përmirësuar praktikat bujqësore dhe për të rritur produktivitetin.30

Certifikimi Standardet bazë janë Analiza e Rreziqeve dhe Pikat Kritike të Kontrollit (HACCP) dhe Certifikimi Organik.

HACCP[31] është një standard ndërkombëtar që bazohet në parimet e FAO/WHO Codex Alimentarius Commission (Komisioni Codex Alimentarius i FAO-s dhe OBSH-së), dhe përfshin një grup të plotë parimesh mbi higjienën dhe sigurinë ushqimore. Ai është një sistem parandalues për menaxhimin e sigurisë ushqimore, që është i detyrueshëm për të gjitha bizneset ushqimore, në përputhje me Rregulloret Evropiane (EC) 178/2002[32] dhe 852/2004[33], si dhe me Udhëzimin Kombëtar nr. 20 20, datë 25.11.2010, të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.[34]

Procesi i certifikimit HACCP zakonisht zgjat nga 14 deri 30 ditë, në varësi të kërkesave konkrete të biznesit përkatës, dhe përfshin:

- Vizitë tek biznesi: Biznesi vizitohet nga një kompani konsulente e specializuar në vlerësimin e proceseve të punës dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësime dhe përshtatje me qëllim plotësimin e standardeve të HACCP-së.

- Përgatitja e dokumentacionit: Biznesi duhet të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ku përfshihen evidenca, procedura dhe plane që lidhen me sigurinë dhe higjienën ushqimore.

- Krijimi i sistemeve për mbajtjen e dokumentacionit: Duhet të ngrihet një sistem për mbajtjen e dokumentacionit dhe të dhënave, për të garantuar që procedurat e sigurisë ushqimore të jenë të dokumentuara siç duhet dhe të gjurmueshme.

- Inspektimi nga organi certifikues: Organi certifikues inspekton biznesin për të siguruar plotësimin e të gjitha kritereve të HACCP-së dhe kontrollon si dokumentacionin, ashtu edhe praktikat e ndjekura.

- Lëshimi i certifikatës: Pas inspektimit të suksesshëm, trupa certifikuese lëshon certifikatën HACCP, që konfirmon se biznesi përmbush standardet e sigurisë ushqimore.

Certifikimi organik është një proces i gjatë, por me vlerë, sepse jep akses në tregjet globale dhe u mundëson bizneseve t'i marketojnë produktet e tyre si organike, me çmime më të larta dhe kërkesë më të madhe. Ky është një proces që siguron që produktet të prodhohen sipas standardeve specifike të bujqësisë organike, që fokusohet në qëndrueshmërinë dhe ruajtjen e mjedisit, dhe përjashtimin e kimikateve sintetike dhe organizmave të modifikuara gjenetikisht (OMGJ).

Certifikimi kërkohet për bizneset që dëshirojnë t'i reklamojnë dhe shesin produktet e tyre si 'organike', sidomos në tregjet ndërkombëtare. Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar kohët e fundit Ligjin nr. 104/2024 "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre".[35]

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe i rregullave për prodhimin organik, certifikimin dhe përdorimin e treguesve që i referohen prodhimit organik në etiketim dhe reklamim. Ai gjithashtu përcakton rregullat për kontrollin zyrtar, përveç sa parashikohet në legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare. Fazat kyçe për certifikimin organik janë:

- Aplikimi fillestar: Biznesi dorëzon aplikimin në organin e akreditуar të certifikimit organik.

- Inspektimi i fermës ose operatorit: Kryhet një inspektim në terren nga trupa certifikuese për të siguruar respektimin e standardeve të bujqësisë organike dhe të përpunimit organik. Ky inspektim përfshin kontrollin e dokumenteve, metodave të prodhimit dhe praktikave mjedisore.

30. Konstatime nga takimet dhe intervistat me përfaqësues të bashkisë dhe aktorë të zinxhirit të vlerës.
31. Shih: https://aku.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Udhezim_Nr.20.pdf
32. Shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32002R0178
33. Shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32004R0852
34. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb144203.pdf
35. Ky ligj është pjesërisht i harmonizuar me Rregulloren e BE-së nr. 2018/848 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 30 maj 2018, mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, që shfuqizoi Rregulloren e Këshillit nr. 834/2007. Për më shumë shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/ligj-nr.-104-dt.-19.9.2024-prodhimi-organik.docx

Certifikimi organik ndihmon prodhuesit e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike, përfshirë shumë gra në zonat rurale, të arrijnë tregje me vlerë më të lartë duke përmbushur standarde të rrepta të qëndrueshmërisë dhe cilësisë.

- Mbajtja e dokumentacionit dhe e të dhënave: Bizneset duhet të mbajnë dokumentacion të hollësishëm të praktikave të tyre bujqësore (plehrat, pesticidet, etj.) rotacionin e kulturave bujqësore, menaxhimin e tokës dhe praktika të tjera përkatëse. Ky dokumentacion ndihmon garantimin e transparencës dhe gjurmueshmërisë.

- Rishikimi i praktikave dhe procedurave: Trupa certifikuese shqyrton praktikat e biznesit dhe i krahason ato me standardet organike. Kjo përfshin garantimin e mospërdorimit të substancave të ndaluara (si kimikate sintetike apo OMGJ) dhe që metodat e prodhimit mbështesin ruajtjen afatgjatë të një mjedisi të shëndetshëm.

- Vendimi i certifikimit: Pas inspektimit dhe shqyrtimit, trupa certifikuese merr një vendim. Në qoftë se biznesi konstatohet se i përmbush standardet organike, ai merr certifikatën organike.

- Inspektime në vijimësi: Certifikimi organik kërkon inspektime dhe auditime të përvitshme për vazhdimin e certifikimit. Bizneset duhet të vazhdojnë t'u përmbahen standardeve dhe çdo ndryshim në praktika duhet të dokumentohet dhe miratohet.

Procesi i certifikimit zakonisht zgjat 2-3 vjet, sepse bizneset duhet të tregojnë se u janë përmbajtur praktikave organike për të paktën atë periudhë. Gjatë kësaj kohe, bizneseve u jepet statusi i ndërmjetëm "në proces certifikimi organik."

Operatorët më të mëdhenj të eksportit të BMA-ve janë të certifikuar sipas Standardit Organik Evropian dhe Standardit Organik të SHBA-së (që përfaqësojnë tregjet kryesore për BMA-të shqiptare).
Certifikimi organik kryhet nga disa organe certifikuese: Ecocert SA, ICEA, BCS, OkoGarantie GmbH, BioInspecta AG, CERES GmbH, Control Union Certifications B.V., IMO CH, IMC srl. Historikisht, i vetmi organ vendor i certifikimin në Shqipëri ka qenë Bio-inspecta (më parë Alb-inspect), që është akreditуar nga shërbimet akredituese zvicerane.[36]

Shoqatat Ka vetëm dy shoqata kryesore: Shoqata e Kultivuesve të Bimëve Mjekësore dhe e Prodhuesve të Esencave Eterovajore (EPCA) dhe Shoqata e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike e Shqipërisë (ABMA). Nuk ka ndonjë shoqatë të prodhuesve të BMA-ve që të mbrojë interesat e tyre dhe të aktorëve të tjerë në zinxhirin e vlerës të BMA-ve në shkallë kombëtare. E vetmja organizatë në nivel kombëtar është KASH (Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar), i cili është një organizatë/federatë ombrellë që mbulon të gjithë sektorët kryesorë agroushqimorë në Shqipëri, ndër të cilët edhe BMA-të. Pjesa më e madhe e aktorëve (vjelësit/rritësit, grumbulluesit/konsoliduesit dhe përpunuesit/eksportuesit) nuk janë të angazhuar në ndonjë prej shoqatave (DSA, 2023). Mungesa e pjesëmarrjes së gjerë ka çuar në mundësi të humbura për promovimin e praktikave të mira bujqësore për kultivimin dhe mbledhjen e BMA-ve dhe për kontrollin e sigurisë ushqimore.

36. *Quality and standards for sustainable trade of Medicinal dhe Aromatic Plants* (Cilësia dhe standardet për tregtim të qëndrueshëm të bimëve mjekësore dhe aromatike). GQSP. UNIDO, 2023. Shih: https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/UNIDO%20GQSP%20ALBANIA%20Medicinal%20Aromatic%20Plants%20Value%20Chain%20STUDY%202023.pdf

2.3 KONSTATIMET E STUDIMIT

Bazuar në punën në terren, vrojtimet, dhe intervistat e kryera me aktorë kyç në zinxhirin e vlerës (dy gra dhe dy burra), ndër të cilët prodhues dhe përpunues, si dhe specialistë të zinxhirit të vlerës të BMA-ve, u identifikuan të dhënat në vijim.

Mundësitë:

- Rritja e kërkesës për BMA-të në të gjithë vendin. Ka pasur një rritje të ndjeshme të kërkesës për BMA në rajon dhe në të gjithë vendin, e nxitur nga kërkesa në treg. Kjo është e lidhur drejtpërdrejt edhe me shumëllojshmërinë e madhe të produkteve të disponueshme, si edhe me periudhën pas Kovid-19 dhe me kërkesën në rritje nga tregjet ndërkombëtare.[37]

- Kultivimi i BMA-ve duket se është një mundësi e mirë për t'i angazhuar fermerët, bazuar në progresin e nismave në vend deri tani. Aktualisht në Dibër kultivohen me BMA rreth dhjetë hektarë. Analiza të kryera më parë kanë treguar që zona ka të gjitha kushtet agroteknike të nevojshme për kultivimin e disa bimëve. Gratë theksuan se bimët e përhershme me një vjelje sezonale në vit janë më të përshtatshme për kushtet e tyre. Kultivimi mbi bazën e praktikave më të mira bujqësore shton sasinë e prodhimit dhe në të njëjtën kohë siguron cilësinë në përputhje me kërkesat e tregut ndërkombëtar.
  - Duke bërë kalimin nga mbledhja e bimëve të egra në kultivim, gratë do të shtojnë të ardhurat dhe do të përmirësojnë kushtet e punës së tyre.[38] Kjo do të kërkojë investime, duke filluar që nga farat/fidanët dhe deri në trajnimet për praktikat e mira bujqësore.

- Plotësimi i kërkesave të standardeve dhe marrja e certifikatave të cilësisë do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e procesit dhe rritjen e vlerës së produkteve, gjë që do të çojë në rritjen e kërkesës për produkte të BMA-ve, rritjen e çmimeve të shitjes dhe shtimin e të ardhurave për njësi.
  - Nevojiten më shumë njohuri, sidomos për zbatimin e standardeve, certifikimin dhe zbatimin e praktikave më të mira në të gjitha fazat e kultivimit.

- Organizimi i fermerëve, sidomos i grave, në grupe, pakëson kostot në sigurimin e inputeve, përdorimin e përbashkët të pajisjeve dhe kostot e tregut; unifikon dhe garanton cilësinë e produktit; mundëson rritjen e kapaciteteve të aktorëve në të gjithë hallkat e zinxhirit të vlerës dhe rrit rolin e tyre në zinxhirin e vlerës.

- Mundësitë për zbatimin e praktikave të mira bujqësore në kultivimin e BMA-ve:

- Përmirësimi i kushteve të punës të grave të angazhuara në ZV-në e BMA-ve.

- Të gjitha punëtoret duhet të trajnohen, sidomos për menaxhimin e kimikateve bujqësore/plehrave, higjienën dhe ndihmën e parë.

- Pajisje mbrojtëse personale, mbi të gjitha gjatë përdorimit të kimikateve bujqësore.

- PMB në kultivim (historia e parcelës; inspektimi; analiza e dheut; rreziku i kontaminimit; përgatitja e fushës' fara/fidanë të certifikuar' mbjellja dhe transplantimi; plehrat organike dhe kimike; ujitja; kujdesi për bimët dhe mbrojtja e bimëve; proceset e vjeljes dhe pas vjeljes (përpunimi fillestar dhe tharja); paketimi; magazinimi dhe transporti; etj.)

Kufizimet:

- Shumica e aktiviteteve janë informale, që do të thotë se punëtorët dhe prodhuesit (sidomos gratë) shpesh nuk janë të regjistruar në zyrat ose autoritetet tatimore. Si rezultat, ato humbin të drejtën të përfitojnë nga skemat e subvencioneve, të sigurimeve shëndetësore, pensioneve dhe nga programe dhe projekte të ndryshme. Përveç kësaj, fakti që gratë nuk janë të

37. Shih: https://invest-in-albania.org/the-economic-potential-of-medicinal-and-aromatic-plants-in-albania/
38. Shih: https://www.fao.org/4/y4586e/y4586e08.htm

regjistruara përbën vështirësi për të përcaktuar gamën e plotë të pjesëmarrjes së tyre në ZV.

- Vendet ku kryhen proceset e mbledhjes spontane të bimëve shpesh gjenden rreth tri orë larg qendrave të banuara dhe, sidomos gjatë stinës së vjeljes, kjo mund të krijojë vështirësi për kryerjen e të gjitha proceseve të nevojshme. Po kështu, largësitë e mëdha ulin cilësinë e produktit për shkak të kushteve në të cilat transportohen bimët deri sa arrijnë në qendrat e grumbullimit.

- Gjendja ekonomike e familjeve. Shpesh përfshirja në këtë aktivitet është burimi kryesor i të ardhurave për pjesën më të madhe të familjeve .[39] Për shkak të informalitetit, banorët janë të përjashtuar edhe nga skemat e subvencioneve dhe mundësitë financiare.

- Cilësia e ulët e produktit, që çon në çmime të ulëta të shitjes. Mungesa e aftësive profesionale dhe e certifikimit të cilësisë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e prodhimeve. Ka raste kur produkti i vjelë/kultivuar humbet cilësinë gjatë procesit të tharjes, ose gjatë paketimit të papërshtatshëm për ruajtje dhe transport.

Më poshtë jepen problemet kryesore të identifikuara në kultivimin e BMA-ve në Bulqizë. Më konkretisht, problemet (kufizimet) lidhen me:

Fazën e garantimit të inputeve:
- Certifikimi 'organik' dhe i fidanëve
- Analiza e tokës – e certifikuar
- Pronësia e tokës – aksesi në financim/regjistrim (ndihmë tjetër)

Fazën e kultivimit:
- Aftësitë e kultivimit dhe vjeljes, sidomos për bimët tradicionale (si, kur, pse, çfarë)
- Mjete dhe pajisje pune të përshtatshme për gratë
- Mungesa e ofruesve të shërbimeve për zbatimin e praktikave të mira bujqësore
- Infrastruktura (pajisjet) dhe kualifikimet për procesin pas vjeljes në fermat e vogla

Fazën e pasvjeljes dhe të tharjes:
- Mungesë e kontrollit të cilësisë
- Mungesë e mjediseve të përshtatshme dhe pajisje të pamjaftueshme për proceset pas vjeljes dhe përpunim në fermat e vogla
- Mungesë paketimi cilësor
- Njohuri të kufizuara për proceset e mësipërme

Fazën e tregtimit:
- Mungesë e brandit, etiketimit dhe paketimit sipas kërkesave ligjore (përpunim në shkallë të vogël për konsumatorët përfundimtarë në treg, me fokus grupin e grave të Reçit)
- Kapacitete të përshtatshme për ruajtjen e produktit final
- Lidhjet në treg
- Njohuri për zhvillimet në treg dhe kërkesat e tregut
- Promovimi

Në lidhje me çështjet e pabarazisë gjinore dhe të përfshirjes së grave në zinxhirin e vlerës, informacioni i mbledhur nga takimet dhe intervistat tregon se rreth 150 gra/vajza në të gjithë bashkinë, sidomos nga njësitë administrative të Zerqanit, Shupenzës, dhe Gjoricës,[40] janë të përfshira në pjesën më të madhe të aktiviteteve të punës, sidomos në proceset e mbledhjes spontane të bimëve, ndërkohë që kontribuojnë edhe në kryerjen e punëve të shtëpisë. Kjo do të thotë se gratë/vajzat e reja që merren me mbledhjen e bimëve të egra larg nga shtëpia, kanë ngarkesë të dyfishtë. Palët e interesit dhe specialistët theksojnë se ekzistojnë mundësi për kultivimin e bimëve më afër shtëpive të tyre, që mund të çojë në përmirësimin e cilësisë, sasisë, dhe të kontrollit të grave mbi burimet, si dhe do të ofrojë mundësi për kultivimin e bimëve që vlerësohen dhe kërkohen më shumë në treg.[41] Aftësitë tradicionale për identifikimin dhe mbledhjen e bimëve zakonisht përcillen nga brezi në brez. Gratë/vajzat që kryejnë proceset e kultivimit, vjeljes, dhe të grumbullimit dhe ndoshta edhe në tharjen e produktit, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zinxhirin e vlerës, dhe konsoliduesit varen nga aftësitë e tyre për sigurimin e cilësisë së produktit. Gratë/vajzat rrallë përfshihen në proceset e vendimmarrjes; autoritet vendimmarrës për proceset e menaxhimit të biznesit, mundësitë e financimit, etj.

Në lidhje me mundësitë e financimit, për shumë familje, ky lloj aktiviteti është burimi vetëm i fitimit të të ardhurave. Zakonisht fitimet merren pasi sasia e mbledhur është çuar në qendrën e grumbullimit. Aktualisht, duke qenë se zinxhiri i vlerës bazohet vetëm në mbledhjen spontane të bimëve, mundësitë e financimit janë shumë të ulëta, për të mos thënë inekzistente.

39. Studim i sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike. MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf
40. Informacion nga pronari i LO-AM Medicine, Drilon Voci.
41. Shih: https://tetratechintdev.exposure.co/womens-economic-empowerment-in-albania

2.4 NDËRHYRJE TË REKOMANDUARA PËR ZINXHIRIN E VLERËS TË BMA-VE NË BULQIZË

Në vijim jepen disa rekomandime të përgjithshme për zhvillimin e zinxhirit të vlerës së BMA-ve në Bashkinë Bulqizë, Dibër, kategorizuar sipas impaktit:

1. Mbështetja e tranzicionit nga mbledhja e bimëve të egra në kultivimin e tyre:

- **Forcimi i praktikave të mira bujqësore (PMB)**: është shumë e rëndësishme të përmirësohen praktikat e kultivimit të bimëve mjekësore dhe aromatike duke u fokusuar në praktikat e mira bujqësore. Kjo përfshin trajnimin në aspekte si analiza e tokës, vlerësimi i rrezikut të kontaminimit, përgatitja e arave, përdorimi i farave dhe fidanëve të certifikuar, mbjellja, transplantimi, plehërimi, ujitja, mirëmbajtja dhe mbrojtja e bimëve. Përveç kësaj, praktikat e vjeljes efikase, trajtimit pas vjeljes, tharjes, ruajtjes, dhe transportimit duhet të forcohen për të ruajtur cilësinë dhe vlerën e tregut të produkteve. Këtu duhet të përfshihen edhe trajnime të specializuara për agrokimikate, menaxhim të plehrave, higjienën dhe ndihmën e parë, për përmirësimin e këtyre praktikave në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

2. Asistencë teknike:

- **Analiza e tokës dhe material shumëzues i certifikuar**: Ndihma për kryerjen e analizave të tokës është thelbësore për të siguruar kushte optimale për kultivimin e BMA-ve. Mundësimi i aksesit në material shumëzues të certifikuar (fara dhe fidanë) dhe mbështetja për replikimin e fidanëve në fermë do të çojë në rritje të aktivitetit dhe do të sigurojë furnizim të qëndrueshëm për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit në të ardhmen. Kjo nismë duhet të fillohet menjëherë dhe të vazhdojë në periudhën afatgjatë për të garantuar suksesin dhe zgjerimin e kultivimit të BMA-ve.

- **Grante të vogla për përmirësime në proceset e vjeljes dhe pasvjeljes**: Duhet të sigurohen grante të vogla për të përmirësuar praktikat e vjeljes dhe të pasvjeljes në ferma. Këtu mund të përfshihen grante për pajisje si thasë për ruajtje dhe transport. Këto investime do të ndihmojnë ruajtjen e cilësisë së produkteve nga vjelja deri në treg dhe duhet të zbatohen në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

- **Mjete pune personale dhe mbrojtëse**: Sigurimi i mjeteve mbrojtëse personale për punëtorët, sidomos për përdorimin e agrokimikateve, është me rëndësi thelbësore për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e personave të përfshirë në kultivimin e BMA-ve. Kjo mbështetje duhet të jetë e vazhdueshme, në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

3. Certifikimi i cilësisë dhe standardet e sigurisë:

- **Vetëdijesimi për certifikimin**: është e rëndësishme që prodhuesit të ndërgjegjësohen për vlerën e certifikimeve dhe se si ndihmojnë ato për të pasur akses në tregje të mëdha. Procesi i marrjes së certifikatave, si për shembull i certifikatave të produkteve organike, duhet të shpjegohen qartë për të siguruar që prodhuesit i kuptojnë hapat që duhet të bëjnë. Ky proces ndërgjegjësimit duhet të kryhet në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë dhe të vazhdojë të kryhet sipas kërkesave të tregut.

- **Mbështetje për certifikim organik**: Prodhuesit duhet të ndihmohen për marrjen e certifikimit organik, duke siguruar që prodhimet e tyre të përmbushin standardet e kërkuara. Kjo ndihmë duhet të fillojë në periudhën afatmesme dhe të vazhdojë në periudhën afatgjatë për t'i ndihmuar prodhuesit e BMA-ve të mbeten konkurrues në tregjet ndërkombëtare.

- **Këshillim dhe mentorim**: Ofrimi i këshillimit dhe mentorimit për prodhuesit në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë do të mbështesë rritjen e biznesit të tyre dhe do t'i ndihmojë që të orientohen më mirë nëpër problematikat e zinxhirit të vlerës të BMA-ve. Kjo do të sigurojë që ata të përmirësohen vazhdimisht dhe t'u përmbahen kërkesave të tregut.

4. Mbështetje për grupet e prodhuesve:

- **Organizimi i grave në grupe**: Organizimi i grave në grupe është një strategji kyçe për përmirësimin e përfaqësimit dhe rolit të tyre në zinxhirin e vlerës të BMA-ve. Këto grupe i fuqizojnë gratë që të kenë një zë më të fuqishëm në treg dhe do të

jenë të rëndësishme për krijimin e një sektori më të shëndoshë dhe konkurrues. Kjo nismë duhet të ndiqet në periudhën afatmesme dhe të vazhdohet edhe në afat të gjatë.

- **Ndërtimi i kapaciteteve të grave fermere**: Pajisja e grave fermere me njohuri për planifikimin e biznesit, krijimin e lidhjeve të biznesit, marketing, dhe identifikimi i mundësive të financimit janë thelbësore për fuqizimin e grave që ato të kenë sukses në zinxhirin e vlerës të BMA-ve. Trajnimi në këto fusha duhet të zbatohet në periudhën afatmesme, me mbështetje të vazhdueshme edhe në periudhën afatgjatë.

- **Lidhje të qëndrueshme me konsoliduesit**: Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme midis grupeve prodhuese dhe konsoliduesve vendorë, rajonalë dhe kombëtarë do të ndihmojë stabilizimin e tregut dhe do të sigurojë që prodhuesit të kenë blerës të sigurt. Marrëveshjet paraprake mund të nxisin prodhimin dhe të garantojnë akses në treg. Këto marrëdhënie duhen ushqyer në periudhën afatmesme dhe të vazhdojnë edhe më tej në periudhën afatgjatë, për të siguruar suksesin në vijimësi të zinxhirit të vlerës të BMA-ve.

Rekomandimet e mësipërme ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse për forcimin e zinxhirit të vlerës të BMA-ve, me fokus mbi asistencën teknike, certifikimin, fuqizimin e grave dhe përmirësimin e aksesit në treg përmes partneriteteve të forta. Këto veprime do të ndihmojnë krijimin e një zinxhiri vlere më të qëndrueshëm dhe me fitim për prodhuesit e BMA-ve në Shqipëri.

Tabela 6. Rekomandime për zinxhirin e vlerës të BMA-ve

Nr.	Veprimtaria	Impakti		
		Afatshkurtër	Afatmesëm	Afatgjatë
1	**Mbështetja e tranzicionit nga mbledhja e bimëve të egra në kultivim**			
1.1	Forcimi i praktikave të mira bujqësore (PMB) në kultivimin e BMA-ve, duke përmirësuar teknikat e vjeljes dhe trajtimin pas vjeljes, përfshirë tharjen, ruajtjen dhe transportimin në mënyrën e duhur. Fushat kryesore për t'u fokusuar janë: o Menaxhimi i parcelës: historia, inspektimi, analiza e tokës, dhe vlerësimi i rrezikut të kontaminimit. o Mbështetje me përzgjedhjen e bimëve për kultivim, bazuar në kërkesat agroteknike të zonës, kërkesave të tregut dhe kushteve dhe nevojave të grave o Praktikat e kultivimit: përgatitja e arës, përdorimi i farave/fidanëve, mbjellja, transplantimi, plehërimi, ujitja, kujdesi për bimët, dhe mbrojtja e bimëve. o Vjelja dhe pasvjelja: vjelje, përpunim fillestar, tharje, paketim, ruajtje, transportim efikas për ruajtjen e cilësisë dhe vlerës në treg. o Trajnime, sidomos për menaxhimin e agrokimikateve/plehrave, higjienën dhe ndihmën e parë.	X	X	X
2	**Asistenca teknike**			
2.1	o Analiza e tokës/dheut o Parcela eksperimentale/demonstruese me bimë të caktuara o Mbështetje me material shumëzues të certifikuar o Mbështetje me replikimin e fidanëve për të zgjeruar prodhimin dhe për të siguruar furnizim të qëndrueshëm për zgjerim të aktivitetit në të ardhmen	X	X	X
2.2	Grante të vogla për përmirësimin e proceseve të vjeljes dhe pasvjeljes në ferma (për pajisje si thasët për ruajtje dhe transport, etj.)	X	X	X
2.3	Mjete pune personale dhe mjete mbrojtëse, sidomos për përdorimin e agrokimikateve.	X	X	X

Nr.	Veprimtaria	Impakti		
		Afatshkurtër	Afatmesëm	Afatgjatë
3	**Certifikimi i cilësisë dhe standardet e sigurisë**			
3.1	Seanca ndërgjegjësimi për rëndësinë e certifikimit për të pasur akses në tregjet e mëdha dhe hapat e nevojshëm për certifikim.	X	X	X
3.2	Ofrimi i mbështetjes për prodhuesit që të marrin certifikim organik, duke siguruar përmbushjen e standardeve.		X	X
3.3	Këshillimi dhe mentorimi.	X	X	X
4	**Mbështetje për grupet prodhuese**			
4.1	Organizimi i grave në grupe për rritjen e përfaqësimit dhe rolit të tyre në zinxhirin e vlerës.		X	X
4.2	Ndërtimi i kapaciteteve të grave fermere lidhur me njohuritë bazë për planifikimin e biznesit, marrëdhëniet e biznesit, marketing, mundësitë e financimit, etj.		X	X
4.3	Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme midis grupeve prodhuese dhe konsoliduesve lokalë/rajonalë dhe/ose kombëtarë për promovimin e prodhimit bazuar në marrëveshje paraprake.	X	X	X

Partnerët/bashkëpunimi në nivel vendor: shoqatat kombëtare të BMA-ve; bashkia, drejtoria e bujqësisë, konsoliduesit vendorë. Zinxhiri i vlerës i BMA-ve në Bulqizë është relativisht i ri dhe në hapat e para, krahasuar me zona të tjera që kanë më shumë përvojë në këtë fushë. Pjesa më e madhe e BMA-ve mblidhen si bimë të egra dhe nuk kultivohen, megjithëse vitet e fundit disa fermerë kanë filluar kultivimin e BMA-ve me të njëjtën cilësi si bimët e egra (të cilat, megjithatë, janë më të forta). Konsoliduesi i zonës, Lo-Am Medicine, është shumë i gatshëm të promovojë dhe mbështesë tranzicionin në kultivim; madje në fakt kanë filluar edhe parcela të vogla eksperimentale afër qendrës së grumbullimit.

Pjesa 3

Analizë e Zinxhirit të Vlerës të Punimeve Artizanale

1. Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës të Punimeve Artizanale

Artizanati ka një vend të veçantë në trashëgiminë kulturore të Bashkisë Bulqizë. Kostumet popullore janë një manifestim i vërtetë i artit popullor. Të përgatitura me shumë mund, plot stil dhe hijeshi, ato sot përcjellin traditën e pasur të kësaj zone.

Larmia e kombinimeve të ngjyrave dhe detajeve i bëjnë këto kostume të mahnitshme. Në secilin element të tyre gjen një copëz art, që vjen nga shpirti i pasur i grave dhe vajzave të Bulqizës.Gratë e zonës vazhdojnë të merren me artizanat edhe sot. Veshjet popullore të Bulqizës janë ndër më të veçantat në Shqipëri dhe vazhdojnë të qepen nga artizanet e zonës, si dhe të tregtohen, duke u kthyer në biznese të vogla familjare. Ato përdoren gjithashtu edhe në ceremonitë e dasmave të zonës, si një mënyrë për të ruajtur traditën e të parëve.Veshja e grave përbëhet nga *qasha* prej leshi, e zezë për gratë dhe e kuqe për vajzat, jeleku i zbukuruar me argjend, barkore e bardhë para dhe një brez i kuq prej leshi në mes, këmishë atlasi me mëngë të gjata, shamia e kokës - jepeku – me ngjyra të ndezura, të brendshme dhe çorape të bardha, mitan me ngjyra ose tabes në vend të këmishës. Një nga elementët e kostumit popullor, qasha, është një veshje që është trashëguar brez pas brezi dhe është përdorur edhe pas viteve 1990. Sipas gojëdhënave popullore, qasha është elementi kryesor i kostumit popullor, trashëguar që nga koha e Skënderbeut.

Në qytetin e Bulqizës, dhjetë gra kanë ruajtur dhe mbajtur gjallë teknikat tradicionale artizanale në shtëpitë e tyre, duke prodhuar produkte të mrekullueshme të bëra me dorë që mishërojnë trashëgiminë e pasur kulturore të zonës. Ndër to, Rabije Alla (62 vjeç), Selvie Karaj (60 vjeç), dhe Tana Shkina (55 vjeç) janë artizane me përvojë që i kanë kushtuar dekada të tëra perfeksionimit të mjeshtërisë së tyre, duke krijuar qëndisma të imta dhe pëlhura dekorative, bazuar në njohuri të thella të përcjella brez pas brezi. Arjana Shehu (28 vjeç) është specialiste e krijimeve me rruaza – ajo bën bizhuteri delikate dhe aksesorë dekorativë. Lëndët e para gratë i marrin kryesisht nga Tirana – të importuara nga Turqia dhe Kina – por disa materiale të caktuara blihen edhe nga furnizues brenda Shqipërisë. Këto artizane kontribuojnë në ekonominë dhe ruajtjen e kulturës së zonës, duke i shitur produktet e tyre në tregun lokal, ose duke i prodhuar ato për dhurata, përdorim personal, ose për shkëmbim brenda komunitetit të tyre. Brezi i ri, si Sara Karaj (21), Nexhmije Gjikola (21), dhe Argita Vicishta (21), po mësojnë dhe po i përshtatin këto teknika tradicionale, duke i kombinuar ato me ndikime moderne. Ndërkohë, gra të papuna si Xhuljana Lleshi (22), Merita Rama (45), dhe Ervina Gjikola (38) merren me punime artizanale si një mjet për t'u shprehur, për të vendosur lidhje në komunitet, dhe si mundësi fitimi të të ardhurave. Me gjithë vështirësitë ekonomike, ato e vazhdojnë punën e tyre artizanale me përkushtim, shpesh duke i përdorur aftësitë e tyre për të krijuar dhurata ose objekte artizanale të punuara me dorë, që i shkëmbejnë brenda rretheve të tyre. Dy nga këto gra, Rabije Alla dhe Selvie Karaj, i shesin aktivisht krijimet e tyre në tregun lokal, duke mbajtur një mikro-ekonomi mallrash të punuar me dorë. Puna e tyre jo vetëm që ruan traditat artistike të zonës, por edhe krijon tek gratë e Bulqizës një ndjenjë qëndrueshmërie dhe besimi tek vetja.[42]

Punimet artizanale, sidomos qëndismat dhe rrobat prej leshi, janë traditë mjaft e përhapur ndër gratë e Ostrenit.

42. Informacion i mbledhur përmes intervistave dhe konsultimeve me përfaqësues të SDI-së, Elias Mazloum dhe Armando Suka.

Njësia administrative e Ostrenit shtrihet në juglindje të Bashkisë Bulqizë dhe ka një sipërfaqe prej9874 ha, me terren kryesisht malor. Në lindje ajo kufizohet me Maqedoninë e Veriut, në lindje me Trebishtin, në jug dhe jugperëndim me Steblevën, në perëndim me Zerqanin, dhe në veri me Gjoricën. Ostreni zë pjesën më të madhe të krahinës së Gollobordës, një krahinë shumë e njohur në zonën e Dibrës për karakteristikat e saj kulturore, gjuhësore, etnografike dhe historike. Emri i Gollobordës (Golo Brdo) vjen nga maqedonishtja, që do të thotë "kodër e zhveshur", një pamje që të bie në sy sapo hyn në këtë zonë. E vendosur në mes të maleve, ajo ka qenë për një kohë të gjatë qendër e komunitetit që flet gjuhën bullgare në Shqipëri.[43] Në Gollobordë ruhen gjurmë të qytetërimeve të lashta, së bashku me një trashëgimi të pasur të kulturës materiale dhe shpirtërore. Zona njihet për arkitekturën e saj tradicionale, me shtëpi të ndërtuara me gurë të zonës dhe me elementë druri të gdhendur. Burrat njihen veçanërisht për mjeshtërinë e punimit të gurit – mjeshtëri e trashëguar brez pas brezi. Ndërsa gratë kanë ruajtur artin e endjes së pëlhurave, duke krijuar kostume tradicionale shumëngjyrëshe që ende vishen edhe sot në festa dhe aktivitete të tjera të rëndësishme . Veshja tradicionale e grave të kësaj zone pasqyron një traditë të lashtë të shprehjes artistike që vë në pah disa nga elementët më të vjetër dhe më domethënës të artizanatit tradicional. Motivet që gjenden në këtë art popullor janë të lidhura ngushtë me historinë e zonës dhe me tiparet më të gjera kulturore dhe artistike të banorëve të zonës. Burimet historike na kanë mundësuar të ndjekim gjurmët e shprehjeve artistike të mishëruara në këto veshje, që janë ruajtur në formën e tyre më të kulluar në të gjithë zonën e Gollobordës. Motivet e larmishme të qëndismave, të pasura në simbolizëm të veçantë, dëshmojnë për aftësinë dhe mjeshtërinë e jashtëzakonshme që i ka rrënjët në lashtësi. Përmes qëndisjes së simboleve dhe motiveve të ndryshme, kjo veshje përcjell psikologji shoqërore, me elemente dekorative që i janë përshtatur me kujdes traditave popullore dhe historisë së zonës. Është fakt i njohur se trashëgimia shpirtërore nuk është statike; ajo evoluon me kalimin e kohës, duke përfshirë elemente të reja gjatë periudhave të ndryshme historike. Megjithatë, në këtë veshje tradicionale, tiparet origjinale janë ruajtur me kujdes që nga kohët e lashta. Procesi artizanal i kushton shumë rëndësi ruajtjes së traditës, teknikës së mjeshtërisë, precizionit të motiveve të qëndisura, dhe cilësisë së materialeve të zgjedhura. SI formë e artit popullor, kostumet tradicionale përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kulturës materiale, ndërsa motivet artistike të shprehura në ato veshje shërbejnë si një përbërës thelbësor i trashëgimisë shpirtërore të një komuniteti ose grupi etnik.[44]

Veshja tradicionale e Ostrenit është element i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore të zonës, që pasqyron identitetin dhe mënyrën e jetesës së banorëve të saj. Kostumi popullor, që vishet në 13 fshatrat e Ostrenit, është ruajtur me kujdes nga një grup grash të përkushtuara, ndër të cilat Xhemile Muca, Lirije Muca, Rehane Muca, Zenepe Tola, dhe Kujtime Tola. Këto artizane i punojnë me dorë dhe me shumë dashuri kostumet që përbëhen nga fustane, veshje, dhe aksesorë të bërë me materiale natyrore. Mjeshtëria e tyre flet për lidhjen e fortë me natyrën dhe historinë e pasur të zonës dhe vë në pah rolin e rëndësishëm të grave në ruajtjen e kulturës dhe zhvillimin ekonomik të zonës.Punimet artizanale, sidomos qëndismat dhe rrobat prej leshi, janë traditë mjaft e përhapur ndër gratë e Ostrenit. Pothuaj të gjitha gratë në zonë i kanë këto aftësi dhe merren me artizanat; megjithatë puna e tyre mbetet e padukshme në të dhënat dhe regjistrat zyrtarë. Punimet e thurura prej leshi, në veçanti, ka mjaft potencial për vetëpunësim, megjithëse aftësitë e grave aktualisht janë të kufizuara vetëm në një numër të vogël produktesh tradicionale dhe ato nuk kanë njohuri për kërkesat në treg. Me mbështetjen e duhur, ato kanë aftësinë të zgjerojnë gamën e produkteve të tyre përtej traditës lokale dhe t'u përshtaten nevojave të tregut.Procesi i prodhimit kryhet më së shumti me dorë, me vegla të thjeshta tradicionale, si tezgjahu. Gratë kanë kontroll të plotë mbi pajisjet dhe përcaktojnë në mënyrë të pavarur çmimin e shitjes së produkteve të tyre, bazuar në koston e tyre. Megjithatë, aksesi në treg mbetet një sfidë e konsiderueshme, sepse shitjet e tyre aktualisht kufizohen brenda komunitetit, ose në kontakte të drejtpërdrejta. Për të mundësuar zgjerimin e klientelës, është e nevojshme të diversifikohen produktet, të vendosen lidhje në treg dhe të zhvillohen trajnime për modele dhe teknika të reja.[45]

43. Shih: https://preserving-heritage.com/
44. Shih: https://preserving-heritage.com/
45. Konstatime nga takimet dhe intervistat me gratë e Ostrenit.

Tabela 7. Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të punimeve artizanale

Anët e Forta	Dobësitë
Gratë kanë aftësitë bazë dhe mund të fitojnë më shumë në qoftë se mbështeten me trajnime. **Pothuaj të gjitha gratë në Ostren zotërojnë aftësitë** dhe merren me artizanat, kryesisht me qëndistari, si dhe produkte si rroba prej leshi dhe jelekë. **Procesi i prodhimit kryhet më së shumti me dorë**, me vegla të thjeshta tradicionale, si tezgjahu. **Gratë kanë kontroll të plotë mbi pajisjet** dhe përcaktojnë në mënyrë të pavarur çmimin e shitjes së produkteve të tyre, duke marrë parasysh koston e prodhimit. **Puna mund të bëhet nga shtëpia** dhe gratë mund të shtojnë të ardhurat e familjes së tyre. **Nuk ekzistojnë pengesa tradicionale.** Artizanati zakonisht konsiderohet si aktivitet me të cilin merren gratë dhe përcillet nga brezi në brez.	**Zinxhiri i vlerës dhe gratë që janë të përfshira në të nuk figurojnë në të dhënat** dhe regjistrat zyrtarë. **Mungesa e burimeve financiare** dhe, rrjedhimisht, investime të pamjaftueshme për pajisje dhe teknologji. **Mungesa e certifikimit** për aftësitë dhe cilësinë e produkteve. **Aftësitë e grave kufizohen vetëm në disa produkte tradicionale** dhe ato nuk kanë njohuri për kërkesat e tregut. **Operim informal në treg.** **Tregu i tyre është i kufizuar** në komunitetin lokal ose kontaktet e drejtpërdrejta. **Kushte pune të kufizuara,** sidomos për gratë. **Njohuri dhe aftësi të kufizuara** për administrimin e biznesit, financimin, marketingun, reklamën, etj. **Ka ende pengesa që kufizojnë fuqizimin e grave,** si vendimmarrja për fillimin e biznesit, për aksesin në burime, etj. **Informacion i kufizuar** për mundësitë e tregut.
Mundësitë	**Kërcënimet**
Gatishmëria për të bashkëpunuar dhe për të ndarë së bashku asetet, burimet dhe tregjet. **Punimet artizanale, sidomos artikujt e thurur prej leshi, kanë potencial** për vetëpunësimin e grave në Ostren. **Gama e produkteve të tyre është e kufizuar në ato tradicionale të zonës**, por me mbështetjen e duhur, ato i kanë aftësitë për të zgjeruar listën e produkteve me artikuj të tjerë, bazuar në kërkesat e tregut. **Gratë kanë aftësitë bazë** dhe mund të fitojnë aftësi të tjera në qoftë se mbështeten me trajnime. **Duhet bërë më shumë për sa i përket diversifikimit të produkteve,** përfshirë modele dhe produkte të reja për tregun, vendosja e lidhjeve në treg dhe trajnime për modele të reja. **Ekziston mundësia për të bërë ndryshime me investime të vogla,** pajisje të thjeshta, trajnime për teknologjinë dhe aftësitë e biznesit, dhe lidhjet në treg. **Bashkia dhe njësia administrative i kanë prioritet artizanet e Ostrenit** dhe u shprehën të gatshme t'u ofronin grave një mjedis pune gratë në ndërtesën e njësisë administrative. **Mundësia për grupimin e grave për përdorim të përbashkët të pajisjeve**, bashkëpunim, dhe përfaqësim më të mirë në treg.	**Brezat e rinj mund të mos jenë të interesuar** ta vazhdojnë traditën, që mund të çojë në humbjen e aftësive me kalimin e kohës. **Njohuri të kufizuara për strategjitë e çmimeve**, menaxhimin e biznesit, dhe tendencat në treg. **Sektori nuk njihet zyrtarisht** në të dhënat zyrtare dhe kornizat e politikave, gjë që kufizon mbështetjen institucionale.

2. Diagram i Zinxhirit të Vlerës të Punimeve Artizanale në Ostren

Në vijim paraqitet një diagram gjithëpërfshirës i hallkave të zinxhirit të vlerës, aktorëve, faktorëve mbështetës dhe çështjeve kryesore të identifikuara, bazuar në konstatimet nga intervistat me grupet e interesit dhe agjencitë mbështetëse vendore, puna kërkimore në terren, dhe konsultimet me specialistë.

Diagrami paraqet grupet kryesore të interesit, fazat që nga inputet deri në tregun përfundimtar dhe ndihmon në identifikimin e vështirësive që dalin gjatë prodhimit. Vlerat numerike sipër kutive përfaqësojnë kostot dhe vlerën e shtuar për çdo fazë.

Figura 3. Diagram i zinxhirit të vlerës të punimeve artizanale



Sikurse shihet në figurë 3, zinxhiri i vlerës i punimeve artizanale në njësinë administrative (NJA) të Ostrenit është i organizuar në disa faza kyçe:

Faza e inputeve – Kjo është faza fillestare që ka të bëjë me mbledhjen ose kultivimin e lëndëve të para, sigurimin e pajisjeve dhe të furnizimeve të nevojshme. Furnizuesit e inputeve luajnë rol kyç në procesin e prodhimit përmes sigurimit të lëndëve të para, të pajisjeve dhe veglave të nevojshme për prodhimin artizanal. Ndër këta janë fermerët ose tregtarët e zonës që furnizojnë me lesh, pambuk dhe ngjyra natyrale që përdoren në prodhimin artizanal, furnizuesit me vegla pune artizanale, si tezgjahu, gjilpëra, furka, dhe fije, si dhe shitësit me pakicë ose shumicë që furnizojnë me materiale dekorative, pëlhura dhe aksesore.

Burimi i zakonshëm i lëndëve të para për gratë artizane në Bulqizë është tregu lokal në qytet dhe, në disa raste, ato i marrin lëndët e para në qytetin fqinjë të Peshkopisë, ose në Tiranë. Fijet e leshit dhe pambukut përdoren rëndom në endje pëlhurash, qëndistari, dhe thurje me shtiza, për krijimin e veshjeve tradicionale, qilima dhe pëlhura dekorative. Pajisja kryesore është tezgjahu, që prodhohet kryesisht me porosi nga një numër i vogël artizanësh që kanë mbetur në vend. Një tezgjah i mirë, i prodhuar me dorë, mund të kushtojë mesatarisht 1000 Euro. Makinat qepëse dhe të qëndisjes për punë më të detajuar dhe më fine mund të blihen në Tiranë, ku janë edhe furnizuesit kryesorë të këtyre pajisjeve. Artizanet mund t'i blejnë këto makina të dorës së dytë, me çmim nga 800-1500 Euro (në varësi të parametrave teknikë). Për shkak të mundësive të kufizuara të grave për të lëvizur, burrat ndihmojnë me transportin për në treg dhe blejnë lëndët e para. Duke qenë se produktet e prodhuara nga gratë e Ostrenit janë kryesisht prej leshi, faza e inputeve (lëndëve të para) llogaritet të jetë 25% e kostos totale të prodhimit. Disponueshmëria e lëndëve të para me cilësi të lartë dhe me çmime të përballueshme është e kufizuar, dhe artizanet nuk kanë akses në pajisje moderne që mund të rrisin produktivitetin dhe të përmirësojnë cilësinë e produkteve. Përveç kësaj, ato mbështeten në furnizuesit lokalë, pa pasur lidhje me tregje alternative të vendit dhe ndërkombëtare, që kufizon aftësinë e tyre për të zgjeruar prodhimin.

Faza e prodhimit – Kjo është faza kur produktet artizanale punohen me dorë, përpunohen dhe përgatitet produkti përfundimtar. Kjo fazë është krejtësisht (100%) nën kontrollin dhe menaxhimin e grave. Zakonisht ajo kryhet gjatë pak orëve të kohës së lirë që kanë gratë, pasi kanë bërë punët e tjera të papaguara në familje. Një gruaje mund t'i duhen dy deri në tre muaj për të përfunduar një kostum të plotë tradicional të Ostrenit. Kjo fazë përbën edhe pjesën më të madhe të kostos, që llogaritet në 75% të kostos totale të produktit.

Faza e tregut – Kjo fazë ka të bëjë me shpërndarjen, marketimin dhe shitjen e produkteve të bëra me dorë përmes kanaleve të ndryshme të tregtimit. Megjithatë, gratë artizane të Ostrenit kanë akses të kufizuar në treg dhe nuk kanë mundësi të shumta për shitje. Aktualisht ato ose prodhojnë për nevojat e veta, ose punojnë me porosi, dhe klientët e tyre janë kryesisht banorë të zonës ose ata që kanë emigruar në qytete të tjera ose jashtë shtetit. Një traditë e rëndësishme është ajo që nuset e reja të zonës gjithmonë marrin dhuratë një kostum popullor kur martohen, duke e mbajtur këtë zeje gjallë në kulturën e zonës. Edhe kjo fazë menaxhohet plotësisht nga gratë dhe ka kosto minimale (5%).

Gratë artizane në Bulqizë aktualisht i shesin produktet e tyre përmes tregut lokal, ku shitjet mund të bëhen brenda komunitetit, dhe përmes rekomandimeve ose kontakteve të drejtpërdrejta, që shërbejnë si kanale informale marketingu. Ndonjëherë, gratë marrin pjesë në panaire dhe ekspozita artizanale, që u ofrojnë njëfarë njohjeje përtej zonës ku banojnë. Vështirësitë kryesore në këtë fazë përfshijnë aksesin e kufizuar në treg, praninë e kufizuar online ose në kanalet digjitale të marketingut për promovimin e produkteve të tyre, dhe mungesa e brandit. Pa kanale të strukturuara të shitjes, artizanet e kanë të vështirë të kenë akses në një klientelë më të gjerë.

Më poshtë vijon një përshkrim i shkurtër i agjencive që mbështesin këtë zinxhir vlere në sistemin e tregut:

Specialistët e ZV-së - Gratë artizane në Ostren janë prodhueset kryesore që merren me dizajnin dhe punimin e kostumeve tradicionale dhe produkteve të tjera artizanale të punuara me dorë, duke ruajtur teknikat artizanale. Ato gjithashtu marrin vendime për kostot e prodhimit dhe caktojnë çmimet e produkteve bazuar në koston e materialeve dhe kohëzgjatjen e prodhimit. Shumë artizane nuk kanë njohuri teknike apo trajnim formal për modele të reja, tendencat e tregut dhe teknikat moderne të prodhimit. Po kështu, ka mungesë të standardeve të kontrollit të cilësisë, që ndikon në konsistencën dhe konkurrueshmërinë e

produktit. Krahas këtyre, produktiviteti i ulët për shkak të përdorimit të mjeteve manuale dhe metodave tradicionale pengon aftësinë e tyre për të përballuar porosi më të mëdha. Gratë artizane të Ostrenit nuk kanë marrë asnjëherë informacion për mundësitë e marrjes së mbështetjes ose asistencës nga specialistët e ZV-së.

ACE – Shkolla e Artizanatit[46] është një qendër kombëtare për edukimin në fushën e artit dhe të artizanatit, e ngritur në Tiranë. Ajo u krijua si model eksperimental për formim profesional në fushat e artit, artizanatit dhe të dizajnit të modës, dhe ofron formim në këto fusha, në nivelin fillestar dhe atë të përparuar. Qendra synon t'u përmbahet standardeve më të larta të praktikave dhe arritjeve të artit bashkëkohor, si në nivel vendor ashtu edhe ndërkombëtar. Ajo përpiqet të zbatojë një program solid për përfshirjen e komunitetit në arsimim të vazhdueshëm, si dhe t'i shtojë vlerë komunitetit kulturor, ekonomik dhe social duke ruajtur zejet dhe historinë, teknikën dhe burimet natyrore, si shkollë profesionale në fushën e artit dhe artizanatit në Shqipëri.

Qendra ofron laboratorë praktikë të të mësuarit përmes internetit dhe offline, me mësimdhënie nga artistë dhe artizanë profesionistë në secilën fushë, si rrobaqepësi, dizajn dhe krijim modelesh/shabllonesh, qepje haute couture, qëndistari me tambur, qëndistari luvenille, qëndistari franceze, arti i luleve në pëlhurë, endje pëlhurash me vegjë, qëndisje me dorë të stilit të vjetër, punime ari tredimensionale me tel, qëndisje me rruaza, përpunim lëkure për çanta dhe aksesorë të modës, krijime modelesh për kostume tradicionale. Aty mësohet edhe për histori suksesi të artistëve dhe sipërmarrësve në këto fusha, krijimin e aksesorëve të modës, ringjalljen e zejeve të harruara përmes metodologjive bashkëkohore, punimet prej metali dhe hekuri, artin e fibrës si pasion i njohur në artet e bukura, punimet e aplikacionit me tekstile, krijimin e modeleve për kostume fëmijësh, kukulla organike, artin e punimit me dru dhe shajak, artin e qeramikës për dekorime të hapësirave të brendshme dhe aksesorë mode, kapelari. Gjithashtu ofrohen edhe seminare dhe masterklasa për përparimin dhe qëndrueshmërinë e industrisë së modës dhe zejeve artizanale në vitet e ardhshme, si edhe organizohen me ekspozita dhe shfaqje në të gjithë vendin si tregues të përparimit të punimeve të studentëve.

Agjenci mbështetëse – Ka një numër institucionesh dhe organizatash që luajnë rol në mbështetjen e sektorit të zejtarisë duke ofruar udhëzime për politikat, asistencë, dhe mundësi trajnimi.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është përgjegjëse për politikat mbështetëse për sektorin e zejtarisë tradicionale dhe promovimin e ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Ajo mund të ofrojë asistencë financiare, grante ose subvencione për të mbështetur zejtarët dhe bizneset e vogla lokale, si edhe të krijojë programe për forcimin e lidhjeve të tregut dhe lehtësimin e eksporteve. Megjithatë, vazhdon të jetë problematike mungesa e programeve të strukturuara që kanë në qendër posaçërisht gratë sipërmarrëse në sektorin e zejtarisë. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) ofron mundësinë e mbështetjes financiare për artizanët dhe zejtarët, me qëllim forcimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që promovojnë artizanatin dhe trashëgiminë kulturore në Shqipëri. Thirrja e MEKI-të për financim (2025)[47] ofro fonde publike për mbështetjen e projekt-propozimeve nga:

- Individë artizanë
- Organizata jofitimprurëse (OJQ)
- Biznese të regjistruara (individë dhe subjekte të regjistruara në QKB)

Në kuadër të kategorisë së parë mund të aplikojnë individë artizanë dhe shoqata të artizanatit që kanë aktivitet të vazhdueshëm prodhues në fushat e zejtarisë të cilësuara në këtë kategori. Mbështetja financiare e ofruar do të jetë midis 500 mijë deri në 1,5 milion lekë për blerjen e mjeteve dhe pajisjeve të punës të nevojshme për aktivitetet e tyre të prodhimit, blerjen e lëndëve të para për prodhimin e produkteve artizanale dhe mbështetjen për promovimin dhe brandimin e produkteve artizanale. Projektet e përzgjedhura duhet të kenë në fokus të veprimtarisë promovimin, edukimin, mbrojtjen, ruajtjen dhe përcjelljen e artizanatit tradicional. Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të japë këshilla të qarta për aplikantët e interesuar që operojnë në sektorin e artizanatit dhe të trashëgimisë kulturore, për t'i ndihmuar të përgatisin dhe dorëzojnë projekt-propozime në kuadër të Programit Kombëtar të Granteve për Kulturën dhe Krijimtarinë 2025.

Dhoma Kombëtare e Zejtarisë (DHKZ) u themelua më 19 dhjetor 2017 si një person juridik që funksionon sipas Ligjit "Për zejtarinë në Republikën

46. Shih: https://craftsman.al/
47. Shih: https://meki.gov.al/hapet-thirrja-per-grante-fondi-i-artizaneve-2025/

e Shqipërisë" (Nr. 70/2016)[48]. Ajo është një organizatë jofitimprurëse me seli në Tiranë dhe ka shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ligji parashikon organizimin e plotë të veprimtarisë zejtare dhe krijimin e një sistemi të dyfishtë kualifikimi, mbështetur plotësisht në modelin e aplikuar në Gjermani. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë ka në fokus:

- veprimtaritë zejtare në Shqipëri;
- formimin profesional në këtë sektor;
- organizimin e sipërmarrjeve zejtare;
- nxitjen e zhvillimit të zejtarisë.

Institucioni përfaqëson zejtarët dhe artizanët dhe mbron interesat e tyre në nivel kombëtar. Ai ofron programe trajnimi për zhvillimin e biznesit dhe për përmirësimin e aftësive dhe punon për certifikimin dhe njohjen formale të zejtarisë tradicionale. Pavarësisht nga këto përpjekje, shtrirja e tij dhe angazhimi me zejtarët dhe zejtaret në zona të thella si Ostreni mbeten të kufizuar, dhe fondet dhe burimet e pamjaftueshme pengojnë nismat për zhvillimin e nismave në shkallë të gjerë për zhvillimin e biznesit.

Certifikimi i titujve të zejtarisë në Shqipëri

Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për kualifikimet profesionale, lëshojnë dy certifikata kryesore në sektorin e zejeve:

- Certifikata e ndihmësmjeshtrit konfirmon se individi zotëron kualifikim profesional të barabartë me atë të një ndihmësmjeshtri. Ekuivalenca përcaktohet nga në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për kualifikimet profesionale.

- Certifikata mjeshtrit vërteton se individi ka shumë vite përvojë si edhe njohuritë dhe aftësitë profesionale për praktikimin e një zeje të caktuar dhe gjatë viteve ka kontribuar në kalimin e ekspertizës tek brezat e zejtarëve të rinj.

- Certifikata e mjeshtrit u jepet atyre që demonstrojnë se kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për ta ushtruar zejen përkatëse në mënyrë të pavarur dhe kanë kaluar me sukses provimin e kualifikimit për mjeshtër.

Dhoma Ekonomike e Gruas e Shqipërisë[49] është një organizatë jofitimprurëse që ka për qëllim mbrojtjen dhe avancimin e r ekonomike dhe sociale të grave sipërmarrëse, profesioniste dhe të vetëpunësuara në të gjithë sektorët e ekonomisë shqiptare. E themeluar nga një grup sipërmarrësesh me bë, Dhoma Ekonomike e Gruas synon të fuqizojë gratë përmes nismave strategjike dhe shërbimeve mbështetëse. Misioni dhe aktivitetet e saj janë:

- **Mbështetje me politika:** Bashkëpunon me organet e pushtetit qendror dhe vendor, si edhe me organizata ndërkombëtare, për hartimin dhe zbatimin e politikave që promovojnë fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të grave.

- **Trajnime dhe konsulencë:** Ofron programe trajnimi profesional dhe ndihmë për planifikim strategjik të biznesit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për gratë e vetëpunësuara.

- **Mbështetje për internacionalizim:** Lehtëson zgjerimin ndërkombëtar të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të drejtuara nga gratë përmes promovimit të produkteve, punimeve artizanale, modës, dhe dizajnit në vend përmes panaireve, konferencave dhe seminareve.

- **Programe mentorimi:** Ka filluar një program të parë mentorimi për mbështetjen e grave nga gratë, duke dhënë këshilla dhe udhëzime për kapërcimin e vështirësive dhe strategji për rritjen e biznesit.

- **Punë kërkimore dhe botime:** Kryen studime dhe boton materiale për informimin dhe mbështetjen e grave në biznes.

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale[50] në Shqipëri është një institucion që synon ruajtjen, promovimin, dhe zhvillimin e zejeve tradicionale, traditave dhe aktiviteteve kulturore. Qendra ka për qëllim mbrojtjen e traditës së pasur kulturore të Shqipërisë duke mbështetur artizanët e vendit dhe duke siguruar që praktikat tradicionale të përcillen nga brezi në brez. Objektivat kryesore janë:

- **Ruajtja dhe promovimi i zejeve tradicionale:** Qendra punon për ruajtjen e autenticitetit të punimeve artistike dhe artizanale në Shqipëri, duke i mbështetur artizanët me projekte dhe nisma të ndryshme.

- **Edukimi kulturor:** Ajo luan një rol të rëndësishëm në edukimin e publikut për trashëgiminë kulturore të Shqipërisë, sidomos përmes aktiviteteve, ekspozitave dhe seminareve

48. Shih: https://www.dhkz.org.al/index.php/sq/legjislacioni/178-ligj-nr-70-2016-per-zejtarine-ne-republiken-e-shqiperise
49. Shih: https://weca.al/

që nxjerrin në pah punimet artizanale tradicionale.

- **Bashkëpunimi me zejtarët dhe komunitetet:** Qendra bashkëpunon me zejtarë dhe komunitetet lokale për përmirësimin e sasisë së produkteve dhe vijueshmërisë së metodave të prodhimit.

- **Qendra organizon shpesh aktivitete të ndryshme** si festivale kulturore, seminare dhe programe trajnimi për mbështetjen e zejeve tradicionale në Shqipëri dhe për të siguruar vitalitetin e tyre në shoqërinë e sotme.

Shoqata e Artizanëve dhe e Zejeve të Shqipërisë[51] synon promovimin dhe ruajtjen e zejeve tradicionale shqiptare. Ajo u themelua nga rreth 50 artizanë dhe merret aktivisht me organizimin e aktiviteteve dhe ekspozitave për njohjen e publikut ne trashëgiminë e pasur artizanale të Shqipërisë. Shoqata organizon rregullisht panaire të zejeve në qytete të ndryshme, përfshirë në Shkodër, për t'u dhënë zejtarëve platformë për ekspozimin dhe shitjen e produkteve të tyre. Këto aktivitete tërheqin banorët vendas dhe turistët, dhe forcojnë shkëmbimet kulturore dhe mundësitë ekonomike. Ekspozitat artizanale mbahen edhe në vende të tjera, si në Tuz në Malin e Zi, ku vihet në pah shumëllojshmëria dhe mjeshtëria e zejtarëve shqiptarë. Këto ekspozita janë të hapura për publikun për një periudhë të caktuar kohe, duke u mundësuar vizitorëve të vlerësojnë dhe të blejnë vepra arti tradicionale. Gratë artizane të Ostrenit nuk janë anëtare në ndonjë shoqatë të zonës apo kombëtare.

2.1 KONSTATIMET E STUDIMIT

Bazuar në punën në terren, vrojtimet, dhe intervistat e kryera me aktorë kyç në zinxhirin e vlerës, si specialiste të zinxhirit të vlerës të punimeve artizanale, u identifikuan të dhënat e mëposhtme:

Mundësitë:

Ka një numër mundësish për rritje në sektorin e punimeve artizanale në Ostren. Zona ka një traditë të pasur kulturore dhe aftësitë tradicionale ekzistuese ofrojnë bazën për zgjerimin e aktivitetit. Gratë artizane kanë aftësinë të diversifikojnë produktet në qoftë se marrin trajnimin e duhur, si dhe ka potencial për zgjerimin e tregut përmes platformave në internet, turizmit dhe bashkëpunimit me shitësit me pakicë të punimeve artizanale.

Organet e pushtetit vendor kanë shprehur interes për mbështetjen e sektorit përmes ofrimit të ambienteve për artizanet, dhe krijimi i kooperativave artizanale mund të përmirësojë aftësinë e tyre negociuese dhe të shtojë dukshmërinë e tyre. Me investime të përshtatshme, këto mundësi mund të çojnë në qëndrueshmëri afatgjatë të sektorit.

Kufizimet:

Me gjithë mundësitë e përmendura, ka edhe një numër kufizimesh. Aksesi në treg mbetet një vështirësi e konsiderueshme dhe artizanet nuk kanë njohuri biznesi në fusha si strategjitë për caktimin e çmimeve, angazhimi i klientëve dhe planifikimi financiar. Varësia nga modelet tradicionale, pa futur pothuaj asnjë element inovativ për t'iu përshtatur preferencave të konsumatorëve, e kufizon më tej zgjerimin në treg. Një aspekt tjetër kritik është mungesa e burimeve financiare për të investuar për mjete më të mira pune, mjedis pune, dhe trajnim profesional. Krahas këtyre, nuk ka akses në platforma për shitje në internet apo mjete digjitale marketingu, që kufizon dukshmërinë e tyre përtej shitjeve të produkteve në zonë.

Problematikat kryesore të identifikuara

- **Faza e inputeve:**
  - Mungesa e lëndëve të para cilësore dhe me çmime konkurruese.
  - Varësia nga lëndët e para të importuara.
  - Informacion i kufizuar për tregjet furnizuese.

50. Shih: https://folklor.gov.al/
51. Shih: https://www.facebook.com/ShoqataEArtizaneveTePunimeveArtistikeTeShqiperise?locale=sq_AL

- Akses i kufizuar në mundësi financimi, sidomos për gratë aktiviteti i të cilave është informal.
- Mungesë bashkëpunimi për blerje të përbashkëta të inputeve.

- **Faza e prodhimit:**
  - Proces i prodhimit kryhet me dorë, kërkon shumë kohë dhe bëhet me mjete pune të vjetruara.
  - Efikasitet i ulët për shkak të mungesës së pajisjeve dhe teknikave moderne.
  - Ndërgjegjësim i kufizuar për kërkesat e tregut, sidomos ndër gratë.
  - Hapësirë e kufizuar pune.
  - Nivel i ulët bashkëpunimi për të punuar dhe për të përdorur bashkërisht pajisjet.
  - Punë informale.

- **Faza e tregut:**
  - Mungesë identiteti përmes një brandi që tërheq një treg më të gjerë.
  - Mungesë e lidhjeve me tregun, me shitës me pakicë në nivel vendi dhe nivel ndërkombëtar.
  - Nivel i ulët i marrëdhënieve me klientët dhe përpjekje promocionale minimale.
  - Mungesë informacioni dhe mungesë pranie në mundësitë e tregut (panairet).
  - Nivel i ulët marketimi digjital.

Çështje të pabarazisë gjinore dhe të përfshirjes së grave në zinxhirin e vlerës

Nga informacioni i mbledhur nga takimet dhe intervistat – që u zhvilluan në kuadër të dy vizitave të kryera ku u angazhuan rreth 23 palë interesit, tregon se gratë dhe vajzat janë të përfshira aktivisht në pjesën më të madhe të fazave të zinxhirit të vlerës të punimeve artizanale, sidomos në prodhim dhe shitje. Megjithatë, ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazi në vendimmarrje dhe në akses në mundësi financimi dhe për zhvillimin e biznesit.

Aftësitë tradicionale artizanale përcillen nga një brez në tjetrin, por vajzat e reja shpesh emigrojnë në zona urbane në kërkim të punësimit alternativ, duke vënë kështu në rrezik qëndrueshmërinë e zinxhirit të vlerës. Shumë gra kanë autoritet të kufizuar në vendimmarrje kur është fjala për zgjerimin e biznesit, sepse përgjegjësitë dhe punët e shtëpisë shpesh kanë përparësi. Barrierat gjinore, si mungesa e aksesit në burime dhe e pavarësisë financiare, kufizojnë aftësinë e tyre për të rritur prodhimin apo për të investuar në rritjen e biznesit.

Për t'i trajtuar këto probleme, është e nevojshme që të bëhen trajnime në fushën e biznesit, sidomos për gratë artizane; të mundësohen lidhjet në rrjete dhe lidhjet me tregun për mbështetjen e sipërmarrjeve të grave, dhe të promovohen modele bashkëpunimi në kooperativë që u mundësojnë grave të bashkëpunojnë dhe të rrisin praninë e tyre në treg.

Mundësitë e financimit Aksesi në financim mbetet një prej pengesave kryesore me të cilat përballen gratë në zonat rurale,[52] përfshirë gratë artizane në Ostren.[53] Aktualisht, burimet financiare për bizneset e zejtarisë janë shumë të pakta, sidomos për gratë artizane që punojnë në mënyrë informale. Pavarësisht nga kjo, ka disa mundësi potenciale financimi që mund ta mbështesin këtë sektor. Ndër to përfshihen grantet dhe subvencionet nga shteti, përmes Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, skemat e huave të vogla ose të mikrokredive posaçërisht për gratë sipërmarrëse, si dhe partneritetet me grupe interesi të sektorit privat, si shitësit me pakicë të punimeve artizanale, organizatat e tregtisë së drejtë, dhe OJQ-të.

Mikrokredia është shpesh e vetmja mundësi që kanë gratë artizane për të pasur akses në financim, që u mundëson të blejnë lëndë të para, të përmirësojnë mjediset e punës, të blejnë pajisjet e nevojshme dhe të zgjerojnë bizneset e tyre. Megjithatë, norma e lartë e interesit[54] që vihet nga institucionet e mikrokredisë shpesh i bën këto kredi të papërballueshme për familjet me të ardhura të ulëta, duke kufizuar kështu aftësinë e tyre për ta shfrytëzuar plotësisht këtë mbështetje financiare.Për ta kapërcyer këtë vështirësi, krijimi i një mekanizmi të dedikuar mbështetës posaçërisht për gratë artizane mund ta lehtësonte shumë aksesin e tyre në fonde. Ky mekanizëm mund të përfshijë kredi me interes të ulët, grante dhe programe edukimi financiar që synojnë t'i pajisin gratë artizane me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për menaxhimin më të mirë të

52. *Overview of Women Entrepreneurs and Entrepreneurship – Factsheet* (Pamje e përgjithshme e grave sipërmarrëse dhe sipërmarrjeve të tyre- Fletë informative). UN Women, 2021. Shih: https://eca.unwomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20ECA/Attachments/Publications/2021/8/Expo%20Report/ALBANIA_Factsheet-min.pdf

53. Nga intervistat me gratë në Ostren u mësua se asnjë prej tyre nuk kishte marrë ndonjëherë ndihmë financiare.

financave të tyre dhe për rritjen e qëndrueshme të bizneseve të tyre.
Përveç kësaj, krijimi i modeleve të kooperativave në kuadër të të cilave gratë artizane mund të aplikojnë kolektivisht për asistencë financiare, mund ta shtojë fuqinë e tyre negociuese dhe të pakësojë risqet individuale. Duke bashkuar forcat, gratë artizane do të mund të bashkonin burimet, të ndanin kostot dhe të siguronin kushtet më të favorshme, që do t'u mundësonte të investonin në bizneset e tyre dhe të forconin stabilitetin e tyre ekonomik.
Si konkluzion përmbledhës, kjo qasje jo vetëm do të përmirësojë aksesin e grave artizane në financim, por edhe do të kontribuojë në fuqizimin e tyre ekonomik dhe do t'i ndihmojë të jenë të suksesshme në sistemin e tregut formal dhe të kenë arritje afatgjata.

2.2 NDËRHYRJE TË REKOMANDUARA PËR ZINXHIRIN E VLERËS TË PUNIMEVE ARTIZANALE NË BULQIZË

1. Mbështetja e grupimit të grave:

- **Ndërtimi i kapaciteteve**: Ekziston nevoja e ofrimit të programeve për ndërtimin e kapaciteteve për gratë artizane. Këto programe duhet të fokusohen në aspekte kyçe si planifikimi i biznesit, krijimi i marrëdhënieve të biznesit, strategjitë e marketingut, dhe identifikimi i mundësive për financim. Kjo do t'i ndihmojë gratë artizane që të fitojnë aftësitë e nevojshme për menaxhimin dhe rritjen e bizneseve të tyre në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

- **Mbështetja e grupimeve të grave artizane**: Duhen bërë përpjekje për të nxitur krijimin e grupeve të grave artizane me qëllim që të përmirësohet përfaqësimi i tyre në sistemin e tregut. Këto grupe do t'u mundësojnë grave që të kenë zë më të fuqishëm dhe përfaqësim më të mirë në treg. Kjo nismë duhet të fillojë në periudhën afatmesme, dhe të vazhdojë të zgjerohet në periudhën afatgjatë.

- **Regjistrimi për njohje si subjekt:** Është thelbësore që gratë artizane të mbështeten që të regjistrohen për t'u njohur si njësi prodhuese. Kjo do të bëjë që ato të njihen ligjërisht dhe të bëhen më konkurruese dhe më të integruara në sistemin e tregut formal. Ky proces duhet të fillojë në periudhën afatmesme, dhe të vazhdojë në periudhën afatgjate.

2. Asistenca teknike:

- **Prezantimi i modeleve të reja**: Tregu është në evoluim të vazhdueshëm vazhdimisht dhe, për të qenë në një hap me të, gratë artizane duhet të njihen me modele të reja bazuar në kërkesat aktuale të tregut. Këtu përfshihet diversifikimi i llojeve të punimeve artizanale që prodhohen dhe përshtatja me tendencat moderne. Është shumë e rëndësishme që këto modele të aplikohen në periudhën afatshkurtër dhe që ato të vazhdojnë të evoluojnë edhe në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

- **Grante të vogla për përmirësime**: Për të përmirësuar kushtet e punës, aftësitë prodhuese dhe cilësinë e produkteve, gratë artizane duhet të marrin grante të vogla. Këto grante mund të përdoren për të blerë mjete dhe pajisje pune më të mira, ose për të përmirësuar vendin e punës, dhe janë thelbësore për të mundësuar rritjen e bizneseve në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

- **Trajnimi për modele dhe procese të reja**: Artizanet duhet të trajnohen në vijimësi për modele dhe procese prodhimi të reja. Kjo do t'i ndihmojë të jenë konkurruese dhe të sjellin risi në treg. Këto programe trajnimi duhet të zbatohen në periudhën afatshkurtër, me investime të mëtejshme për periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

- **Hapësirë pune e përbashkët për gratë**: Është e rëndësishme që grave t'u krijohen hapësira pune të përbashkëta, në bashkëpunim me administratën

54. Albania Credit Guarantee Scheme Assessment (Vlerësim i skemës së garantimit të kredive në Shqipëri). Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Grupi i Bankës Botërore 2020. Shih: https://documents1.worldbank.org/curated/en/907601595607606723/pdf/Albania-Credit-Guarantee-Scheme-Assessment.pdf

vendore. Këto hapësira do t'u mundësojnë grave artizane që të punojnë në një mjedis bashkëpunues, të përdorin burimet bashkërisht, dhe të rrisin efikasitetin e punës. Krijimi i këtyre hapësirave të punës duhet të kryhet menjëherë dhe të vazhdojë në periudhën afatgjatë.

3. Certifikimi:

- **Mbështetje e grave me procesin e certifikimit**: Gratë artizane duhet të ndihmohen për të marrë certifikata përmes Qendrës Kombëtare të Certifikimit (QKC). Ky proces certifikimi validon aftësitë e artizaneve dhe siguron që produktet e tyre të përmbushin standardet e cilësisë. Kjo duhet të jetë në fokus në periudhën afatmesme dhe të vazhdojë të kryhet edhe në periudhën afatgjatë.

- **Këshillimi dhe mentorimi**: Ofrimi i këshillimit dhe mentorimit për gratë artizane do t'i ndihmojë ato të përmirësojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre. Kjo do t'i çojë drejt marrjes së certifikatave dhe do t'i aftësojë që të orientohen në kompleksitetet e tregut. Këshillimi duhet të fillojë në periudhën afatmesme dhe të vazhdojë në periudhën afatgjatë për të pasur përfitime të vazhdueshme.

4. Marketimi:

- **Lidhjet e tregut**: Vendosja e lidhjeve në treg është me rëndësi kritike për zgjerimin e tregut të grave artizane dhe për të pasur akses në blerës të rinj. Duhet të bëhen përpjekje për t'i ndihmuar gratë që të lidhen me rrjete, distributorë dhe aktorë të tjerë më të mëdhenj në treg. Kjo duhet të fillojë në periudhën afatshkurtër dhe të vazhdojë të kryhet në vijimësi në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

- **Marketingu digjital dhe tregtia elektronike:** Duke qenë se bota po bëhet gjithnjë e më shumë digjitale, artizanet duhet të ndihmohen që të aftësohen në përdorimin e strategjive të marketingut digjital dhe krijimin e platformave të tregtimit elektronik për shitjen e produkteve të tyre. Kjo do t'i ndihmojë të kenë akses në një audiencë më të gjerë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Kjo nismë duhet të fillojë në periudhën afatmesme dhe të rritet më tej në periudhën afatgjatë.

Zinxhiri i Vlerës Të Punimeve Artizanale mund të përmirësohet përmes fuqizimit të grave me anë të trajnimeve, mbështetjes, certifikimit dhe aksesit në treg.

- **Marrëveshje paraprake me operatorët në treg**: Mbështetja e grave artizane që të bëjnë marrëveshje paraprake me operatorët e tregut garanton që ato të kenë një treg të sigurt dhe të qëndrueshëm për produktet e tyre. Kjo mund t'i ndihmojë që të planifikojnë prodhimin dhe të sigurojnë të ardhura. Kjo nismë duhet të zbatohet në periudhën afatshkurtër, me mbështetje të vazhdueshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

- **Veprimtari promocionale dhe pjesëmarrje e drejtë**: Së fundi, është shumë e rëndësishme që të mbështeten veprimtaritë promocionale dhe që gratë artizane të nxiten të marrin pjesë në panaire dhe ekspozita. Kjo do të bëjë të mundur njohjen e tregut me produktet e tyre dhe do të ndihmojë në krijimin e reputacionit në treg. Këto veprimtari duhet të fillojnë në periudhën afatmesme dhe të vazhdojnë si strategji afatgjatë për ruajtjen dhe rritjen e pranisë së tyre në treg.

Këto rekomandime ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse për përmirësimin e zinxhirit të vlerës të punimeve artizanale përmes fuqizimit të grave me anë të trajnimeve, mbështetjes, certifikimit dhe aksesit në treg.

Tabela 8. Rekomandime për zinxhirin e vlerës të punimeve artizanale

Nr.	Veprimtaria	Impakti		
		Afatshkurtër	Afatmesëm	Afatgjatë
1	**Mbështetja e grupimit të grave**			
1.1	Ndërtimi i kapaciteteve të grave artizane në lidhje me njohuri bazë për planifikim biznesi, marrëdhëniet e biznesit, marketing, mundësitë për financim etj.	X	X	X
1.2	Mbështetje për krijimin e grupeve të grave artizane për përfaqësim më të mirë në treg		X	X
1.3	Mbështetja e regjistrimit për njohje si subjekt		X	X
2	**Asistenca teknike**			
2.1	Prezantimi i modeleve të reja bazuar në kërkesat e tregut	X	X	X
2.2	Grante të vogla për përmirësimin e kushteve të punës, prodhimit dhe cilësisë së produkteve të grave	X	X	X
2.3	Trajnim për modele të reja dhe procese të tjera	X	X	X
2.4	Mbështetje për krijimin e një hapësire të përbashkët pune për gratë, në bashkëpunim me administratën lokale	X	X	X
3	**Certifikimi**			
3.1	Mbështetja e grave në procesin për marrjen e certifikatës përmes QKC-së		X	X
3.2	Këshillimi dhe mentorimi		X	X
4	**Marketingu**			
4.1	Mbështetje për vendosjen e lidhjeve në treg	X	X	X
4.2	Mbështetje për marketim digjital dhe tregti elektronike		X	X
4.3	Mbështetje për lidhjen e marrëveshjeve paraprake me operatorët	X	X	X
4.4	Mbështetje e veprimtarive promocionale dhe pjesëmarrjes në panaire		X	X

Partnerët/bashkëpunimi në nivel vendor: Dhoma Kombëtare e Zejtarisë; bashkia dhe njësia administrative e Ostrenit; Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; pikat e shitjes; shoqatat në ZV, etj.

Pjesa 4
Shtojcat

Shtojca 1. Bashkia Bulqizë: Informacion i përgjithshëm

Bashkia Bulqizë gjendet në rajonin verilindor të Shqipërisë. Në veri ajo kufizohet me Bashkinë Dibër, në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në jugperëndim me Bashkinë Tiranë, në jug me Bashkinë Librazhd dhe në perëndim me Bashkinë Klos.

Bulqiza ka një reliev kryesisht kodrinor e malor, me lartësi që shkojnë nga 420 në 2.101 m mbi nivelin e detit, me majën më të lartë që arrin në 2.115 m mbi nivelin e detit. Në këtë territor ndodhet Lugina e Bulqizës e cila shtrihet nga perëndimi në lindje me gjatësi 25 km dhe gjerësi deri në 1 km. Lugina përshkohet nga Zalli i Bulqizës që derdhet në Drinin e Zi. Në territorin e Bashkisë Bulqizë ndodhen edhe Malësia e Martaneshit dhe Malësia e Gollobordës. Lartësia më e madhe është në jug të Maleve të Allamanit, Maja e Kreshtës (2.101 m) njëkohësisht edhe maja më e lartë në këtë territor, si dhe Malet e Lopës, Maja e Dhokzit (2.020 m) dhe Maja e Kaptinës (1.873m).

Klima në gjithë territorin e bashkisë së Bulqizës është kontinentale e ftohtë, me dimër të ashpër dhe verë të thatë. Temperatura mesatare vjetore arrin vlerën 10°C: temperatura maksimale e regjistruar në verë është 35°C, ndërsa temperatura minimale e regjistruar në dimër është -18°C, me sasi mesatare reshjesh deri në 980 mm në vit.

Figura 4. Bashkia Bulqizë



Bashkia Bulqizë ka një sipërfaqe prej 694 km² dhe është e ndarë në tetë njësi administrative: Bulqizë, Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren dhe Trebisht. Bashkia ka nën administrimin e saj dy qyteza (Bulqiza dhe Krasta) dhe 63 fshatra, dhe bën pjesë në rrethin e Dibrës. Bazuar në ndarjet administrative, bashkia përbëhet nga 26,9% zonë urbane dhe 73,1% zonë rurale.

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë Bulqizë[55]

Bashkia Bulqizë karakterizohet nga një popullsi kryesisht rurale, relativisht e re, dhe një shkallë mjaft të lartë shpopullimi. Numri i individëve që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe të lartë është më i ulët se mesatarja në nivel qarku dhe vendi.

Aktivitetet ekonomike në bashki përfshijnë bujqësinë, blegtorinë, industrinë minerare, shfrytëzimin e pyjeve, mbledhjen e bimëve mjekësore, shërbimet, etj. Kjo zonë njihet për peizazhet e saj të bukura, mjedisin malor dhe resurse të pasura kulturore e natyrore, që përbëjnë potenciale për zhvillimin e turizmit. Bujqësia është e organizuar në ferma të vogla familjare; sipërfaqja e tokës së punueshme është e vogël, e copëzuar dhe një pjesë e mirë e saj, e pandarë. Rreth 34,5% e të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e bujqësisë. Sistemi i ujitjes është i amortizuar. Mungon infrastruktura e grumbullimit, paketimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore. Skema e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes vlerësohet si e papërshtatshme. Tek fermerët mbisundon mentaliteti individual dhe mungojnë qasjet e punës në grup. Mbarështimi i blegtorisë është aktivitet me rëndësi në zonë, por nuk ekzistojnë të gjitha hallkat e zinxhirit të prodhimit. Mungesa e kullotave, infrastruktura e papërshtatshme, promovimi i dobët, mungesa e markës dhe emigrimi i krahut të punës shihen si shqetësuese nga blegtorët e zonës.

Aktualisht, industria minerare nuk kontribuon sa duhet në ekonominë e zonës për shkak të mosderdhjes së rentës minerare. Vjelja e taksave dhe e detyrimeve nga ana e bashkisë është në nivel të ulët për shkak pamundësisë financiare të njësive familjare. Numri i bizneseve për banor është i vogël dhe mungojnë skemat mbështetëse.

Niveli i zhvillimit social dhe burimeve njerëzore nuk është shumë i lartë. Papunësia, varfëria dhe përjashtimi shoqëror janë dukuri shqetësuese. Arsimimi dhe punësimi i banorëve, dhe veçanërisht i grave, është në nivele të ulëta për shkak të mendësisë patriarkale dhe veçorive të zhvillimit ekonomik të zonës, i orientuar më së shumti nga industria e rëndë, pylltaria dhe hidrocentralet.

Nevoja për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore nëpërmjet arsimit profesional, trajnimeve në fushën e menaxhimit të projekteve, integrimi evropian, etj., është domosdoshmëri. Pjesëmarrja e balancuar e burrave dhe grave në vendimmarrje është shumë larg kërkesave të legjislacionit. Mbështetja e ekonomisë kryesisht tek minierat dhe kufizimi i mundësve të punësimit, kërkojnë diversifikim të ekonomisë së bashkisë edhe në sektorë të tjerë, si në shërbimet, turizëm, agrobiznes, artizanat, etj.

Infrastruktura arsimore, sociale, kulturore, sportive e shëndetësore është e vjetër dhe ka nevojë për përmirësime. Nevojat për një sistem transporti publik në qytet dhe për transportin e nxënësve në zonat e largëta rurale janë të dukshme. Turizmi është thuajse inekzistent si aktivitet për shkak të mungesës së organizimit në zinxhirin e vlerës, infrastrukturës së dobët rrugore e turistike, mungesës së dukshmërisë në treg dhe të marketingut territorial.

Zona ka probleme të rënda mjedisore për shkak të shfrytëzimit të paqëndrueshëm e të paplanifikuar të burimeve natyrore, minerare, pyjore, ujore. Shpyllëzimi pa kriter është një problem i mprehtë që dëmton jo vetëm mjedisin por edhe perspektivat e zhvillimit të bashkisë në periudhën afatgjatë. Drejtuesit vendorë janë mjaft të angazhuar për mundësimin e një zhvillimi të diversifikuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor. Planifikimi vendor ekziston në nivelin e njësive administrative, ndërsa shihet si domosdoshmëri planifikimi në nivel bashkiak, me theks mbi procesin me pjesëmarrje. Nuk ekzistojnë agjenci të zhvillimit vendor apo praktika të zhvillimit vendor me nismën e komunitetit, siç janë Grupet e Veprimit Lokal (GVL).

55. Bashkia Bulqizë, Programi buxhetor afat-mesëm, 2025-2027. Shih: https://bulqiza.gov.al/wp-content/uploads/2025/01/PBA-2025-2027.pdf

Historia

Bulqiza është një trevë e banuar që në kohët e lashta iliro-romake, që dëshmohet edhe nga rrënojat arkeologjike të qytetërimeve antike, dhe sidomos të periudhës së Mesjetës, gjatë së cilës zona ka qenë mjaft e populluar. Bulqiza njihet edhe si vendi ku u zhvilluan betejat e Skënderbeut. Kërkimet arkeologjike në zonën e Bulqizës kanë zbuluar edhe një fortifikim të periudhës së Skënderbeut. Vrojtimet e arkeologëve në një kodër që njihet me emrin Shkëmbi i Kullës së Skënderbeut, zbuloi rrënojat e një fortifikimi që ata besojnë se i shërbyen heroit kombëtar në dy betejat kundër Ballaban Pashës në Vajkal. Në fillim të shekullit ky vend nuk njihej si qytet, por si hani i Duriçit dhe hani i Bobës, ku ndalonin ata që udhëtonin për të bërë në Tiranë dhe në Durrës.
Qyteti i Bulqizës lindi si një qendër punëtorësh në mes dy fshatrave: Duriçit dhe Vajkalit, në vitin 1950. Qyteti filloi me baraka prej druri në vitet 1949-1950 dhe më pas u ndërtuan një numër ndërtesash njëkatëshe, një shkollë, kopshte e çerdhe për fëmijë. Me rritjen e vazhdueshme të mundësive të punësimit, në qytet erdhën punëtorë, kryesisht nga zona e Dibrës, gjë që bëri të nevojshme ndërtimin e objekteve të tjera për banim dhe shërbime sociale.

Gjatë viteve 1948-1990 kjo qytezë e vogël në verilindje të Shqipërisë u bë e njohur si "qyteza e minatorëve", e cila në vitet 1970-1983 u zgjerua edhe më shumë me ndërtesa të reja banimi. Bulqiza është qyteti me rezervat më të mëdha të kromit në Shqipëri.

Populllsia

Sipas Censusit të vitit 2023, Bulqiza ka 26.826[56] banorë, me shpërndarje gjinore pak a shumë të balancuar (13.608 meshkuj dhe 13.218 femra). Kjo balancë midis gjinive pasqyron një strukturë demografike të qëndrueshme, pa imbalancat e ndjeshme që vihen re ndonjëherë në zonat rurale. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, popullsia e bashkisë ka rënë me 27,4% si pasojë e emigrimit, sepse shumë banorë largohen në kërkim të mundësive më të mira në qytete më të mëdha ose jashtë shtetit. Kjo tendencë emigrimi, së bashku me mbështetjen e zonës kryesisht në industrinë minerare, kanë qenë faktorë ndikues në nivelin e përgjithshëm të rritjes dhe prosperitetit të komunitetit.

1. Fëmijët (0-14 vjeç): Grupmosha me numrin më të vogël të popullsinë totale të zonës ajo e më të vegjëlve (0-14 vjeç), me gjithsej 4.732 fëmijë (2.477 meshkuj dhe 2.255 femra).

2. Të rriturit në moshë pune (15-64 vjeç): Ky grup përbën shumicën e popullsisë, me 17.481 individë (8.954 meshkuj dhe 8.527 femra).

3. Të moshuarit (65+ vjeç): Numri total i të moshuarve është 4.613, (2.177 meshkuj dhe 2.436 femra), që përbën afërsisht 17% të popullsisë totale.

Kjo shpërndarje demografike nxjerr në pah disa aspekte kyçe të përgjithshme:

- Përqindja e lartë e të rriturve në moshë pune, por me probleme potenciale për shkak të tendencave të emigrimit që mund të ndikojnë në krahun e disponueshëm të punës.

- Përqindja relativisht e ulët e fëmijëve, që ngre shqetësim potencial në lidhje me mundësitë e bashkisë për rritje në të ardhmen, në qoftë se nuk merren masa për të mbështetur familjet dhe përmirësuar mundësitë që ofrohen në zonë.

- Numri i konsiderueshëm i të moshuarve, që mund të kërkojë më shumë vëmendje për sa i përket shërbimeve sociale, kujdesit shëndetësor, dhe nismave për mbështetjen e komunitetit, veçanërisht duke pasur parasysh natyrën rurale të Bulqizës.

Sipas të dhënave të bashkisë, popullsia dhe numri i familjeve në çdo njësi administrative është si më poshtë:

56. Sipas Regjistrit të Gjendjes Civile, popullsia është 30.100 banorë.

Tabela 9. Popullsia e Bulqizës (2023)

Grupmosha	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Gjithsej	13,608	13,218	26,826
0-14	2,477	2,255	4,732
15-64	8,954	8,527	17,481
65+	2,177	2,436	4,613

Source: INSTAT (2024)

Njësitë administrative	Numri i familjeve
Bulqizë	2,960
Martanesh	590
Fushë-Bulqizë	920
Zerqan	1,210
Gjoricë	1,210
Ostren	1,100
Shupenzë	1,520
Gjithsej[57]	9,510

Burimi: Bashkia Bulqizë (2023)

Ky dallim midis njësive urbane dhe atyre rurale tregon për përqendrimin e banorëve në zonat më qendrore dhe më të aksesueshme (si Bulqiza dhe Shupenza), dhe dëshmon për një shkallë më të madhe shpopullimi në zonat më të thella dhe më pak të zhvilluara ekonomikisht.
Rreth 10% e njësive familjare në bashki kanë kryefamiljare nëna të vetme – një faktor demografik i rëndësishëm që duhet mbajtur parasysh në kuadër të shërbimeve sociale dhe mekanizmave mbështetës që nevojiten për grupet e cenueshme në zonë. Këto statistika flasin për sfida në zhvillimin e zonave rurale, ku aksesi në shërbimet ekonomike, arsimore dhe shëndetësore mund të jetë më i vështirë.

INFRASTRUKTURA: UJI, ENERGJIA ELEKTRIKE DHE JETA SOCIALE

Shërbimet Komunale: Shërbimet Ujore dhe të Energjisë Elektrike[58]

Siguria e aksesit në shërbime komunale si furnizimi me ujë dhe energji elektrike është thelbësor për pjesëmarrjen e grave në ekonomi. Tradicionalisht, gratë në zonat rurale dhe malore të Bulqizës janë ato që sigurojnë ujin që u duhet familjeve. Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë mund të ulë ndjeshëm sasinë e kohës dhe mundimin që kërkohet për kryerjen e këtyre punëve, duke çliruar kohën e grave për t'u marrë me veprimtari që krijojnë të ardhura, ose për t'u arsimuar. Gjithashtu, siguria e furnizimit me energji elektrike është shumë e rëndësishme për aktivitetet e biznesit që kryhen nga shtëpia dhe veprimtari si agrobiznesi dhe përpunimi i bimëve mjekësore, sepse mbështet prodhimtarinë dhe konektivitetin.

57. NJA e Trebishtit mungon në të dhënat e Bashkisë.
58. Plani i Përgjithshëm i Zhvillimit të Territorit, Bashkia Bulqizë.

InfrastruKtura Publike[59]

Planimetria urbane e Bulqizës krijon vështirësi të konsiderueshme për angazhim social, veçanërisht për gratë. Mungesa e hapësirave të përbashkëta dhe qendrave kulturore kufizon mundësitë e grave për të ndërvepruar dhe për t'u përfshirë në jetën e komunitetit. Mungesa e hapësirave publike të sigurta e kufizon edhe më shumë lirinë e grave për t'u angazhuar në veprimtari sociale, për të krijuar rrjete dhe për të pasur akses në shërbime mbështetëse.

Papunësia

Papunësia vazhdon të jetë problem i konsiderueshëm në Bulqizë, ku 38% e grave dhe 62% e të rinjve (15-24 vjeç) janë të papunë, sipas Planit Operacional të Zhvillimit Lokal.[60] Hendeku gjinor në papunësi reflekton problemin më të gjerë të mundësive të kufizuara të grave për punësim, veçanërisht në sektorët formalë. Papunësia e grave lidhet zakonisht me rolet tradicionale gjinore, mungesën e aksesit në arsimim dhe trajnim, dhe pengesat që hasin për të hyrë në sektorët e dominuar nga meshkujt, si minierat dhe ndërtimi.Politikat e punësimit me ndjeshmëri gjinore duhet të përqendrohen në rritjen e aksesit të grave në mundësitë për punësim, si në sektorë tradicionalë, ashtu edhe në sektorë të rinj. Nisma të tilla si trajnimi profesional, stazhi i punës dhe ofrimi i mbështetjes për gratë në sektorët jotradicionalë, si teknologjia, agroturizmi dhe bujqësia e qëndrueshme, mund të ndihmojnë në kapërcimin e hendekut gjinor në punësim. Gjithashtu, hartimi i planeve të zhvillimit lokal me më shumë përfshirje, që bazohen në analizë gjinore dhe i japin përparësi fuqizimit ekonomik të grave, do të ndihmonin në adresimin e këtyre problemeve.

Dallimet në Punësim

Sipas informacionit në Planin Operacional të Zhvillimit Lokal,[61] rreth 38% e grave dhe 62% e të rinjve në bashki janë të papunë. Ndonëse papunësia e të rinjve është shqetësim i konsiderueshëm, duhet trajtuar gjithashtu edhe dimensioni gjinor i papunësisë. Në Bulqizë, gratë, veçanërisht ato në zonat rurale, përballen shpesh me barriera shtesë në punësim, si rolet gjinore tradicionale që u japin përparësi përgjegjësive të tyre në shtëpi ose në rolet e përkujdesjes, aksesi i kufizuar në arsim dhe mungesa e rrjeteve profesionale apo mbështetja për gratë sipërmarrëse. Përveç kësaj, gratë në zonat rurale mund të përjashtohen nga sektorët jotradicionalë, si minierat, që janë një industri e rëndësishme në ekonominë e Bulqizës. Mundësitë e punësimit në bujqësi dhe sektorët e shërbimeve, si agroturizmi, mund të jenë më të arritshme, por shpesh nënvlerësohen dhe nuk financohen sa duhet. Politikat e punësimit me ndjeshmëri gjinore që fokusohen në krijimin e mundësive për gratë, veçanërisht nëpërmjet trajnimeve profesionale, programeve të mentorimit dhe mbështetjes për bizneset me pronare gra, janë thelbësore për të zvogëluar hendekun gjinor në punësim. Programet të posaçme me fokus vajzat e reja dhe grupet e margjinalizuara – si gratë rome dhe egjiptiane – mund të sigurojnë përfshirje më të madhe të grave. Programet që nxisin gratë të konsiderojnë mundësinë e punësimit në sektorë jotradicionalë dhe përmirësojnë aksesin e tyre në burime financiare për ndërmarrje sipërmarrëse, mund të ndihmojnë të sjellin ndryshime në rolet gjinore dhe të krijojnë mundësi më të diversifikuara për punë.

SHËRBIMET SOCIALE DHE NDIHMA EKONOMIKE

Ndihma Ekonomike

Në vitin 2023, afërsisht 2.200 familje, ose rreth 9.500 persona në Bulqizë përfituan nga programe të ndihmës ekonomike.[62] Këto programe janë jetësore për eliminimin e varfërisë, veçanërisht për familjet në vështirësi për shkak të papunësisë, paqëndrueshmërisë ekonomike dhe vështirësive të tjera sociale. Megjithatë, shpërndarja e ndihmës ekonomike në Bulqizë mund të mos bëhet me ndjeshmëri gjinore që mund të shkaktojë dallime gjinore të paqëllimshme në shpërndarjen e burimeve.

59. Po aty.
60. Plani Operacional i Zhvillimit Lokal, Bashkia Bulqizë, 2020.
61. Bashkia Bulqizë, 2020.
62. Sektori i Kujdesit Social, Bashkia Bulqizë.

Gratë në Bulqizë, veçanërisht ato në zonat rurale, përballen me vështirësi të mëdha ekonomike për shkak të aksesit të kufizuar në burime, shërbime sociale dhe në mundësi për krijimin e të ardhurave. Veçanërisht familjet me kryefamiljare gra kanë më tepër gjasë të vuajnë nga varfëria për shkak të aksesit më të paktë në punësim ose në mbështetje financiare krahasuar me familjet me kryefamiljarë meshkuj.

Ndër problemet gjinore për të pasur akses në ndihmë ekonomike përfshijnë:[63]

- Aksesi në burimet financiare: Gratë shpesh përballen me pengesa për të pasur akses në tokë, kredi dhe prona, veçanërisht në zonat rurale ku rolet tradicionale gjinore janë më të ngurta.

- Roli si amvisë dhe në familje: Gratë janë shpesh personat kryesorë që ofrojnë përkujdesje brenda familjes gjë që e kufizon mundësinë e tyre për të marrë pjesë në programet e ndihmës ekonomike apo trajnim që mund të rrisë pavarësinë e tyre financiare.

- Mungesa e politikave me ndjeshmëri gjinore: Programet e ndihmës ekonomike që nuk marrin parasysh pabarazitë gjinore mund të përjashtojnë pa dashje gratë, veçanërisht ato që nuk kanë mbështetjen e burrave që mund të jenë fituesit kryesorë të të ardhurave në familjet e tyre.

Arsimi

Në Bulqizë ka tre kopshte, 51 shkolla 9-vjeçare dhe 6 shkolla të mesme, 88% e të cilave janë në zonat rurale. Për shkak të shtrirjes gjeografike, nxënësit e fshatrave të thella detyrohen të përshkojnë rrugë të gjata për të ndjekur shkollën. Edhe në kushtet e dimrit të ashpër dhe motit te keq, një pjesë e tyre e bëjnë rrugën në këmbë ose me mjete të rastit. Infrastruktura arsimore në bashki në mjaft raste është e vjetruar dhe mungojnë mjediset sportive, si palestra dhe fusha sporti. Me gjithë përpjekjet për rritjen e nivelit arsimor e kulturor të të rinjve, shkollat përgjithësisht nuk kanë biblioteka.

Tabela 10. Arsimi parashkollor

Lloji i institucionit	Numri i institucioneve	Gjithsej fëmijë	Vajza	Djem
Kopshte publike	3	264	116	148
Grupe parapërgatitore	7	432	238	194

Tabela 11. Arsimi i detyruar dhe i mesëm (2018)

Niveli i arsimit	Numri i shkollave	Gjithsej nxënës	Vajza	Djem
Arsimi i detyruar	51	3,876	1,769	2,107
Arsimi i mesëm	6	1,095	534	561

Burimi: Bashkia Bulqizë "Plani Social 2020-2023"

Bashkia ka tregues të ulët të nivelit arsimor në krahasim me mesataren e qarkut dhe të vendit. Vetëm 22,7% e banorëve mbi 15 vjeç kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe vetëm rreth 4% kanë përfunduar arsimin universitar ose pasuniversitar, në krahasim me përkatësisht 24,26% dhe 5,2% në nivel qarku dhe 31,4% dhe 11,8% në nivel vendi.

63. Po aty.

Tabela 12. Shkolla profesionale gjeologji miniera dhe e shërbimeve sociale

Shërbime sociale		Gjeologji-miniera	
Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
6	19	28	-

Burimi: Bashkia Bulqizë

Shkolla Profesionale Gjeologji-Miniera në Bulqizë është hapur me mbështetjen e ndërmarrjes Alb Crom (ACR), që jep bursa për nxënësit. Programi zgjat katër vjet dhe çdo vit shkollën e ndjekin rreth 120 nxënës gjithsej, me 35-40 nxënës për çdo vit arsimor. Në përfundim të shkollës, pothuajse 100% e nxënësve fillojnë punë, që është tregues i partneritetit të fortë midis arsimit dhe sektorit minerar të zonës.

Shëndetësia

Në Bulqizë ka 750 persona të regjistruar me aftësi të kufizuara dhe institucionet e kujdesit shëndetësor janë të kufizuara – ka vetëm një spital në qytet dhe një qendër shëndetësore në vetëm një prej shtatë njësive administrative jashtë qytetit. Në bashki punojnë 15 mjekë dhe 120 infermierë, që i shërbejnë një popullate me nevoja të konsiderueshme shëndetësore.[64] Me gjithë shërbimin e vyer që ofrohet, duhet konsideruar ndikimi gjinor i sistemit shëndetësor.Gratë, veçanërisht ato në zonat rurale, përballen me vështirësi të konsiderueshme për të pasur akses në shërbime shëndetësore. Ato janë shpesh personat kryesorë që kujdesen për fëmijët, të moshuarit, dhe anëtarët e familjes me aftësi të kufizuara dhe kanë më shumë gjasa të kenë probleme shëndetësore që lidhen me shëndetin riprodhues, si kujdesi amësor, planifikimi familjar dhe menopauza. Gjithashtu, gratë me aftësi të kufizuara mund të përballen me më shumë vështirësi për të pasur akses në shërbim shëndetësor të specializuar, sepse institucionet shëndetësore mund të mos kenë burime të mjaftueshme ose personel të trajnuar për t'iu përgjigjur nevojave të tyre. Në Bulqizë, trajtimi i aspekteve si papunësia, reformat e ndihmës ekonomike dhe aksesi në shërbime shëndetësore, kërkon një qasje me ndjeshmëri gjinore, për të siguruar që gratë të mos ndikohen në mënyrë joproporcionale nga vështirësitë sociale dhe ekonomike. Adresimi i pengesave me të cilat përballen gratë në tregun e punës, garantimi që ato të përfshihen në programet e ndihmës ekonomike dhe përmirësimi i aksesit të grave në shërbimin shëndetësor – veçanërisht gratë në zonat rurale dhe ato me aftësi të kufizuar – janë hapa të domosdoshëm për krijimin e një komuniteti më përfshirës dhe të drejtë. Politikat dhe reformat me ndjeshmëri gjinore duhet të jenë në qendër të çdo nisme zhvillimore për të garantuar që gratë në Bulqizë të fuqizohen në aspektin shoqëror dhe ekonomik.

Bizneset dhe Aktiviteti Ekonomik në Zonë

Aktiviteti ekonomik është i orientuar nga bujqësia, blegtoria dhe industria minerare.[65] Bujqësia është e organizuar në ferma të vogla familjare me sipërfaqe të kufizuar toke të punueshme. Zona ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e kulturave bujqësore, foragjereve, frutikulturës, vreshtarisë, etj. Rreth 34,5% e të punësuarve në Bulqizë janë të angazhuar në sektorin bujqësor.[66] Ndërkohë, një tjetër burim i rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të kësaj zone janë agrobizneset, si edhe kultivimi dhe përpunimi fillestar i bimëve mjekësore, me të cilat zona është mjaft e pasur. Qyteti është ndërtuar në funksion të industrisë minerare dhe rezervave të mëdha të kromit. Falë kësaj pasurie, 40% e ndërmarrjeve në Bulqizë lidhen me industrinë minerare, ku janë punësuar 77% e krahut aktiv të punës në këtë zonë. Gjatë tre viteve të fundit numri i ndërmarrjeve aktive ka mbetur pothuajse konstant, me pak ndryshim, nga 548 në vitin 2021 në 556 në vitin 2023. Një vështrim më nga afër tregon se numri i ndërmarrjeve të drejtuara nga meshkujt është në mënyrë konstante më i lartë se i atyre të drejtuara nga gratë, me 417 ndërmarrje të drejtuara nga meshkujt në vitin 2021 – që u rrit në 430 në vitin 2023, ndërsa bizneset e drejtuara nga gratë pësuan një rënie të lehtë nga 131 në vitin 2021 në 126 në vitin 2023.

64. Sektori i shëndetësisë, Bashkia Bulqizë.
65. Plani i Përgjithshëm i Zhvillimit të Territorit, Bashkia Bulqizë.
66. Po aty.

Tabela 13. Ndërmarrjet aktive

Ndërmarrjet aktive	2021	2022	2023
Burra	417	427	430
Gra	131	131	126

Ndërmarrje aktive sipas aktivitetit ekonomik, treguesve dhe vitit	2021	2022	2023
I. Prodhuesit e të mirave	147	152	154
II. Ofruesit e shërbimeve	401	406	402

Burimi: INSTAT (2024).

Bujqësia

Bulqiza ka 8.050 hektarë tokë bujqësore, por një problem i madh është mungesa e fermave të regjistruara zyrtarisht. Zona karakterizohet nga bujqësia njësezonale për shkak të dimrit të gjatë. Gratë, veçanërisht në zonat rurale, përballen me pengesa të konsiderueshme për të pasur akses në tokë, sepse tradicionalisht të drejtat e pronësisë mbi tokën trashëgohen nga anëtarët meshkuj të familjes. Si rrjedhim, gratë shpesh nuk kanë kontroll mbi vendimet që lidhen me bujqësinë dhe të ardhurat e krijuara nga bujqësia, me gjithë kontributin e tyre të konsiderueshëm në punët e bujqësisë. Sa i përket prodhimit bujqësor, në kultivimin e kulturave bujqësore në Bashkinë Bulqizë tendencat nga viti 2021 në vitin 2023 kanë qenë të ndryshueshme. Sipërfaqja e kultivuar me drithëra u rrit nga 1.303 hektarë në vitin 2021 në 1.364 hektarë në vitin 2022, dhe më tej pësoi një rënie të lehtë, me 1.306 hektarë në vitin 2023. Po ashtu, prodhimi i drithërave u rrit nga 7.919 ton në vitin 2021 në 8.159 ton në vitin 2022, me të njëjtin nivel prodhimi në vitin 2023. Ndër drithërat më kryesore janë gruri, misri, thekra, elbi dhe tërshëra.

- Prodhimi i grurit, për shembull, pati një rritje të lehtë në vitin 2022, me 1.374 ton, por ra përsëri në vitin 2023 në 1.230 ton.
- Kultivimi i misrit mbeti konstant me një prodhim 6.499 ton në vitin 2021, me një rritje të lehtë në 6.505 ton në vitin 2022, dhe më tej në 6.870 ton në vitin 2023.
- Thekra, e cila pati një rritje të konsiderueshme në sipërfaqen e kultivuar në vitin 2022, pësoi përsëri rënie në vitin 2023.

Lidhur me kultivimin e perimeve, sipërfaqja e mbjellë me perime u rrit nga 253,6 hektarë në vitin 2021 në 279,8 hektarë në vitin 2022, ndërsa prodhimi u rrit nga 6.844,9 ton në vitin 2021 në 7.030 ton në vitin 2022, dhe më tej në 7.450 ton në vitin 2023.

Tabela 14. Të dhëna për prodhimin bujqësor (2023)

Kultura bujqësore	Sipërfaqja në prodhim (ha)	Prodhimi (ton)
Drithëra	1306.0	8330
- Grurë	270.0	1233
- Misër	960.0	6870
- Thekër	52.0	154
- Elb	4.0	15
- Tërshërë	20.0	61

(Vazhdon në faqen tjetër)

Kultura bujqësore	Sipërfaqja në prodhim (ha)	Prodhimi (ton)
Perime	278	7450
Patate	155	5030
Fasule të bardha	25	37
Foragjere	6234	143225
Bimë mjekësore	1	9

Buimi: INSTAT 2024.

Një mundësi zhvillimi që vlen të përmendet është potenciali i pashfrytëzuar i bimëve mjekësore dhe aromatike. Në vitet 2021 dhe 2022, këto bimë u kultivuan në një sipërfaqe 0,3 hektarë, me një prodhim minimal prej vetëm 0,6 ton. Në vitin 2023 sipërfaqja e kultivuar u rrit në 1 hektar dhe prodhimi pësoi rritje të konsiderueshme, me 9 ton (produkt i freskët). Në Bulqizë është ngritur kohët e fundit një qendër kryesore grumbullimi e bimëve mjekësore dhe aromatike. Kjo qendër grumbullon kryesisht bimë të egra, ndërkohë që edhe kultivimi po zhvillohet gradualisht. Kultivimi i bimëve mjekësore paraqet një fushë premtuese për rritje ekonomike. Këto bimë janë me vlerë për produkte mjekësore dhe kozmetike lokale dhe mund të ofrojnë mundësi të reja për fuqizimin ekonomik të grave, veçanërisht ato në zonat rurale ku gratë tradicionalisht kanë pasur rol në kultivimin e bimëve mjekësore. Sipërfaqja e vreshtave në kultivim aktiv ka mbetur konstante, 28 hektarë, nga viti 2021 deri në vitin 2023, që tregon se sipërfaqja e mbjellë me vreshta as nuk është rritur e as nuk është pakësuar gjatë kësaj periudhe. Megjithatë sasitë e prodhuara kanë pasur luhatje, me një rritje të lehtë nga 303 ton në vitin 2021 në 305 ton në vitin 2022, dhe pastaj një rënie në 260 ton në vitin 2023, që përbën një rënie me afërsisht 14,75% krahasuar me vitin e mëparshëm.

Tabela 15. Prodhimi i vreshtarisë

	Sipërfaqja në prodhim (ha)			Prodhimi (ton)		
Viti	2021	2022	2023	2021	2022	2023
Vreshta	28	28	28	303	305	260

Burimi: INSTAT, 2024.

Sipërfaqja totale me pemë frutore në Bulqizë pësoi një rritje shumë të vogël, nga 314 hektarë në vitet 2021–2022, në 315 hektarë në vitin 2023. Edhe sipërfaqja në prodhim aktiv gjithashtu pati një rritje të lehtë, nga 247 hektarë në vitin 2021 në 255 hektarë në vitin 2023. Në prodhimin total të frutave pati luhatje, me një rritje të konsiderueshme nga 4.076 ton në vitin 2021 në 5.046 ton në vitin 2022, dhe një rënie të lehtë, në 4.957 ton, në vitin 2023.

Tabela 16. Prodhimi i frutave

Lloji i pemës frutore	Sipërfaqja totale (ha)			Sipërfaqja në prodhim (ha)			Prodhimi (ton)		
Viti	2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023
Mollë	86	86	6	7	7	79	676	1.702	1.786
Kumbulla	69	69	69	61	61	61	345	1.697	1.273
Qershi	56	56	56	47	47	49	312	584	286
Nektarina/pjeshka	0	0	0	0	0	0	56	47	68
Gështenja	27	27	27	26	26	26	100	238	294
Arra	70	70	70	33	33	34	168	372	539
Gjithsej pemë frutore	314	314	315	247	249	255	4.076	5.046	4.957

Statistikat tregojnë edhe për shpërndarjen e fermerëve sipas gjinisë në njësi të ndryshme administrative në Bashkinë Bulqizë. Nga një total prej 6.737 fermerësh, 5.730 janë burra (85,1%) dhe 1.007 janë gra (14,9%), çka dëshmon për pabarazi gjinore të ndjeshme në pjesëmarrje në bujqësi. Shifrat vënë në pah hendekun e theksuar gjinor në bujqësi në Bulqizë, ku numri i fermerëve është në mënyrë konstante më i lartë se ai i fermereve në të gjithë sektorët. Kjo tendencë sugjeron se gratë kanë pjesëmarrje të kufizuar në bujqësi, që mund të jetë si rezultat i ndikimit të normave shoqërore, nivelit të aksesit në burime ose mundësi ekonomike.

Tabela 17. Fermerët në Bulqizë sipas njësisë administrative dhe gjinisë

NJA-të	Fermerët	Meshkuj	Femra
Bulqizë Vajkal 1 dhe 2	305	260	45
Martanesh	106	91	15
Fushë Bulqizë	1229	1045	184
Zerqan	1500	1275	225
Suspense	1166	992	174
Gjoricë	1429	1215	214
Ostren	761	647	114
Trebisht	241	205	36
Gjithsej Bulqizë	**6737**	**5730**	**1007**

Burimi: Bashkia Bulqizë 2023

Sipas të dhënave të INSTAT-it, në të gjithë territorin e bashkisë vetëm 449 fermerë janë të regjistruar dhe kanë NIPT .

Llojet e bagëtive dhe numri i krerëve për secilin lloj në Bashkinë Bulqizë fletë për ekzistencën e një nënsektori bujqësor të diversifikuar:

- Gjedhë: 4.557 krerë, që dëshmon për rëndësinë e mbarështimit të gjedhëve, veçanërisht për prodhimin e mishit dhe qumështit.
- Dhen: Me 8.700 krerë, mbarështimi i dhenve ka rol të rëndësishëm dhe kontribuon në prodhimin e mishit, leshit dhe të qumështit.



- Dhi: Në zonë ka 6.300 krerë, që thekson rëndësinë e prodhimit të mishit dhe qumështit, veçanërisht në zonat kodrinore dhe malore.
- Kafshë barre: 1.356 krerë gjithsej, që tregon se ato vazhdojnë të përdoren, me gjasë për transport dhe punë bujqësore në zonat rurale.
- Pula për vezë: Në zonë ka 47.000 pula dëshmon për një aktivitet të konsiderueshëm të rritjes së shpendëve, veçanërisht për prodhimin e vezëve, që arriti në 6,345 milion kokrra në vitin 2023.

- Kosheret: Me 6.130 koshere, bletaria vazhdon të jetë aktivitet i rëndësishëm tipik, që kontribuon në prodhimin e mjaltit (55 ton).

Në vitin 2023, prodhimi total i mishit (peshë e gjallë) në Bashkinë Bulqizë ishte 1.448 ton, ku përfshihet mishi i disa llojeve të bagëtive.

- Gjedhi përbënte pjesën më të madhe, me prodhim 1.017 ton mish, që vë në pah mbizotërimin e mbarështimit të gjedhëve në zonë.
- Dhentë kontribuan 210 ton mish, ndjekur nga dhitë, nga të cilat u morën 127 ton mish.
- Shpendët kontribuan me 94 ton mish, që përbën një pjesë më të vogël, por të rëndësishme, të prodhimit të mishit.
- Vihet re mungesa e të dhënave për sasinë e mishit të derrit, që flet për mungesën e mbarështimit të derrave në zonë.

Tabela 18. Prodhimi i mishit, peshë e gjallë, në vitin 2023 (ton)

Gjithsej	Gjedhë	Dhen	Dhi	Shpendë
1.448	1.017	210	127	94

Burimi: Baza e të dhënave e INSTAT-it

Prodhimi i përgjithshëm i qumështit në Bashkinë Bulqizë arriti në 12.232 ton, pjesa më të madhe e të cilit ishte qumësht lope:

- Lopët kontribuan pjesën më të madhe të qumështit, me 11.205 ton, që vë në pah mbizotërimin e rritjes së gjedhëve për prodhimin e qumështit.
- Dhitë prodhuan 615 ton qumësht, që tregon rolin suplementar të tyre si burim i qumështit, veçanërisht në zonat ku mbizotëron mbarështimi i dhive.
- Dhentë kontribuan me 413 ton qumësht, që përbën pjesën më të vogël, por megjithatë të rëndësishme, në prodhimin e përgjithshëm të qumështit.

Tabela 19. Prodhimi i qumështit në vitin 2023 (ton)

Gjithsej	Lopë	Dele	Dhi
12.232	11.205	413	615

Burimi: Baza e të dhënave e INSTAT-it

Në territorin e Bulqizës ka vetëm 5 baxho të cilat ndodhen: 1 në NJA-në e Zerqanit, 1 në Bulqizë, dhe 3 në Martanesh. Bagëtitë që rriten për prodhimin e qumështit në Bashkinë Bulqizë përfshijnë:

- Lopët: mjelja e qumështit u bë nga 4.150 lopë, që dëshmon për rolin qendror të mbarështimit të gjedhëve në prodhimin e qumështit, i cili përbënte pjesën më të madhe në sasinë prej 12.232 ton të qumështit të prodhuar gjithsej.
- Delet për qumësht: Numri i deleve të rritura për qumësht ishte 7.500, që pasqyron kontributin e tyre në prodhimin e qumështit nga delet (413 ton).
- Dhitë për qumësht: Me 5.300 dhi të rritura për qumësht, mbarështimi i dhive siguroi një burim qumështi shtesë, duke kontribuar 615 ton në sasinë e përgjithshme të qumështit të prodhuar.

Tabela 20. Bagëtitë për qumësht në vitin 2023

Lopët	Delet për qumësht	Dhitë për qumësht
4.150	7.500	5.300

Burimi: Baza e të dhënave e INSTAT-it

Bashkia Bulqizë shënoi rezultate të dukshme në produkte të tjera që lidhen me blegtorinë. Prodhimi i vezëve ishte i konsiderueshëm, me 6,345 milion kokrra, që tregon për vendin që zë rritja e shpendëve në ekonominë e zonës. Po kështu, prodhimi i leshit ishte 19 ton – edhe ky tregues i mbarështimit të dhenve – megjithëse në një shkallë relativisht të vogël. Krahas këtyre u prodhua një sasi totale prej 55 ton mjaltë, që pasqyron kontributin e bletarisë në diversifikimin e bujqësisë në zonë.

Tabela 21. Prodhime të tjera nga bagëtitë në vitin 2023 (Ton)

Vezë / 000 kokrra	Lesh	Mjaltë
6.345	19	55

Burimi: Baza e të dhënave e INSTAT-it

Të dhënat për blegtorinë nga sektori i bujqësisë në Bashkinë Bulqizë janë pak më të ndryshme nga informacioni i botuar në bazën e të dhënave të bujqësisë të INSTAT-it.

Tabela 22. Blegtoria në Bulqizë 2024

NJA	Fermerët	Gjedhë	Dele	Dhi	Kuaj	Shpendë	Koshere
Bulqizë	294	368	210	11	20	4.417	47
Fushë Bulqizë	625	578	406	200	212	11.964	434
Zerqan	919	515	448	299	265	12.004	1.755
Shupenzë	1.063	311	669	494	201	10.560	485
Gjoricë	820	482	821	436	143	13.592	335
Ostren	437	364	2.170	728	211	2.529	800
Trebisht	172	147	1.346	35	111	1.025	417
Martanesh	192	302	633	588	47	2.196	642
Gjithsej Bulqizë	**4.522**	**3.067**	**6.703**	**2.791**	**1.210**	**58.287**	**4.915**

Burimi: Bashkia Bulqizë 2024

Turizmi

Bulqiza dhe zonat përreth ofrojnë mundësi të panumërta për turizëm, kryesisht turizëm malor, që mbetet më i preferuari, si për turistët e huaj, ashtu edhe për ata vendas. Malet e larta, biodiversiteti, natyra dhe klima e bëjnë këtë zonë shumë të pëlqyer për turizëm në çdo stinë të vitit. Natyra fantastike dhe e paprekur e Bulqizës është thesar i çmuar. Sipas të dhënave të Bashkisë Bulqizë, në vitin 2024 zonën e vizituan afërsisht 19.690 vizitorë.[67]

67. Ky informacion u dha nga zëvendës kryetari i bashkisë Haxhi Pulja gjatë mbledhjes së datës 21.01.2025

Me ndërtimin e Rrugës së Arbrit, turizmi mund të marrë një dimension tjetër, pasi ajo ofron lehtësi infrastrukturore për të vizituar zonën dhe do të shërbejë si një urë e mirë për shkëmbime kulturore dhe për promovimin e bukurive të kësaj zone. Liqeni i Zi është një nga mrekullitë natyrore të Bulqizës, që ia vlen të vizitohet. Shpatet e pjerrëta të veshura me pyje ahu e pishe dhe uji i pastër si kristali, krijojnë një peizazh të pakrahasueshëm. Quhet Liqeni i Zi për shkak të thellësisë së madhe dhe depozitimeve të kromiteve në shtratin e liqenit, që i japin ujit ngjyrë të errët. Ai është një monument natyror që mirëpret vizitorët që duan të shijojnë bukuritë e natyrës. Një arsye më shumë për të vizituar Bulqizën janë dhe pamjet e mrekullueshme që ofron lugina e Drinit të Zi, kurse edhe për të apasionuarit e *rafting*, ky lumë u ofron mundësi të vozitin me varkat e rafting. Vizitorët që duan t'u ngjiten maleve mund të përshkojnë rrugën që të çon tek Liqeni i Thatë në malin Kamavec. Ujëvara e Duriçit është një tjetër atraksion turistik në afërsi të qytetit të Bulqizës, në shpatin verior të malit të Kaptinës. Ujëvara buron nga Liqeni i Zi dhe ka pamje mahnitëse. Liqenet e Dhoksit janë një tjetër atraksion turistik në Bulqizë. Edhe kullat shekullore tërheqin vizitorë të shumtë në Bulqizë. Më të njohurat janë kulla 200-vjeçare në njësinë administrative Fushë-Bulqizë, dhe kulla e Salë Markës në fshatin Zogje, një kullë guri tepër e veçantë. Këto kulla, të shndërruara në bujtina, tashmë prej vitesh janë kthyer në atraksionet më rëndësishme për turistë vendas dhe të huaj. Veç njohjes me historinë dhe traditën e këtyre kullave, aty mund të shijohen dhe gatimet bio dhe tradicionale të zonës.[68]Sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit për Rrjetin e Zonës së Mbrojtur, në Bashkinë Bulqizë ka dy zona shumë të rëndësishme mjedisore dhe turistike: Shebenik-Jabllanicë, me sipërfaqe prej 167,6 ha, dhe Mali me Gropa-Bizë-Martanesh, me sipërfaqe prej 9.036 ha. Gjithashtu, ka edhe disa gjeomonumente, si shpella, gurë, shkëmbinj, gropa, etj., që janë shpallur monumente natyrore. Në këtë zonë ka gjithsej 17 monumente natyrore.[69] Bazuar në Planin Operacional të Zhvillimit Lokal (POZHL) (Bashkia Bulqizë, 2016), monumentet në këtë bashkie janë si vijon:

Tabela 23. Monumentet në bashkinë bulqizë

MONUMENTE NATYRORE	GJEOMONUMENTE	MONUMENTE KULTURORE
Lugina e Drinit të Zi	Shpella e Urës së Qytetit	Teqeja e Bllacës
Malësia e Pratit	Shkëmbi i Qytetit	Teqeja e Babë Shehut (Boçevë)
Pllaja e Peladhit	Xixëll Martanesh	Kisha e Kovashicës
Mali i Homeshit	Shpella e Ftohtë Gjuras	Xhamia e Vleshës
Hurdhat e Bllacës	Shpella e Xixëllës (Valikardhë)	Kulla e Krajkave
Delgjurra		
LLiqeni i Zi	Hidromonumente:	Fusha e Kalasë
Liqeni i Bardhë	Tre Çezmat e Zerqanit	Kisha e Kaziakut
Zabeli i Madh	Ujëvara e Duriçit	Maja e Varrezave (Sofraçan)
Zalli i Bulqizës	Gurra e Vakëfit të Zerqanit	Gardhi i Gurrës
	Liqeni i Zi	
Drini i Zi	Biomonumente:	Lapidari i krijimit të batalionit partizan
Zalli i Okshtunit	Bregu i Pepesë	Lapidari i dëshmorit të atdheut Mane Kazani
Mali i Ramnagores	Qarri i Muharremit	Lapidari i Tercilio Kardinalit
	Qarri i Kovashicës	
	Qarri i Gjinovecit	
	Pisha Zogjë	Kulla e Markëve
	Qarri i Peladhit	Kulla e Kurtëve (Shupenzë)
	Zabeli i Madh Zerqan	

68. Shih: https://bulqiza.gov.al/turizmi-bulqize/; https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/Databaze-e-burimeve-turistike_18OCT.-2017_Brr-Diber.pdf; https://agroturizem.gov.al/kulla-hupi/

69. Vlerësimi i bashkisë i kryer nga projekti PGLP i USAID, 2019.

Divizioni – Projekti "Parku Tematik Retro Bulqizë 2024" [70]

Parku Tematik Retro Bulqizë 2024, është projekti inovativ turistik që do të transformojë një zonë të degraduar, dikur zonë ushtarake, në një destinacion të ri për vizitorët dhe turistët gjithnjë e më të shumtë të veriut të vendit, e në mënyrë të veçantë të qarkut Dibër, ku Rruga e Arbrit ka sjellë ndryshime të mëdha në shumë drejtime. Ndër të tjera, projekti rivitalizon edhe një zonë minerare, duke ndërtuar aty një aset tjetër turistik, Divizionin, i cili do të kthehet në një nga qendrat më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit.

"Divizioni" i rilindur do të jetë një destinacion turistik mikpritjeje, me treg turistik prodhimesh të zonës, hoteleri dhe shërbime për ata që do të duan të ndalen kalimthi apo të qëndrojnë më gjatë për eksplorimin e natyrës magjike të kësaj zone.

Projekti synon të krijojë dhoma hoteli të stilit retro, dhoma me kapacitet më të madh për akomodimin e grupeve (hostele) si edhe një dhomë muze me mobilie dhe teknologji nga periudha e komunizmit. Gjithashtu, plani është që të integrohen ambiente të reja për ngrënie mëngjesi dhe kafeteri, hapësirë për administratën dhe recepsionin, si edhe banja të ndara dhe të përbashkëta, për të plotësuar nevojat e vizitorëve.

Kultura dhe Traditat

Punimet artizanale kanë vend të veçantë në trashëgiminë kulturore në Bashkinë Bulqizë. Veshjet popullore përbëjnë një ekspozitë të vërtetë të artit popullor. Të qepura me shumë mund, plot stil e bukuri, ato sot përcjellin traditën e pasur të kësaj zone. Larmia e kombinimit të ngjyrave dhe detajeve i bën këto veshje të mahnitshme. Në çdo element të tyre gjen një pjesëz arti që buron nga shpirti i pasur i vajzave dhe grave bulqizake.

Gratë e zonës vazhdojnë edhe sot të merren me artizanat. Kostumet popullore bulqizake janë nga më të veçantat në Shqipëri dhe vazhdojnë të qepen edhe sot nga artizanet e zonës, të cilat edhe i shesin, duke u kthyer në një biznes të vogël familjar. Ato përdoren edhe në dasmat e zonës, që është një mënyrë për ruajtjen e traditës së të parëve.

Veshja e grave përbëhet nga qasha prej leshi, me ngjyrë të zezë për gra dhe e kuqe për vajza, jeleku i zbukuruar me serm, barkore e bardhë para, dhe me një brez leshi të kuq në mes, këmishë atlasi me mëngë të gjata, jepeku – shamia e kokës me ngjyra të ndezura, të brendshme dhe çorape të bardha, mitan me ngjyra, ose një tabes në vend të këmishës.

Një nga këto elementë të kostumit popullor, qasha, është veshje e trashëguar brez pas brezi dhe është përdorur edhe pas viteve 90-të. Sipas gojëdhënave popullore, qasha është element kryesor i kostumit popullor, e trashëguar që nga koha e Skënderbeut.

* * *

Rajoni etnografik i Gollobordës ndodhet në pjesën juglindore të Dibrës. Golloborda ruan gjurmë civilizimi të lashtë, si edhe një traditë të pasur të kulturës materiale dhe shpirtërore.

Veshja tradicionale e grave në këtë rajon pasqyron traditën e lashtë të shprehjes estetike, duke nxjerrë në pah disa nga elementet më të vjetra dhe më domethënëse të mjeshtërisë tradicionale. Motivet në këtë art folklorik janë të lidhura ngushtë me historinë e zonës dhe me dukuritë më të gjera kulturore e artistike të banorëve të zonës. Burimet historike na kanë mundësuar të gjurmojmë origjinën e shprehjeve artistike në këtë veshje popullore, që është ruajtur në formë të paprekur në të gjithë zonën e Gollobordës. Motivet a ndryshme të qëndisura, të pasura

70. Shih: https://www.kryeministria.al/en/newsroom/prezantohet-projekti-per-parkun-tematik-retro-bulqize-2024-nje-destinacion-turistik-mikpritjeje-dhe-motor-i-ri-ekonomie-per-zonen-e-bulqizes/

me simbolizëm unik, dëshmojnë për zejtarinë e jashtëzakonshme dhe mjeshtërinë historike që daton nga antikiteti. Nëpërmjet qëndisjes së simboleve dhe motiveve të ndryshme, kjo veshje përcjell psikologjinë shoqërore, ku elementet dekorative u përshtaten me kujdes traditave popullore dhe historisë së zonës. Është fakt i njohur se trashëgimia shpirtërore nuk është statike, ajo evoluon me kalimin e kohës duke ngërthyer elemente të reja gjatë periudhave të ndryshme historike. Megjithatë, veçoritë origjinale në këtë veshje tradicionale janë ruajtur me kujdes që nga kohët e lashta.
Procesi krijimit të këtyre punimeve artizanale i vë theks të madh ruajtjes së traditës, teknikës së punimit, përpikërisë së motiveve të qëndisura dhe cilësisë së materialeve të zgjedhura. Si një formë e artit folklorik, veshja tradicionale përfaqëson një pjesë të rëndësishme të kulturës materiale, ndërsa motivet artistike të shprehura në këto veshje shërbejnë si një komponent thelbësor i trashëgimisë shpirtërore të një komuniteti apo grupi etnik.

Shtojca 2: Konteksti Kombëtar i Barazisë Gjinore

Korniza ligjore në Shqipëri, sidomos për sa i përket barazisë gjinore, është ndërtuar mbi dispozitat kushtetuese dhe ligjore që synojnë të sigurojnë të drejta të barabarta të burrave dhe grave.

Neni 18/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk duhet të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etniciteti, gjuha, bindjet politike, ose karakteristika të tjera.

Gjatë viteve, Shqipëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të harmonizuar kornizën e saj ligjore me standardet ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe luftimin e diskriminimit, dhunës, dhe abuzimit në familje me bazë gjinore. Ndër ligjet kryesore që kontribuojnë në këtë kornizë ligjore përfshihen:

1. **Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri"** (Ligji nr. 9970/2008): Ky ligj trajton çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, për sigurimin e mundësive të barabarta për burrat dhe gratë në ushtrimin e të drejtave të tyre, që ata të kontribuojnë në sektorë të ndryshëm të shoqërisë. Ai gjithashtu parashikon masa të veçanta të përkohshme, ndër të cilat edhe kuota gjinore prej 30% për poste politike dhe vendimmarrëse.

2. **Kodi Zgjedhor (Ligji nr. 10019/2008):** Me ndryshimet që iu bënë në vitin 2012, në Kod u përfshinë kuotat gjinore në procesin zgjedhor, duke siguruar që asnjëra gjini të mos përfaqësohej nga më pak se 30% në listat e kandidatëve të partive politike për zgjedhjet parlamentare. Përpos kësaj, në vitin 2020 dhe vitin 2024 u përfshinë dispozita të specifike për garantimin e kuotave gjinore. Ndryshimet që iu bënë Kodit në 2015 dhe 2020 i zgjeruan më tej kuotat gjinore, ndër të cilat edhe kuota prej 50% meshkuj dhe 50% femra për zgjedhjet vendore.

3. **"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008** "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (Ligji Nr. 57/2016), përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në menaxhimin e sistemit buxhetor, duke shtuar si parim të funksionimit të tij respektimin e barazisë gjinore, ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të së njëjtës natyrë.

4. **Ligji "Për financat e vetëqeverisjes vendore"** (Ligji nr. 68/2017) ka krijuar mundësi për përfshirjen e efektshme të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi). Ndër të tjera, ky ligj synon të sigurojë që nëpërmjet krijimit dhe shpërndarjes së burimeve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore të përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore.

5. **Kodi i Punës (Ligji nr. 7961/1995):** Kodi i Punës ndalon diskriminimin në punësim, kërkon akomodim të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara dhe ndalon ngacmimin moral dhe seksual në vendin e punës. Ai përfshin gjithashtu edhe dispozita për promovimin e barazisë gjinore në punësim dhe të drejta profesionale.

6. **Ligji "Për personat me aftësi të kufizuara"** (Ligji nr. 93/2014): Ky ligj garanton mundësi dhe akses të barabartë për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë garantimin që gratë me aftësi të kufizuara të kenë të njëjtat mundësi si burrat me aftësi të kufizuara për akses në të drejtat e garantuara nga ky ligj.

7. **Ligji "Për sigurimet shoqërore"** (Ligji nr. 104/2014): Ky ligj njeh të drejtën e nënave dhe të baballarëve për leje prindërore, përfshirë zgjatjen e lejes së barrëlindjes deri në 63 ditë dhe aplikimi i bonusit për nënat me foshnja të porsalindura.

8. **Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"** (Ligji nr. 9669/2006): Ky ligj synon parandalimin dhe reduktimin e të gjitha formave të dhunës, duke u ofruar mbrojtje viktimave përmes procedurave të shpejta, jo të kushtueshme dhe të thjeshta. Me ndryshimet që iu bënë ligjit në vitet 2018 dhe 2020 u forcuan dispozitat që lidhen me parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave.

9. **Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi"**, i ndryshuar (Ligji nr. 221, datë 04.02.2010). Sipas këtij ligji, askush nuk mund të diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionit gjenetik, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër. Edhe ky ligj u përmirësua me Ligjin 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi", ku ndër të tjera saktësohet më tej objekti i këtij ligji, shtohen përkufizimet, duke theksuar gjuhën e urrejtjes, jepet përkufizim për format e rënda të diskriminimit, etj.

10. **Ligji 22/2018 "Për strehimin social"**, ku theksohet parimi i mosdiskriminimit, për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara përfitojnë shtresat vunerabël përfshirë viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna.

11. **Ligji 110/2018 "Për noterinë"**, që fuqizon pavarësinë ekonomike të gruas dhe është garant kryesor i të drejtave pronësore të saj, duke sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive.

12. **Ligji 111/2018 "Për kadastrën"**, që gjithashtu rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore.

13. **Ligji 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"**, ku viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje apo nënat nën moshën 18 vjeç, specifikohen tek grupet e veçanta të punëkërkueseve/punëkërkuesve të pafavorizuar në tregun e punës, të cilat/cilët përfitojnë nga shërbimet dhe programet e nxitjes së punësimit.

14. **Ligji 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"** ku përcaktohen si përfituese/përfitues të ndihmës ekonomike ndër të tjera viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

15. **Ligji 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara"**, ku theksohet miradministrimi dhe përdorimi eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030 (SKBGJ) përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipet dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t'u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cenueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës - pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.[71]

Në nivel vendor, promovimi i përfshirjes dhe barazisë gjinore është bërë pjesë e kornizave ligjore dhe të politikave që theksojnë detyrimet e njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e barazisë gjinore (UN Women, 2019). Për shembull, Ligji "Për barazinë gjinore" shtjellon nevojën për promovimin e barazisë gjinore në qeverisjen lokale dhe njësitë e veçanta që janë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës dhe shërbimit, përfshirë barazinë gjinore. Janë bërë përpjekje nga disa bashki për t'iu përmbajtur dispozitave të rregullores së e Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve Evropiane (KBRE) dhe standardeve e BE-së, me strukturë të qartë, prioritete, përgjegjësi dhe buxhete që u përgjigjen nevojave të grave, burrave, të rinjve e të rejave në mënyrë të barabartë (UN Women, 2018). Tetëmbëdhjetë njësi vetëqeverisëse vendore kanë nënshkruar "Kartën evropiane për barazinë e burrave dhe grave në jetën vendore" – një numër i tyre me ndihmën e UN Women, dhe 15 prej tyre kanë hartuar plan veprimi vendor për barazinë gjinore.

Si rezultat i këtyre, ligjeve, politikave dhe planeve, Shqipëria ka shënuar përmirësime në shumë aspekte të barazisë gjinore, për shembull, në rolin e grave në zhvillimin e sektorit privat. Përqindja e sipërmarrjeve me pronare ose administratore gra është rritur në të gjitha zonat e Shqipërisë. Megjithatë decentralizimi dhe zbatimi i suksesshëm i kornizave ligjore dhe të zhvillimit ende has në vështirësi dhe ritmi i ndryshimit në fuqizimin ekonomik të grave përmes zhvillimit të sektorit privat është i ngadaltë, sidomos ndër gratë në zonat rurale. Normat, rolet dhe përgjegjësitë gjinore, dhe tendencioziteti gjinor në aksesin e grave në burimet prodhuese (si toka, financat, rrjetet, teknologjia dhe pajisjet) dhe në shërbimet e biznesit, bëjnë që ende të mos ketë barazi për gratë dhe burrat në sferat ekonomike dhe sociale.

Disa ndikime të tendenciozitetit gjinor që shihet në Shqipëri për sa i përket fuqizimit të grave përmes zhvillimit të sipërmarrjeve, janë:

- 31,2% e ndërmarrjeve drejtohen nga gra.[72] Në vitin 2022, përqindja e grave pronare dhe administratore u pakësua krahasuar me vitin 2021, si për sa u përket bizneseve që prodhojnë mallra, ashtu edhe ato në sektorin e shërbimeve. Numri i bizneseve me pronare ose administratore gra është më i madh në sektorin e shërbimeve se sa në sektorin e prodhimit të mallrave, me përkatësisht 33,4 % dhe 17,2 %.

- Shkalla e punësimit në vitin 2023 ishte 72,9 % për burrat dhe 58, 9 % për gratë në grupmoshën 15-64 vjeç. Struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregon se 45,4% e grave janë të punësuara me pagë, ndërsa 23,5% e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes.[73]

- Në Shqipëri, numri i familjeve me kryefamiljarë burra është 4 herë më i madh se i atyre me kryefamiljare gra.

71. VKM nr. 400, datë 30.06.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit".

72. INSTAT, Regjistrat e Biznesit, 2023. https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistrat-e-biznesit/#tab3

73. Gra dhe burra në Shqipëri, 2022, https://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-Treguesis/gender-equality/#tab3

Grupmosha 55-64 vjeç ka numrin më të madh të familjeve me kryefamiljarë burra, dhe grupmosha 74+ vjeç, numrin më të madh të grave kryefamiljare. Për të gjitha grupmoshat, numri i familjeve me kryefamiljarë burra është më i lartë.[74]

Gratë luajnë një rol të rëndësishëm në sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri, ku përbëjnë një pjesë të madhe të forcës punëtore në bujqësi, ndonëse në shumicën e rasteve në punësim informal. Në vitin 2023, 37,3 % e grave të punësuara ishin të punësuara në sektorin e bujqësisë, me një rritje prej 0,1 pikë përqindjeje krahasuar me vitin pararendës. Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punësimit për gratë që jetojnë në zonat rurale.

Pabarazitë gjinore në bujqësi shpesh vazhdojnë të ekzistojnë për shkak të kornizave administrative diskriminuese. Ndër to përfshihen praktika që: (i) i pengojnë gratë të jenë (bashkë-)pronare të tokës; (ii) i pengojnë gratë të fitojnë të ardhurat të vetat apo të kenë akses në shërbime mbështetëse (për shembull, duke u refuzuar përdorimin e numrit tatimor)[75]; (iii) kërkojnë nga gratë që të paraqesin "certifikatën e fermerit" si kriter për të marrë pjesë në programe trajnimi dhe për të përfituar shërbime këshillimore; dhe (iv) i lejojnë shoqatat e përdoruesve të ujit të përdorin pronësinë mbi tokën si kriter për anëtarësim në to.[76] Faktorë të tjerë pengues janë mungesa e transportit publik në zonat rurale dhe mundësitë e kufizuara të lëvizjes. Në Shqipëri, pjesa më e madhe e motoçikletave dhe automjeteve zotërohen dhe drejtohen nga burrat dhe në vend mbizotëron norma sociale se nuk është e përshtatshme që gratë të udhëtojnë të pashoqëruara. Mundësitë e kufizuara të lëvizjes e bëjnë të vështirë që gratë të kenë akses në tregje.[77]

Shumë gra nuk janë ende të regjistruara si (bashkë-)pronare të shtëpive, tokës dhe pasurive të tjera të tyre, që vazhdojnë të figurojnë të regjistruara më së shumti në emër të bashkëshortit ose të anëtarëve të tjerë meshkuj të familjes. Ndër gratë që zotërojnë pronë, pjesa më e madhe (afërsisht 76 për qind) e kanë emrin në një titull ose dokument pronësie për shtëpinë, por jo për tokën.[78] Gratë luajnë rol kyç në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të komuniteteve rurale. Por ky rol i rëndësishëm i tyre – sidomos në prodhimin bujqësor – shpesh është "i padukshëm" dhe nuk njihet.[79]

74. Po aty.

75. Sipas Udhëzimit nr.19, 'Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar', datë 3/9/2014, fermerët që i shesin prodhimet e tyre duhet të regjistrohen në zyrat tatimore dhe të kenë një numër unik identifikimi të personit të tatueshëm. Ky regjistrim është i detyrueshëm që fermerët të përfitojnë nga skemat mbështetëse për fermerët në vend. Pjesa më e madhe e atyre që kanë numër identifikimi të personit të tatueshëm janë burra, megjithëse, në parim, bashkëregjistrimi është i lejueshëm/i mundshëm. Shih: https://www.tatime.gov.al/c/3/12/23/fermere

76. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2024.

77. FAO dhe UN Women (në botim). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

78. INSTAT (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Shih: https://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR348/FR348.pdf

79. Po aty.

Shtojca 3. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural: Çështje Gjinore Kyçe në Shqipëri

Puna e grave në bujqësi kontribuon konsiderueshëm në ekonomi, por roli i tyre përgjithësisht vazhdon të mos njihet

Në vitin 2022 bujqësia përfaqësonte 17,7 për qind të PBB-së në Shqipëri.[80] Ajo vazhdon të jetë sektor kyç në ekonominë e vendit, ku angazhohen 33,9 për qind të forcave aktive të punës. Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punësimit për gratë që jetojnë në zonat rurale: ato përbëjnë 40,1 për qind të forcave të punës në bujqësi, krahasuar me 28,7 për qind të burrave.[81] Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punës për gratë që jetojnë në zonat rurale.

Ashtu si sektorë të tjerë të ekonomisë, sektori bujqësor karakterizohet nga segmentimi gjinor i tregut të punës. Gratë e punësuara në bujqësi kanë më tepër gjasa të kryejnë punë me paga të ulëta, me kohë të pjesshme ose sezonale, ndërsa burrat janë më së shumti të punësuar në vende pune të paguara më mirë dhe me kualifikim më të lartë.[82] Në përgjithësi, gratë janë të mbipërfaqësuara në punësim informal, punë të papaguar, dhe si kontribuese të punës në familje. Një analizë e strukturës së punësimit dhe statusit të aktiviteteve të personave të punësuar tregon se 23,5 për qind e grave punojnë në familje, ndërsa përqindja e burrave që punojnë në familje është shumë më e ulët, 13.2 për qind. Përpos kësaj, sektori karakterizohet nga një sasi e konsiderueshme pune të papaguar të grave.[83] Në punësimin informal, përqindja e grave që kontribuojnë si punëtore në familje është pothuaj dy herë më e madhe se e burrave (54 për qind kundrejt 28 për qind).[84] […] Megjithëse gratë mbajnë mbi shpatulla një pjesë të konsiderueshme të barrës së punës në bujqësi, kontributi i tyre mbetet në një shkallë të lartë i pavlerësuar nga pikëpamja ekonomike.[85] […][86]

Stereotipat gjinorë dhe praktikat diskriminuese kufizojnë aksesin e grave në burimet thelbësore të prodhimit bujqësor bazë

Në themel të praktikave diskriminuese qëndron koncepti i rrënjosur thellë se puna e grave është plotësuese e punës së burrave, të cilët konsiderohen si fituesit kryesorë të jetesës në familjet shqiptare. Kështu, ndërkohë që kryefamiljarët meshkuj shpesh janë pronarë që zotërojnë dhe administrojnë pasuritë familjare dhe lëndët e para bujqësore (për shembull, farat, plehrat organike dhe kimike, makineritë bujqësore), gratë në të njëjtat familje shpesh nuk kanë lirinë t'i përdorin burimet ose të vendosin bashkërisht për varietetet e bimëve, llojet e plehrave dhe kimikateve që përdoren, ose kohën e përdorimit të tyre. Në këto raste, gratë nuk mund t'i vënë njohuritë dhe përvojat e tyre në shërbim të veprimtarive prodhuese. […] Pabarazitë gjinore në bujqësi shpesh vazhdojnë të ekzistojnë për shkak të kornizave administrative diskriminuese. Ndër to përfshihen praktika që: (i) i pengojnë gratë

80. INSTAT [në internet]. Të dhënat e llogarive kombëtare (PPB) të vitit 2023. Shih: https://www.instat.gov.al/en/themes/economy-and-finance/national-accounts-gdp/

81. INSTAT (2023). Gra dhe Burra. Shih: https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf. Ndërsa në vitin 2019, burrat përbënin 32,2 për qind, përqindja e grave ka mbetur pothuaj e pandryshuar.

82. FAO (2011). *The Role of Women in Agriculture* (Roli i grave në bujqësi). Shih: https://openknowledge.fao.org/items/a605b688-83e0-4e3a-ad47-874f0d6f63b1

83. INSTAT (2023). Tregu i punës, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/labour-market-2022/

84. Përllogaritjet e ONP-së për vitin 2019 (ILOSTAT). Shih: ONP (2023). *Women and Men in the Informal Economy: A Statistical Update* (Gratë dhe burrat në ekonominë informale: përditësim statistikor). Gjendet në: https://www.ilo.org/publications/women-and-men-informal-economy-statistical-update

85. FAO (2016). *Gender, Agriculture and Rural Development in Albania* (Gjinia, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural në Shqipëri). Shih: https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.52-%20Gender%2C%20agriculture%20and%20rural%20development%20in%20Albania.pdf

86. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

të jenë (bashkë-)pronare të tokës; (ii) i pengojnë gratë të fitojnë të ardhurat të vetat apo të kenë akses në shërbime mbështetëse (për shembull, duke u refuzuar përdorimin e numrit tatimor)[87]; (iii) kërkojnë nga gratë që të paraqesin "certifikatën e fermerit" si kriter për të marrë pjesë në programe trajnimi dhe për të përfituar shërbime këshillimore; dhe (iv) i lejojnë shoqatat e përdoruesve të ujit të përdorin pronësinë mbi tokën si kriter për anëtarësim në to.
Faktorë të tjerë pengues janë mungesa e transportit publik në zonat rurale dhe mundësitë e kufizuara të lëvizjes. Në Shqipëri, pjesa më e madhe e motoçikletave dhe automjeteve zotërohen dhe drejtohen nga burrat dhe në vend mbizotëron norma sociale se nuk është e përshtatshme që gratë të udhëtojnë të pashoqëruara. Mundësitë e kufizuara të lëvizjes e bëjnë të vështirë që gratë të kenë akses në tregje.[88] […][89]

Shërbimet këshillimore bujqësore janë kryesisht për burrat

Shërbimi Kombëtar i Ekstensionit Bujqësor (SHKEB) për këshillim bujqësor, një strukturë në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, operon nëpërmjet katër agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor (AREB) dhe, në nivel vendor, përmes qendrave të informacionit bujqësor. Shërbimi këshillimor publik përfshin gjithashtu pesë qendra të specializuara të transferimit të teknologjisë bujqësore. […] kapacitetet dhe aftësitë gjinore ende nuk janë pjesë e kualifikimeve të kërkuara për punonjësit dhe trajnimet në këtë drejtim mungojnë. Reagueshmëria e dobët gjinore e shërbimeve, së bashku me statusin social të grave dhe nivelet e ulëta të pronësisë së tyre mbi tokën, ka bërë që gratë të kenë akses të kufizuar në shërbime mbështetëse.[90] Shërbimet këshillimore bujqësore kanë si grup të synuar dhe ndihmojnë burrat: ndër 70.000 fermerët që u kontaktuan dhe ndihmuan nga shërbimet këshillimore në zona të ndryshme të vendit në vitin 2016, u konstatua se vetëm rreth 11 për qind ishin gra.[91] Që prej atëherë, numri i grave përfituese të shërbimeve këshillimore është tkurrur më tej, duke arritur në vetëm 8 për qind në vitin 2023.[92] Si rezultat i aksesit të kufizuar në informacione bujqësore dhe për tregun, niveli i produktivitetit të grave mbetet i ulët. […][93]

Niveli i tanishëm i (bashkë-)regjistrimit të fermave kufizon aksesin e grave në mundësi ekonomike

Legjislacioni që garanton të drejta të barabarta të grave në pronësi dhe trashëgimi është përmirësuar ndjeshëm.[94] Megjithatë, ende nuk janë të disponueshme të dhëna në lidhje me (bashkë-)pronësinë e grave mbi tokën. Aktualisht, vetëm 10 për qind e titujve të pronësisë mbi tokën janë të regjistruar digjitalisht, 10 për qind nuk janë të regjistruar, ndërsa 80 për qind ekzistojnë të regjistruar vetëm në letër. […] Shumë gra nuk janë ende të regjistruara si (bashkë-) pronare të shtëpive, tokës dhe pasurive të tjera të tyre, që vazhdojnë të figurojnë të regjistruara më së shumti në

87. Sipas Udhëzimit nr.19, 'Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar', datë 3/9/2014, fermerët që i shesin prodhimet e tyre duhet të regjistrohen në zyrat tatimore dhe të kenë një numër unik identifikimi të personit të tatueshëm. Ky regjistrimi është i detyrueshëm që fermerët të përfitojnë nga skemat mbështetëse për fermerët në vend. Pjesa më e madhe e atyre që kanë numër identifikimi të personit të tatueshëm janë burra, megjithëse, në parim, bashkëregjistrimi është i lejueshëm/i mundshëm. Shih: https://www.tatime.gov.al/c/3/12/23/fermere

88. FAO dhe UN Women (në botim). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

89. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

90. FAO (2024). *Ensuring that rural advisory services are responsive to women: good practices from FAO experiences in Europe and Central Asia* (Sigurimi që shërbimet këshillimore rurale t'u përgjigjen nevojave të grave: praktika të mira nga përvojat e FAO-s në Evropë dhe Azinë Qendrore). Shih: https://openknowledge.fao.org/items/c69ef2a6-4381-4e16-b624-a090e94b5710

91. UNDP dhe UN Women (2016). Dosja Gjinore Shqipëri. Shih: https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief

92. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në: FAO dhe UN Women (së shpejti). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

93. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023.. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

94. Ligji nr.111/2018 për Kadastrën, miratuar më 02/02/2019. Gjendet në: https://www.ashk.gov.al/2021/04/16/2066/. (versioni në gjuhën angleze gjendet në): https://www.fao.org/faolex/results/details/en/c/LEX-FAOC220473/); dhe Ligji nr.110/2018 për Noterinë, miratuar më 20/12/2018. Gjendet në: http://www.nchb.al/wp-content/uploads/2021/04/Ligj-nr.-110-2018-Per-Noterine.pdf. (Një përkthim jozyrtar në anglishte gjendet në: https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=160&catid=25&m=0). Legjislacioni i ri synon të mbrojë gratë nga tjetërsimi, blerja dhe heqja dorë nga pronat e tyre të paluajtshme, përfshirë tokën. Ai parashikon zbatimin e një sistemi me një sportel, tek noteri publik, për transaksionet që lidhen me tokën si edhe krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës për sigurimin e llogaridhënies nga noterët.

emër të bashkëshortit ose të anëtarëve të tjerë meshkuj të familjes. Ndër gratë që zotërojnë pronë, pjesa më e madhe (afërsisht 76 për qind) e kanë emrin në një titull ose dokument pronësie për shtëpinë, por jo për tokën.[95] […]Kjo i ka penguar gratë fermere që, për shembull, të përfitojnë shërbime këshillimore bujqësore, mbështetje financiare, dhe kontrata formale të rregullta me tregtarët, gjë që ka ndikuar negativisht në produktivitetin e tyre.[96] Krahas kësaj, gratë ndeshin vështirësi për të pasur akses në kredi nga bankat komerciale, kryesisht për shkak të kolateralit të pamjaftueshëm, situatë që rëndohet edhe më për shkak se të drejtat pronësore *de facto* janë të dobëta ose inekzistente. Arritja e një barazie më të madhe në të drejtat pronësore mbi tokën dhe aksesin në kredi do të shtonte ndjeshëm pjesëmarrjen fitimprurëse të grave në ekonominë bujqësore. Mungesa e pronësisë mbi tokën ndikon gjithashtu edhe në mundësitë e anëtarësimit të grave në organizatat e fermerëve, si shoqatat e përdoruesve të ujit dhe të ujitjes dhe shoqatat e prodhuesve. Duke qenë se për t'u anëtarësuar në këto organizata shpesh duhet të jesh pronar i tokës ose kryefamiljar, gratë e kanë të vështirë të bëhen anëtare të tyre. Kur shërbimet këshillimore bujqësore u drejtohen vetëm fermerëve të regjistruar ose anëtarëve të shoqatave, gratë automatikisht përjashtohen për shkak të mospërmbushjes së kushteve të anëtarësimit dhe, rrjedhimisht, nuk përfitojnë nga këto shërbime. […][97]

Gratë kanë (bashkë-)pronësi të kufizuar në ferma dhe ndërmarrje bujqësore

Në vitin 2022, nga 84.369 fermerë të regjistruar zyrtarisht në zyrat tatimore në Shqipëri, vetëm 10,8 për qind ishin gra.[98] Pjesa më e madhe e kontributit të grave në sektorin bujqësor konsiston në punësim informal në familjen bujqësore.[99] Në këtë lloj aktiviteti bujqësor, burrat përgjithësisht identifikohen si drejtues dhe "kryefamiljarë" ndërsa gratë janë të regjistruara si "ndihmëse", nën kategorinë "punëtorë familjarë kontribues".[100] Zakonisht burrat janë ata që kanë nën kontroll asetet bujqësore, marrin vendime, administrojnë financat dhe kryejnë punët që kërkojnë lëvizshmëri, ndërsa gratë merren kryesisht me punë fizike bujqësore, si punët para dhe pas vjeljes/korrjes, përpunimet ushqimore dhe punët e shtëpisë. Kjo ndarje e pabarabartë e punës kufizon aksesin e grave në asete bujqësore.

Ndërmarrjet që operojnë në kuadër të kategorisë ekonomike "Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi" përfaqësojnë vetëm 1 për qind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive.[101] Në mbi 80 për qind të ndërmarrjeve bujqësore aktive, pronarët ose drejtuesit janë burra: në vitin 2022, gratë ishin (bashkë-)pronare të vetëm 18,5 për qind të ndërmarrjeve aktive në bujqësi, pylltari, dhe peshkim.[102] Që nga viti 2016, numri i përgjithshëm i grave pronare dhe drejtuese të bizneseve në Shqipëri është rritur. Megjithatë, niveli dhe ritmi i përfshirjes ekonomike të grave përmes zhvillimit të sektorit privat vazhdojnë të jenë të ulëta, sidomos për sa u përket grave në zonat rurale. Ndikimi i normave gjinore kufizuese që çojnë në diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të grave është i dukshëm në të gjitha nivelet e ekonomisë rurale […][103]

95. INSTAT (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Shih: https://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR348/FR348.pdf

96. UN Women (2016). Studim kombëtar: Diversifikimi ekonomik për gratë që jetojnë në zonat rurale në Shqipëri. Gjendet në: https://albania.un.org/en/46581-economic-diversification-women-living-albanian-rural-areas

97. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

98. INSTAT (2022). Regjistrat e biznesit, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/business-registers-2022/

99. Po aty.

100. FAO (2016). *Gender, Agriculture, and Rural Development in Albania* (Gjinia, bujqësia dhe zhvillimi rural në Shqipëri). Shih: https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.52-%20Gender%2C%20agriculture%20and%20rural%20development%20in%20Albania.pdf

101. INSTAT (2022). Regjistrat e biznesit, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/business-registers-2022/

102. Po aty.

103. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

Gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në burimet e nevojshme për t'u marrë me biznes

Shumë gra në Shqipëri përballen me vështirësi për të pasur akses në burime biznesi. Gratë që nuk kanë llogari bankare apo nuk zotërojnë tokë për ta ofruar si kolateral, kanë akses të kufizuar në shërbime financiare, gjë që ua bën të vështirë të krijojnë, menaxhojnë, ose zgjerojnë bizneset e tyre. Për përfitimin e shërbimeve financiare zakonisht është kusht që të kesh llogari bankare. Megjithatë, ekziston një vijë e qartë ndarëse midis zonave rurale dhe urbane: në vitin 2017, vetëm 31 për qind e banorëve të zonave rurale raportuan se kishin llogari bankare, krahasuar me 52 për qind të banorëve në zona urbane.[104] Përveç kësaj, shihet qartë edhe një hendek i konsiderueshëm gjinor: në grupmoshën 15-45 vjeç, vetëm 17 për qind e grave dhe 25,9 për qind e burrave që jetonin në zona rurale raportuan se kishin llogari bankare, krahasuar me 44,7 për qind të grave dhe 48,2 për qind të burrave në zonat urbane.[105] Këto rezultate ilustrojnë disavantazhet për shkak të përkatësisë së shumëfishtë, si rezultat i karakteristikave gjinore (domethënë, të qenit grua) dhe atyre të vendbanimit (domethënë, banimi në zone rurale). Krahas kësaj, gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në trajnime që ofrojnë njohuri dhe aftësi biznesi, si ato për përpunimin dhe marketimin e produkteve. Për marketimin e duhur të biznesit, është e rëndësishme të merret në kohë informacion i saktë përmes telefonit celular, radios, apo përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Zotërimi ose jo i këtyre mjeteve dhe burimeve nga gratë mund të ndikojë në suksesin e biznesit të tyre. Ndonëse përgjithësisht janë bërë përparime në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në marketim, gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në internet dhe në TIK. Në përgjithësi, infrastruktura e teknologjisë së informacionit është mjaft e zhvilluar në qendrat urbane. Kurse në zonat rurale, ku mbulimi me infrastrukturën e energjisë elektrike dhe internetit me bandë të gjerë nuk është aq i zhvilluar, kostot e këtyre shërbimeve janë të larta dhe depërtimi i ulët – dhe numri i personave që kanë akses në internet dhe që përdorin atë është më i vogël. Në zonat rurale, më pak se 10 për qind e familjeve kanë akses në internet dhe vetëm 28 për qind e tyre kanë kompjuter.[106] Mungesa e konektivitetit të zonave rurale në Shqipëri është evidentuari si një prej mangësive që pengon rritjen ekonomike në vend.[107] Për më tepër, kur në familje ka vetëm një telefon celular, ai shpesh përdoret vetëm nga kryefamiljari, ndërsa gratë dhe vajzat në familje nuk mund ta përdorin atë lirisht. Aktualisht nuk ka studime mbi aksesin e grave në zonat rurale në internet dhe në TIK.

Gratë fermere kanë përfaqësim të ulët në organizata, shoqata dhe organe vendimmarrëse në zonat rurale

Me gjithë rolin e rëndësishëm të grave të zonave rurale në prodhimin bujqësor në Shqipëri, pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje në nivel të familjes, komunitetit dhe administrativ është përgjithësisht e kufizuar. Gratë rrallë janë anëtare apo përfaqësohen në shoqata apo komitete zyrtare dhe ato vazhdojnë të jenë tejet të nënpërfaqësuara në poste vendimmarrëse dhe drejtuese.[108] Në nivel komuniteti, burrat janë drejtues të grupeve prodhuese dhe kooperativave, ndërsa gratë janë të përjashtuara, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga marrja e vendimeve. Në organizatat e fermerëve, numri i grave anëtare është zakonisht i ulët, sepse në ato organizata pranohen si anëtarë kryesisht kryefamiljarët. Rrjedhimisht, gratë rrallë janë të pranishme në diskutime dhe vendimet që merren në grup nuk pasqyrojnë njohuritë, pikëpamjet, nevojat dhe të drejtat e tyre. Shqetësim është gjithashtu mospjesëmarrja e grave në proceset e menaxhimit të burimeve natyrore, si menaxhimi i integruar i ujit, si dhe niveli i ulët i përfshirjes së grave rurale në nismat lidhur me ndryshimet klimatike dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe të trashëgimisë kulturore.[109]

[…] Gjithashtu, gratë nuk kanë pushtet ekonomik, influencë politike, apo informacion mbi proceset e vendimmarrjes. Së fundi, për shkak të kufizimeve në mundësitë e lëvizjes, largësia fizike nga qendrat administrative ku merren vendimet i kufizon më tej mundësitë e pjesëmarrjes së grave. […][110]

104. INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik, dhe ICF (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Gjendet në: http://www.instat.gov.al/media/5050/adhs-2017-18-pdf.pdf

105. Po aty.

106. Po aty.

107. ITU (2022). *Albania – Digital Development Country Profile* (Shqipëria – Profili i zhvillimit digjital të vendit. Shih: https://www.itu.int/en/ITU-D/Regional-Presence/Europe/Documents/Publications/2022/Digital%20Development/Digital%20Development%20Country%20Profile_Albania_final_02.22.pdf

108. UN Women (2020). Dosja e Barazisë Gjinore, Shqipëri 2020. Shih: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020-0

109. Po aty.

110. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

Ofrimi i shërbimeve dhe infrastruktura rurale nuk plotësojnë nevojat e grave dhe vajzave

Në Shqipëri vazhdon të jetë shqetësim aksesi i kufizuar – sidomos i grave dhe vajzave - në shërbime bazë si shëndetësia, kujdesi shëndetësor seksual dhe riprodhues dhe mbrojtja sociale në zonat rurale dhe të thella.[111] Krahas kësaj, infrastruktura e dobët e furnizimit me ujë dhe mbledhjes së ujërave të zeza, mungesa e pajisjeve teknologjike që kursejnë kohë, ofrimi i pamjaftueshëm i shërbimeve të kujdesit për fëmijët e vegjël, infrastruktura e pasigurt e transportit dhe mungesa e transportit publik me kosto të përballueshme - që të gjitha ndikojnë negativisht në mundësitë e grave për t'i kushtuar kohë punës produktive dhe të paguar dhe për të pasur akses në tregje.

Formimi profesional bujqësor nuk mbështet perspektivat e grave dhe vajzave për të pasur karrierë në këtë sektor

Në kuadër të aspiratës së Shqipërisë për të hyrë në tregun e përbashkët të BE-së, të rinjtë e të rejat duhet të kenë nivele të reja të përgatitjes profesionale që të mund të angazhohen si punëtorë fermash, teknikë, sipërmarrës biznesesh bujqësore apo vendimmarrës në fushën e zhvillimit rural. Shkollat profesionale luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e kapaciteteve njerëzore të kualifikuara dhe pajisjen e të rejave dhe të rinjve me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që kërkon tregu. Por me gjithë veprimtaritë promovuese dhe mbështetjen për nxitjen e nxënësve nga zonat rurale të Shqipërisë për të marrë pjesë në arsim dhe formim profesional (AFP), numri i nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale ka rënë. Kjo rënie ka qenë veçanërisht e ndjeshme në regjistrimet nga radhët e grupeve vulnerabël (një rënie me 30 për qind).[112] Në Shqipëri ka tetë shkolla të mesme bujqësore dhe nxënësit në to vazhdojnë të jenë pothuaj tërësisht djem. Numri i vajzave është i ulët (afërsisht 16 për qind) dhe pjesëmarrja e vajzave nga zonat rurale është pothuaj e papërfillshme. […][113]

Politikat, programet, buxhetet dhe skemat kombëtare për mbështetjen e bujqësisë dhe blegtorisë nuk u përgjigjen mjaftueshëm nevojave të grave

Në përgjithësi, politikat, planet, programet dhe buxhetet në Shqipëri hartohen mbi bazën e premisës se të gjithë individët që merren me bujqësi dhe blegtori janë burra. Sikurse shihet edhe në Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027,[114] vëmendja e dokumenteve strategjike përqendrohet tek fermerët burra. Edhe zyrtarët dhe punonjësit e këshillimit bujqësor që shpërndajnë teknologji, politika, informacion dhe risi bujqësore ndër fermerët, janë kryesisht burra. Ndonëse në periudhën 2018-2023 numri i përgjithshëm i grave që përfituan nga skemat kombëtare të mbështetjes pati rritje në vlerë absolute, përqindja e grave në raport me numrin e gjithsejtë të përfituesve ra nga 22 për qind në vitin 2018 në 16 për qind në vitin 2023.[115] Për të nxitur pjesëmarrjen e grave, Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (FBZHR) u jep pikë shtesë ("bonus") grave që aplikojnë. Megjithatë, përqindja e grave që aplikojnë dhe përfitojnë nga programet e FBZHR-së mbetet jashtëzakonisht e ulët.[116] […] Programi i Zhvillimit Rural në kuadër të Instrumentit të Asistencës Para Anëtarësimit (IPA) i Republikës së Shqipërisë 2021-2027 (IPA-ZHR III) përmend shprehimisht detyrimet dhe objektivat e barazisë gjinore.[117] Në të

111. KEGJFDG E OKB-SË (2023). Vërejtje përmbyllëse të raportit të pestë periodik për Shqipërinë, 2023. Gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=KEGJFDG%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en

112. Komisioni Evropian (2023). Raporti për Shqipërinë 2023. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

113. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

114. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2022). Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027, miratuar me Vendimin nr.460, datë 29 qershor 2022. Gjendet në: https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/100/6dea9d2c-c264-48a8-a9e1-d041781a823c;q=strategjia%20e%20bujqesise%20dhe%20zhvillimit%20rural

115. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në: FAO dhe UN Women (së shpejti). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

116. Në vitin 2018, në skemat kombëtare të mbështetjes në bujqësi aplikuan 779 gra, nga të cilat 627 i përfituan ato. Pesë gra përfituan nga "mbështetja për investime në agroturizëm", "inkubator për mbështetjen e prodhimeve vendore tradicionale" dhe "mbështetje për ndërtimin ose rindërtimin e mjediseve të akomodimit në turizmin rural me të paktën 6 deri në 10 dhoma". Në vitin 2019, përqindja e grave që aplikuan për subvencione nga AZHBR ishte 19 për qind. Burimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2019; dhe: Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë (2020). Raport alternativ mbi zbatimin e Konventës KEGJFDG në Shqipëri 2016-2020. Gjendet në: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/alternative-report-on-the-implementation-of-the-cedaw-convention-in-albania

117. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2022). Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/ProgramiIPARDIII_2021-2027_English.pdf

përmendet Aide-Mémoire e kornizës ndërkombëtare përkatëse[118] për përfshirjen e perspektivës gjinore në Planin e Veprimit për Reduktimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë të OKB-së, detyrimet në kuadër të Planit të Tretë të Veprimit Gjinor të BE-së[119], dhe aktivitetet dhe rezultatet e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore (2021-2030), Objektivi 3.1, "Fuqizimi ekonomik i grave në zonat rurale".[120] Qëllimi i përgjithshëm i IPA-ZHR III është rritja e punësimit dhe të ardhurave "të gjeneruara nga gratë dhe sipërmarrësit e rinj në zonat rurale". Në dokument jepen rregullat për aksesimin e fondeve të IPA-ZHR III, ku përfshihen:

- respektim i shprehur i standardeve të BE-së lidhur me kërkesat e barazisë gjinore, pra, integrim i perspektivës gjinore në të gjitha programet;
- kryerja e analizës gjinore;
- të dhëna të ndara sipas gjinisë;
- përdorimi dhe monitorimi i treguesve gjinorë;
- trajnimi për integrimin gjinor në strukturat operative;
- bashkëpunimi me organizatat/shoqatat e grave;
- pjesëmarrja e barabartë e grave në grupet dhe organet zyrtare (si Grupet e Veprimit Vendor);
- përfaqësimi i grave në poste udhëheqëse dhe vendimmarrëse;
- përfshirja e organeve qeveritare përgjegjëse për promovimin e barazisë gjinore;
- veprim afirmativ (kuotat, preferenca ndaj grave aplikante);
- raportim i rezultateve të barazisë gjinore.

Nuk ka informacion të disponueshëm për nivelin e përmbushjes dhe zbatimit të rregulloreve të barazisë gjinore gjatë zbatimit të IPA-ZHR III. Në vitin 2023, Komisioni Evropian pezulloi IPA-ZHR III dhe ajo vazhdon të jetë joaktive.

Rregullat e BE-së të përcaktuara në kuadër të programit IPA-ZHR III për adresimin dhe promovimin e barazisë gjinore në bujqësi shërbejnë si udhëzues i vlefshëm për harmonizimin me standardet e BE-së. Është e nevojshme që të reagohet me politika dhe rregullore kombëtare që rezultojnë në ngushtimin e hendekut gjinor dhe promovojnë një mjedis ku gratë kanë akses të barabartë në burime, në mënyrë që ato të mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në prodhim bujqësor, konkurrencë, rritje ekonomike dhe zhvillim rural.

Boshllëqe në statistikat dhe të dhëna gjinore për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe statistikat gjinore janë shumë të rëndësishme për të kuptuar situatën me të cilën përballen gratë dhe burrat në sektorin BZHR në Shqipëri. Ato janë gjithashtu me rëndësi kyçe për kryerjen e analizave gjinore, hartimin e politikave reaguese gjinore dhe zhvillimin e masave për trajtimin e pabarazive dhe sfidave specifike gjinore. Megjithatë, mangësitë aktuale në të dhëna pengojnë hartimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe buxheteve që kanë lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin rural të cilat u kundërvihen pabarazive, trajtojnë sfidat specifike gjinore, dhe monitorojnë siç duhet përparimin e bërë në ngushtimin e dallimeve gjinore.[121] […][122]

118. UN Women - *Women's Resilience to Disasters Knowledge Hub (2017). Aide-Memoire on integrating gender equality in the UN plan of action on disaster risk reduction for resilience* (Qendër e njohurive për përballimin e fatkeqësive nga gratë (2017). (Kujtesë për integrimin e barazisë gjinore në planin e veprimit të BE-së për reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe përballimin e situatave). Gjendet në: https://wrd.unwomen.org/practice/resources/aide-memoire-integrating-gender-equality-un-plan-action-disaster-risk-reduction

119. Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë (2020). *Objectives and Treguesis to Frame the Implementation of the Gender Action Plan III (2021-25)*(Objektiva dhe tregues për kornizën e zbatimit të Planit të Veprimit Gjinor III), f.27. Gjendet në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020SC0284

120. Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030, botuar në Fletoren Zyrtare nr.112, datë 15/07/2021. Shih: https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/112. Gjendet në:
https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-02/WEB_Strategjia%20Kombetare%20-%20EN.pdf

121. KEGJFDG e OKB-së (2023). Vërejtje përmbyllëse të raportit të pestë periodik për Shqipërinë, 2023. Gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=KEGJFDG%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en]

122. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

Figura 5. Gratë, burrat dhe bujqësia në Shqipëri



Burimi: INSTAT (2023). Tregu i punës, 2022; Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në : FAO dhe UN Women (së shpejti). National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

Fuqizim i Grave për Zhvillim Rural në Shqipërinë e Veriut

SHKODËR DIBËR MALËSI E MADHE BULQIZË

Ambasciata d'Italia Tirana

AGENZIA ITALIANA PER LA COOPERAZIONE ALLO SVILUPPO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

UN WOMEN